# ÇËSHTJA PALESTINEZE

- historia dhe zhvillimi i saj deri në 2005 -

Muhsin Muhamed Salih



© Jehona Study Center
2006

DR. MUHSIN MUHAMED SALIH

*Profesor i studimeve palestineze dhe historisë moderne arabe*

# ÇËSHTJA PALESTINEZE

*Historia dhe zhvillimi i saj deri në 2005*

Boton:

JEHONA STUDY CENTER

Tiranë 2006

ÇËSHTJA PALESTINEZE

*Historia dhe zhvillimi i saj deri në 2005*

*Titulli i origjinalit:*

***THE PALESTINIAN ISSUE***

*Its background and development up to 2005*

Përktheu:

Sabina Fejzullaj (Tufa)

Gentjan Fejzullaj

Redaktoi:

Gentjan Fejzullaj

Grafika:

Lindita Dervishi

Botimi i parë i 2006

©JEHONA STUDY CENTER

# PAK FJALË MBI KËTË LIBËR

Dr. Muhsin Salih është një nga mendjet më të ndritura palestineze që kam njohur ndonjëherë. Libri i tij "Çështja Palestineze: historia dhe zhvillimi i saj gjatë kohërave moderne, deri në vitin 2005" është një përpjekje serioze e një dëshmimtari dhe historiani të gjallë, i cili në rreshtat që vijojnë mundohet ti rrëfejë komunitetit ndërkombëtar tragjedinë më të madhe njerëzore të shekullit të XX: Historinë e Holokaustit Palestinez.

Në momentet qe ky libër po botohet, në Gaza, në Bregun Perëndimor, në Liban dhe në të gjithë Lindjen e Mesme, një popull vazhdon të jetojë si i huaj, i përbuzur dhe i shtypur. Populli krenar palestinez vazhdon deri në këto momente, që prej afro 100 vitesh pas nisjes së tragjedisë së tij të shkaktuar nga çakejtë e vjetër imperialistë, të ekzistojë si një komb i dënuar dhe i mohuar. Palestinezët që prej afro 60 vitesh jetojnë néper kampe refugjatësh, larg nga toka e tyre, të cilën udhëheqësit e botes së sotme ia grabitën me dhunë dhe ligesi këtij kombi të pafaj. Palestinezët janë ende qytetarë të asnjë vendi dhe Palestina e shenjtë e komunitetit të muslimanëve boterorë vazhdon të mbetet një nocion i kaluar historik për mendjet sadiste të sundimtarëve zionistë të Izraelit dhe padronëve të tyre në Perëndim.

Të lindur në fushëbetejen më të egër biblike të Lindjes së Mesme, populli krenar palestinez ka kuptuar se si izraelitet ashtu edhe padronet e tyre perendimorë, thjesht nuk duan që palestinezët arabë t i lënë të jetojnë në tokën e stërgjyshërve të tyre arabe. Te pezmatuar, fyer dhe debuar nga hegjemonët e bardhë të perëndimit judeo kristian, ata i rrëfyen Oksidentit në zgjedhjet e 2006-es se në mënyrë demokratike populli i Palestines do të votonte për

Hamasin, pasi paqja që Perëndimi i krishterë i premtoi OCP-së vite më parë ishte thjesht gënjeshtra e radhës. Duke parë përditë e më shumë se fondamentalizmi islamofobik perendimor qëndroni palëkundër në mbështetje të agresionit izraelit mbi tokën e tyre dhe nenshtrimin e botës muslimane, palestinezët nuk kanë mënyrë tjetër për tju përgjigjur aparteidit të njeriut të bardhe judeo kristian, por vetëm se me intifadë.

Ngaqë publiku ynë në Shqipëri, shpesh bëhet viktimë e trushplarjes së mediave tona thellesisht perëndimore dhe servile, prej kohësh kam qenë i mendimit që ky libër duhej të botohej në gjuhën shqipe: në mënyrë që edhe në mendjen shqiptare të hidhet pakëz dritë mbi historikun e vërtetë të Tokës së Shenjtë dhe njerëzve të saj, palestinezëve.

Palestinezët nuk janë terroristë si okupatorët e tyre izraelitë. Ata janë njerëz që duan të jetojnë të lirë dhe në paqe. Por për të arritur këtë, ata, ashtu si Dauti i vogël në rrëfimet kuranore që qendronte kundër bishës Xhalut, janë të vendosur që të luftojnë një luftë të pabarabartë me makinën ushtarake të zionizmit në Palestinë dhe të mos dorëzohen kurrë, në mënyrë që një ditë, ashtu si Dauti në rrëfimin kuranor, të mundin bishën okupatore dhe të sigurojnë një Palestinë të lirë.

*Olsi Jazexhi*

*Tiranë, mars 2006*

## PËRMBAJTJA


Fjala e autorit.........................................................7

**KAPITULLI I: HISTORIA E ÇËSHTJES PALESTINEZE**

Palestina.........................................................10

Statusi i Palestinës në Islam.........................................12

Palestina në historinë botërore.......................................14

Palestina nën sundimin islam.........................................19

Pretendimet historike dhe fetare të çifutëve për Palestinën............. 21

Të dhëna rreth çështjes palestineze në historinë botërore.............24

Zhvillimet politike të çështjes palestineze deri në vitin 1914.........27

Çështja palestineze gjatë Luftës së Parë Botërore më 1914-1918.....31

**KAPITULLI II: PALESTINA NËN PUSHTIMIN BRITANIK GJATË VITEVE 1917-1948**

Krijimi dhe evolimi i projektit zionist..................................36

Nevoja e ngutshme e krijimit te Lëvizjes Kombëtare Palestineze.38

Lëvizja Kombëtare Palestineze gjatë viteve 1918-1929...............39

Lëvizja Kombëtare Palestineze gjatë viteve 1929-1939...............41

Revolucioni i madh palestinez gjatë viteve 1936-1939.................47

Zhvillimet politike gjatë viteve 1939-1947..............................50

Lufta e vitit 1948 dhe pasojat e saj.......................................54

**KAPITULLI III: ÇËSHTJA PALESTINEZE GJATË VITEVE 1949-1967**

Vendet arabe dhe Palestina..................................................58

Lufta kombëtare palestineze...............................................60

Themelimi i Lëvizjes "Fatah"...............................................64

Themelimi i Organizatës për Çlirimin e Palestinës (O.Ç.P)..........66

Lufta e qershorit 1967 dhe jehona e saj...................................67

**KAPITULLI IV: ÇËSHTJA PALESTINEZE GJATË PERIUDHËS 1967-1987**


Nevoja e menjëhershme e Palestinës për identitet……………………69
Lufta e armatosur palestineze………………………………...…70
Shtetet arabe dhe çështja palestineze…………………….……..74
Domosdoshmëria e prirjes së Palestinës drejt Islamit.....................76


**KAPITULLI V: ÇËSHTJA PALESTINEZE GJATË PERIUDHËS 1987-2000**


Intifada (kryengritja) e bekuar…………………………….…78
Hamasi………………………………………………..………80
O.CP nga lufta e armatosur në procesin e paqes…………………..84
Autoritetet palestineze dhe situata aktuale……………..……90
Shteti Zionist dhe situata aktuale.................................................93


**KAPITULLI VI: ÇËSHTJA PALESTINEZE NË VITET 2000-2005**


Jeruzalemi (Kudsi) dhe situata aktuale…………….……….107
Muri ndarës………………………………………………..…113
Procesi i kompromisit dhe negociatat………………….……118
Harta e Rrugës (The Road Map)……………………..………120
Tërheqja nga Gaza dhe plani i ndarjes………………………123
Ngritja e Hamasit……………………………………………129
Vlerësime dhe përfundime……………………….………….132
Shtojca: Dëshmi dhe shprehje të famshme…………………….139
Bibliografia e përzgjedhur……………….……………………...144

# FJALA E AUTORIT

Falenderimet i takojnë Allahut, Zotit të të gjithë njerëzve. Paqja e Zotit qoftë me kreun dhe vulën e profetëve, me të gjithë familjen dhe mbarë shokët e tij!

Ky studim i shkurtër ka për qëllim të paraqesë një pamje të përgjithshme të çështjes palestineze. Kjo bëhet me anë të tregimeve historike që shpresojmë se do ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë çështjen në tërësi dhe faktorët që ndërlidhen me të. Kjo çështje mund të jetë trajtuar më parë si temë (në lidhje me tokën, popullin, projektin zionist, rezistencën etj.), por ky studim është paraqitur në formën problematike dhe është i ngjashëm nga forma me studimet e shkurtëra. Brenda këtij studimi është cekur secila prej temave, duke pasur parasysh natyrën e secilës temë, pasi në këtë material këto tema nuk janë të ndërlidhura në një rrjedhë të vetme.

Ky studim i drejtohet atyre lexuesish që kanë nevojë të kenë një vizion të shkurtër mbi çështjen palestineze. Pra ky është një libërth apo "libër xhepi", që plotëson nevojat e shumta që ka komuniteti arab dhe ai musliman në tërësi dhe për çdo të interesuar që nuk mund të harxhojë kohë me studime tepër të detajuara dhe specifike rreth kësaj teme.

Vizioni që e përshkon këtë studim, pa dyshim që ka të bëjë me besimin e palëkundur se Palestina prej kohësh ka qenë një territor i banuar nga arabët dhe se feja islame është pjesë e pandarë e historisë së këtij vendi. Po ashtu, ky vizion ka të bëjë dhe me të drejtën e plotë, legjitime dhe të padiskutueshme që kanë palestinezët për atdheun e tyre.

Ky studim është informues dhe i dokumentuar aq sa duhet, si dhe, brenda mundësive, është paraqitur me një gjuhë të thjeshtë dhe në mënyrë të kuptueshme.

Është kënaqësia ime që në parathënien e versionit në gjuhën angleze të këtij libri, ti paraqes falënderimet e mia të thella dhe vlerësimet

e mia shefit të Departamentit të Historisë dhe Qytetërimit pranë Universitetit Ndërkombëtar Islamik, profesorit Hasan Ahmed Ibrahimit. Kjo, pasi ai arriti të bëjë një përkthim të shkëlqyer të tekstit nga gjuha arabe brenda një koha të shkurtër.

Duke i hedhur një sy futnotave në fund të çdo faqeje të librit, lexuesi do të vërë re se në pjesën më të madhe burimet dhe informacionit janë arabe. Por, megjithëse ishte e pashmangshme që ky dorëshkrim të shkruhej fillimisht për lexuesit që e njohin gjuhën arabe, konsultimi me burimet nga gjuha angleze është bërë vetëm atëherë kur ato kanë qenë tepër të rëndësishme.

*Lusim Allahun e Madhëruar që nëpërmjet këtij libri të arrijmë kënaqësinë e Tij!*

# KAPITULLI I

# NJOHURI HISTORIKE MBI ÇËSHTJEN PALESTINEZE

Historikisht çështja palestineze ka qenë dhe vazhdon të jetë e një rëndësie tepër të veçantë, si për botën arabe, ashtu dhe për atë muslimane.

Kjo për tre arsye kryesore:

**Së pari**, kjo ka të bëjë me faktin se Palestina është e shenjtë dhe të gjithë muslimanët kanë një lidhje shpirtërore dhe sentimentale me vendet e shenjta që gjenden në këtë tokë.

**Së dyti**, ky vend është i lidhur ngushtë me urrejtjen ideologjike dhe historike që është e rrënjosur tek çifutët zionistë kundrejt Islamit dhe muslimanëve.

**Së treti**, për shkak të natyrës së gjerë imperialiste, Palestina ka qenë në shënjestër të projektit zionist perëndimor dhe përpjekjeve të tyre të vazhdueshme për ta ndarë umetin musliman në bashkësi të dobëta dhe të veçuara dhe për të bërë të mundur kështu dominimin e tyre nga superfuqitë

Shpërngulja që iu bë bashkësive zioniste izrealite në Palestinë, e cila është zemra e umetit musliman, gjatë vitit 1948 si dhe kërcënimet e gjera ushtarake dhe politike që iu bënë popullatës së këtij vendi, çuan në përpjekjet e këtij populli për të arritur lirinë, bashkimin dhe rivendosjen e rolit të tij historik në botë. Në të vërtetë kjo është sfida më e madhe me të cilën përballen muslimanët në këto rrethana të vështira të historisë së tyre.

Çështja palestineze nuk përbën shqetësim vetëm për arabët palestinezë. Lëvizja Zioniste ka qenë krijuar fillimisht për të qenë një

pararojë e zbatimit të "programit fshesë", të planifikuar nga zionistët perëndimorë, pavarësisht nga sinkronizimi i tij me simpatitë fetare kundrejt çifutëve apo pretendimeve për të zgjidhur "problemin" e tyre në Europë.

Në të vërtetë Perëndimi bëri një padrejtësi të madhe duke imponuar eksodin masiv të popullit palestinez nga toka dhe shtëpitë e tyre si dhe shkatërrimin e shtetit të tyre. Kjo, për më tepër, e ka nxjerrë botën muslimane dhe të gjithë stabibilitetin botëror përballë rreziqeve të mëdha. Dhe, për ironi, ky veprim i paprecedent padrejtësie u ndërmorr nga ana e Perëndimit, atëherë kur më së shumti po jepej dhe reklamohej fuqishëm roli i tij si mbrojtës i të drejtave njerëzore dhe paqes në botë.

## Palestina

Ky emër i është dhënë territoreve të Bilad al-Sham-it, të vendosura në perëndim të Azisë dhe në lindje të Mesdheut. Ky vend i njohur me emrin Palestinë, ka një pozicion strategjik që lidh Azinë me Afrikën si dhe ka një pozicion tepër të favorshëm për dy krahët e botës islame, krahun aziatik dhe atë afrikan.

Fakte të rëndësishme arkeologjike dëshmojnë për popullimin e Palestinës që në kohët e lashta. Po ashtu janë të ruajtura prova se kjo tokë ka kaluar nëpër periudhën e hershme tepër të rëndësishme të trasformimit të veprimtarisë njerëzore që nga blegtoria e deri tek jeta bujqësore. Përveç faktit se një nga qytetet më të hershme të hitorisë, Xheriko, u themelua rreth vitit 8.000 para Krishtit në pjesën verilindore të Palestinës.

Emërtimi më i hershëm që njihet për Palestinënë është Ard Kan an (toka e Kananit). Ky emër iu dha vendit pas emigrimit të popullit të Kananit, i cili erdhi në këtë rajon nga Arabia rreth vitit 2500 p.e.s.

Emri "Palestine" vjen nga fiset bregdetare (Filistinet), të cilët kishin emigruar në këtë vend në shek. XII p.e.s nga Azia e Vogël si dhe nga Deti Egje. Ata u vendosën në pjesët bregdetare, por brenda një

kohe të shkurtër ata u asimiluan nga Kananët dhe e vetmja gjë që mbeti ishte emri i tyre.

Në shkrimet e hershme egjiptiane emri Palestinë është gdhendur me shkronjat "PLS.T". Nga këto shkronja "N"-ja me sa duket ka pasur funksionin e shprehjes së numrit shumës dhe kështu është shtuar në fund[1].

Historikisht kufijtë e Palestinës kanë qenë në ndryshim të vazhdueshëm kohë pas kohe, megjithëse në përgjithësi ajo përfshinte territorin tokësor midis Mesdheut, Detit të Vdekur dhe Lumit Jordan. Ndërsa, përsa i përket kufijve të saj të sotëm, ato u caktuan më vonë gjatë epokës imperialiste britanike dhe për të qenë më të saktë kjo gjë ndodhi gjatë viteve 1920-1923.

Gjatë Epokës Islame Bilad el-Shami u nda në axhnad (njëjësi i kësaj fjale është xhund që do të thotë pjesë). Pjesa palestineze shtrihej nga pjesa egjiptiane e Sinait dhe arrinte deri në qytetin e El-Lajunit, që ndodhet tetëmbëdhjetë kilometra në veri të Xheninit.

Pavarësisht nga këto ndarje që ndryshonin kohë pas kohe. Palestina mbeti një pjesë e brendshme dhe besnike e vendeve të Shamit dhe në përgjithësi e të gjithë umetit musliman. Sipërfaqja e saj totale sot është 27 009 km2.

Palestina ka një klimë të butë mesdhetare, gjë që është një factor favorizues për një vendosje të përhershme të vendasve aty dhe po ashtu kjo favorizon njëkohësisht dhe prodhimin bujqësor.

Territori tokësor palestinez mund të ndahet në tre zona të mëdha, të cilat janë: fushat bregdetare, zona e mesme malore si dhe vargmali jordanez. Nga të tre këto zona të mëdha, zona më e populluar është ajo e fushave bregdetare. Kjo ndodh pasi në këtë zonë ndodhen portet detare, qendrat bujqësore si dhe qendrat e ekonomisë dhe të tregtisë.

Zona e mesme malore përfshin rrafshnaltën e Negevit (El-Nakab),

---

[1] Për më tepër detaje rreth historisë së vjetër te Palestines shih Muhamed Abdul-Amir "Urubat Filistin fi Tarikh (Bejrut, 1972) dhe Marashli Ahmed "Al-Mawsuah Al- Falastinija" (Enciklopedia Palestineze) Damask, 1984. Vol 1. fq.37, Vol.3 fq.273-279 dhe Vol. 4, fq. 174.

vargjet malore të Galilesë (El-Xhelil), Samarias (Nablusi) dhe Hebronit (El-Khalil). Mali më i lartë i kësaj zone është mali Meron (El-Xhermek), i cili arrin gjatësinë 1207 m dhe ndodhet në pjesën veriore të Palestinës. Që në kohët e hershme fshatarët kanë jetuar në këto vende malore dhe janë marrë me rritjen e gjedhit, kanë kultivuar bimë të ndryshme bujqësore, fruta dhe zarzavate.

Në vargmalin jordanez, nga ku lumi Jordan shtrihet dhe zgjatet për të kaluar në detin e Vdekur, gjendet dhe vendi më i ulët në botë. Ai ndodhet 400 metra nën nivelin e detit. Klima e tij e ngrohtë dhe e qëndrueshme e ka bërë këtë vend të famshëm për mbjelljen e palmave, bananeve dhe perimeve të ndryshme.

### Statuti i Palestinës në fenë islame

Fakti se kjo tokë është një tokë e shenjtë për muslimanët është bërë shumë i qartë në Kuran dhe jepet nëpërmjet ajeteve të mëposhtme:

**"O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që Allahu ua ka caktuar e mos u ktheni prapa, se atëherë do të ktheheni tëhumbur."[2]**

**"Qoftë lavdëruar Ai, i Cili në një çast të një nate, e barti robin e Tij (Muhamedin) nga Tempulli i shenjtë (Meka) në Tempullin e largët (Jeruzalemi), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i dëftuar atij disa nga mrekullitë Tona. Me të vërtetë që Ai dëgjon dhe sheh çdo gjë."[3]**

**"Dhe i kemi dhënë Sulejmanit erë të fortë, që të fryjë sipas urdhrit të tij, kah toka, të cilën Ne e kemi bekuar. Ne jemi në dijeni për çdo gjë".[4]**

[2] Sure El-Maide, 21.
[3] El-Isra, I.
[4] Al-Enbija, 81.

Në territorin palestinez gjendet xhamia Al-Aksa, e cila është kibla (vend-drejtimi i faljes) e parë për muslimanët si dhe vendi i tretë i shenjtë për nga rëndësia. Vizita e këtij vendi të shenjtë është e pëlqyeshme dhe falja në këtë vend ka vlerë të barabartë me pesëqind falje në xhamitë e tjera.

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "Njeriu nuk merr ndonjë udhëtim përveçse në tri xhami; në xhaminë e shenjtë (në Mekë), këtu në xhaminë time (në Medine) dhe në Mesxhid El Aksa (në Kuds)".[5]

Në një hadith tjetër, ai ka thënë: "Namazi në xhaminë e shenjtë (në Mekë) është i vlefshëm sa njëqind mijë namaze në ndonjë vend tjetër. Namazi në xhaminë time (në Medine) është i barazvlefshëm me njëmijë namaze, falur diku tjetër. Një namaz në Bejt El Makdes (në Kuds) është i barazvlefshëm me pesëqind namaze diku tjetër".[6]

Palestina është atdheu dhe djepi i profetëve. Kurani përmend shume emra profetësh si; Ibrahimi (Abrahami), Luti, Ismaili (Ishmail). Is haku (Isak). Jakubi (Xhakob), Jusufi (Xhosef), Daudi (David). Sulejmani (Solomon), Salihi, Zekerija (Zakaria), Jahja (Gjoni) dhe Isa (Jezusi) paqja dhe mëshira e Zotit qoftë me të gjithë ata!

Ata kanë jetuar të gjithë në Palestinë dhe po ashtu dhe profeti ynë i fundit Muhamedi (a.s.) e ka vizituar këtë vend. Profetë të ndryshëm, të dërguar tek Benu Israilët që nuk janë përmendur me emra në Kuran, po ashtu kanë jetuar në këtë tokë të bekuar. Njëri nga këta profetë, që përmendet në një hadith sahih është Joshua.

Po ashtu Palestina është vendi, të cilin Allahu i Madhëruar e nderoi duke dërguar në të për vizitë profetin tonë, Muhamedin (a.s.), gjatë udhëtimit të natës së Israsë. Udhëtimi i Profetit vazhdoi nga xhamia Al-Aksa deri lart në qiell (Mirazhi).

Të gjithë profetët janë falur në xhaminë Al-Aksa dhe ata i ka prirë në falje Muhamedi (paqja qoftë me të!). Ky veprim është një shenjë e vazhdimësisë së teuhidit (njëshmërisë së Zotit), i cili ka qenë mesazhi i të gjithë profetëve. Po ashtu falja e të gjithë profetëve se

[5] Transmeton Buhariu, Muslimi, Iben Maxhe dhe Ebu Daudi.
[6]Transmeton Tabaraniu.

bashku, të prirë nga profeti i fundit tregon transformimin e trashëgimisë së tyre si dhe thirrjen për teuhid drejtuar të gjithë muslimanëve anembanë botës.

Në një hadith të vërtetë thuhet se: "Bejt Al-Makdesi (Xhamia Al-Aksa) është toka e ringjalljes dhe vendi i llogarisë."[7]

Ndërsa në një hadith tjetër të vërtetë, autentik, thuhet se Bilad el-Shami, pjesë e brendshme e së cilës është dhe Palestina: “është një mbrojtës i Islamit[8], qendër e imanit (besimit) gjatë kohërave të vështira krizash dhe kaosi".[9]

Ai që qëndron në Palestinë, i motivuar për shkaqe që kanë të bëjnë me fenë islame është i ngjashëm me një muxhahid apo me një luftëtar që ka dalë me gjithçka disponon në rrugë të Zotit.

Kjo gjë konfirmohet nga një hadith i treguar nga Tabaraniu, në të cilin thuhet: "Banorët e Shamit, bashkëshortet e tyre, bijtë dhe skllevërit e tyre të gjithë janë luftëtarë në rrugë të Zotit. Kush prej tyre arrin të marrë ndonjë nga qytetet apo fortesat e këtij vendi, është një muxhahid"[10]

Në një hadith tjetër, të treguar nga imam Ahmedi, thuhet se: "Grupi i vërtetë që i takon triumfi është ai që jeton në Sham, veçanërisht në Bejt-Al-Makdes (Xhaminë Aksa) dhe rrethinat e saj".[11]

Pra nuk është i çuditshëm apo i pakuptueshëm fakti që muslimanët kanë një lidhje të fortë sentimentale me këtë vend të shenjtë dhe të bekuar. Po ashtu nuk është gjë e habitshme se ata e mbrojnë këtë vend me gjakun dhe shpirtin e tyre..

## Palestina në histori

Prova të shumta arkeologjike kanë vërtetuar se jetesa në tokën

---

[7] Hadith i vertete (*sahih*), i transmetuar nga imam Ahmedi në Musnedin e tij dhe Iben Maxhe në Sunan.

[8] Hadith i vertete (*Sahih*), transmetuar nga Hakimi dhe Ebu Al-Naimi.

[9] Hadith i vertete (*Sahi*h), transmetuar nga Tabaraniu.

[10] Transmeton Tabaraniu.

[11] Transmeton imam Ahmedi.

palestineze ka filluar që në lashtësi, në Epokën e Gurit (50000-14000 per). Në këtë vend janë ngritur civilizime të njohura si civilizimi Natufian gjatë mesit të Epokës së Gurit (14,000-8,000 p.e.r).

Rreth vitit 2500 Kananët emigruan në masë të gjerë nga Arabia për në Palestinë dhe rrjedhimisht u bënë vendasit e kësaj toke. Ata themeluan rreth 200 qytete dhe fshatra në Palestinë, ku përmendim Beisan (Beit Shin), Askalan (Askelon), Akka (Acre), Haifa, Al-Khalil (Hebron), Asdud, Bir Al-Saba (Beersheba) dhe Bejt Lahm. (Bethlehem).[12]

Historanë të dëgjuar e me reputacion dëshmojnë se pjesa më e madhe e palestinezëve të sotëm, e në mënyrë të veçantë fshatarët, e kanë origjinën dhe janë pasardhës të Kananëve, Amortëve, Filistinëve dhe fiseve arabe. Ata u vendosën në këtë vend para dhe pas përhapjes në masë të Islamit në këto zona.

Faktikisht ata janë të gjithë të arabizuar dhe të islamizuar dhe formojnë një popullsi të bashkuar homogjene, që me vullnet të lirë e pranoi fenë islame si praktikë të jetës së tyre private dhe publike për një periudhë të vazhdueshme që zgjati rreth trembëdhjetë shekuj.

Profeti Ibrahim (a.s.) ishte i pari që solli në këtë tokë të bekuar flamurin e teuhidit dhe kjo ndodhi rreth vitit 1900 p.e.r. Po ashtu, ai u miqësua me Malik Sadikun i cili ishte udhëheqësi i Jeruzalemit dhe mesa duket ishte një besimtar.

Babai i profetëve, Ibrahimi (a.s.), u mirëprit me entuziazëm nga populli palestinez dhe vazhoi të jetonte dhe të përhapte aty mesazhin e teuhidit. Gjatë gjithë jetës së tij në këtë vend e deri sa vdiq ai nuk hasi asnjë vështirësi në kryerjen e detyrës së tij të thirrësit. Qyteti në të cilin ai jetoi mban emrin "El-Khalil". Bijtë e tij, edhe ata profetë, vazhduan në gjurmët e mesazhit të babait të tyre, Ibrahimit. Ndër ta përmendim Ismailin në Mekë, ndërkohë që Ishaku dhe djali i tij Jakubi (i cili njihet me pseudonimin Izraeli) qëndruan në Palestinë. Dymbëdhjetë bijtë e Jakubit që njihen si Benu Israilët (Izraeliët)

[12] Shih "Al-Mawsuah al-Falastinijah" (Enciklopedia Palestineze). Vol.3. fq.271-79 dhe 666-70.

emigruan për në Egjipt, ku u shtypën egërsisht nga Faraonët që sundonin atje.

Në shekullin XIII (p.e.r) Zoti dërgoi profetin Musa që ti shpëtonte ato fise nga kjo zgjedhë e egër dhe e asgjësoi Faraonin bashkë me ushtarët e tij. Megjithatë, Benu Israilët, të cilët ishin mësuar me nënshtrimin dhe ishin frikacakë, refuzuan që të shkonin me të në tokën e shenjtë, duke thënë ashtu si citohet në Kuran se: **"O Musa! Ne kurrë nuk hyjmë në të derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, se ne po rrimë këtu!"**[13]

Profeti Musa (a.s.) nuk jetoi për të realizuar ëndrrën e tij dhe vdiq përpara se të hynte në Palestinë. Pas dyzet vjet endjesh nëpër shkretëtirën e Sinait u arrit të formohej një brez i devotshëm dhe i guximshëm. Ky brez arriti që, nën udhëheqjen e profetit Usha (Xhoshua) bin Nun, rreth vitit 1190 p.e.r, të gjejë rrugën e tij përgjatë lumit Jordan për në Palestinë.

Brenda një kohe të shkurtër në mesin e Benu Israilëve shpërtheu kaosi, mosmarrëveshjet dhe shthurja morale, gjëra të cilat mbizotëruan në shoqërinë e tyre për 150 vjetët pasues. Më pas, me ardhjen e mbretit të tyre të fuqishëm, Talutit (Sauli), gjendja e tyre u përmirësua dhe ata arritën të mposhtnin armiqtë dhe kundështarët e tyre.

Dalja në skenë e Daudit (Davidit), të cilit Zoti i dhuroi mbretërimin rreth viteve 1004 p.e.r, ishte një sinjal domethënës se një epokë e re po afronte për shndritjen e teuhidit në tokën e shenjtë. Ai i mposhti jobesimtarët dhe mori kontrollin e tërë territorit të Palestinës, përveç sipërfaqeve bregdetare. Rreth vitit 995 p.e.r ai e transferoi kryeqytetin e Palestinës në Jeruzalem. Djali dhe pasuesi i tij, Sulejmani a.s. (Solomoni), ishte një mbret tepër i fuqishëm dhe me prestigj të lartë. Sundimi i tij rreth viteve 963-923 p.e.r ishte një epokë e re një zhvillimi të paparë dhe një begatie të madhe për Palestinen. Vitet e sundimit të mbretit Daud dhe birit të tij Sulejman ishin tetëdhjetë vjet të arta për thirrësit e teuhidit në Palestinë përpara se banorët e saj të pranonin Islamin.

[13] El-Maide, 24.

Pas vdekjes së Sulejmanit, mbretëria e tij u nda në dy shtete armike me njëra tjetrën. Shteti i parë që njihej me emrin "Mbretëria e Izraelit" u themelua në pjesën veriore të Palestinës gjatë viteve 923- 721 p.e.r. Kjo mbretëri ishte aq e korruptuar dhe në kaos të plotë, saqë në Enciklopedinë Britanike ajo cilësohet me neologjizmën poshtëruese si "Mbretëria Bisht" (Tail Kingdom).

Përfundimisht kjo mbretëri u shtyp nga asirianët, nën udhëheqjen e mbretit të tyre Sargoni II, i cili i detyroi izraelitët të emigronin për në Sirinë Veriore, Irak dhe Persi. Në vend të tyre ai solli disa grupe me popullsi armenase. Ndërsa mbretëria e dytë njihej si "Mbretëria e Judeas" dhe për periudhën nga viti 923-586 p.e.r kryeqytet kishte Jeruzalemin, por, gjithsesi, edhe kjo mbretëri ishte e dobët dhe binte vazhdimisht pre e pushtimeve të huaja. Gjatë fundshekullit X-të p.e.r kjo mbretëri u drejtua nga Faraoni i Egjiptit Sheshonku (Sheshonq). Më pas palestinezët kishin drejtimin e saj gjatë periudhës së sundimit të mbretit çifut (Mbreti Jahuramit) në vitet 849-842 p.e.r, ndërsa asirianët ishin ata që i detyruan sundimtarët e këtij vendi të paguanin xhizjen. Përfundimisht ky qytet ra në vitin 586 p.e.r në duart e udhëheqësit babilonas Nebukadnezar, i cili e pushtoi Jeruzalemin, e shkatërroi Tempullin dhe skllavëroi dyzet mijë çifutë. Shkrimet e shenjta hebreje i përmendin mëkatet e izraelitëve për shkak të të cilave merituan të dënohen dhe të shkatërrohej mbretëria e tyre. Në to jepet një thënie nga një prej profetëve të tyre Ashaijah, ku thuhet:

Mjerë ti o komb mëkatar!

Onjerëz të ngarkuar me ligësi!

Osoj keqbërësesish! Bijtë e atyre që janë të korruptuar!

Ata e kanë braktisur Zotin,

Ata kanë provokuar Izraelin e shenjtë.

Ata e kanë braktisur duke i kthyer kurrizin...

(Libri i Isaias, 1.4)

Në një vend tjetër në Shkrimin e Shenjtë shkruhet:

Toka nën banorët e saj është e fëlliqur. Pasi ata kanë shkelur urdhëresat

Kanë ndryshuar urdhrat

Dhe kanë thyer marrëveshjen e përjetshme

(Libri i Isaias, 24: 4,5.)

Kështu pra që sundimi i izraelitëve ka zgjatur vetëm për katër shekuj, gjatë të cilëve autoriteti i tyre nuk i ka përfshirë të tërë territoret palestineze. Zakonisht kjo mbretëri ka qenë e dobët dhe është bërë pre e dominimeve të fuqive të huaja fqinje. Pavarësisht nga kjo, populli i Palestinës; kananët dhe të tjerët, asnjëherë nuk u larguan nga vendi i tyre gjatë shekujve të vështirë kur konflikte të ndryshme shpërthyen në tokën e tyre.

Me pas perandori persian Cyrus (Sairusi) i lejoi çifutët që të kthehen në Palestinë, por vetëm një numër i vogël prej tyre u rikthye për të jetuar së bashku me palestinezët. Gjatë periudhës së viteve 539- 332 p.e.r, rajoni i Jeruzalemit pati një lloj vetëudheheqjeje nën pushtetin e Persisë. Pas Persisë ky vend kaloi nën pushtetin e grekëve (332-63 p.e.r).

Qe nga viti 164p.e.r çifutet kaluan nëpër periudha vetëqeverisjeje, ndërkohë që format dhe territoret përfshirëse në këtë vetëqeverisje ndryshonin kohë pas kohe. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ekzistonte dhe një konkurencë midis superfuqive për sa i përket Palestinës.

Gjatë periudhës që Palestina ndodhej nën pushtetin romak, gje që ndodhi gjatë vitit 63 p.e.r, u vendos një ligj, të cilit i nënshtroheshin të gjitha territoret palestineze. Me anë të kësaj mënyre qeverisjeje, romakët hodhën poshtë mënyrën e vetëqeverisjes së ngritur nga çifutët në Jeruzalem. Për këtë çifutët u ngritën në dy revolta të fuqishme. E para ndodhi gjatë viteve 66-70, ndërsa e dyta gjatë viteve 132-135 të erës sonë, por që të dyja këto revolta u shtypën egërsisht nga romakët. Ai që shtypi revoltën e parë ishte Titusi, i cili shkatërroi edhe Tempullin, ndërsa revoltën e dytë e shtypi Sefrusi, i cili e pushtoi tërësisht Jeruzalemin.

Perandori romak Adrian themeloi një qytet të ri mbi rrënojat e këtij të fundit dhe i dha emrin Aelia Kapitolina. Çifutëve iu mohua kategorikisht e drejta për të hyrë në Jeruzalem për 200 vitet që pasuan[14]".

Po ashtu numri i çifutëve gjatë kësaj periudhe dhe për rreth tetëmbëdhjetë shekujt e mëvonshëm ka qenë relativisht i ulët. Por, nga ana tjetër, vërehet se numri i kan anëve, banorëve autoktonas të kësaj toke, dhe fiset arabe të cilat u asimiluan nga ata vazhduan të qëndrojnë pa shkëputje në Palestinë para dhe pas prezencës së çifutëve në këtë vend. Kjo gjë vazhdon edhe sot.

## Palestina nën pushtetin islam

Perandoria Bizantine e cila sundoi pjesën lindore të Perandorisë Romake që nga viti 394, futi nën pushtetin e saj edhe Palestinën, e cila përveç pak kohe që qëndroi nën pushtetin persian, pjesën tjetër të kohës qëndroi me bizantinet. Por në vitin 636 e.r, i cili përkon me vitin 15 të Hixhretit, gjatë të cilit sundonte kalifi Umer ibn ElHatab, Palestina iu bashkua Kalifatit Islam, përqafoi Islamin dhe popullsia e saj u arabizua tërësisht.

Identiteti i njerëzve dhe tokës palestineze u ruajt tërësisht edhe gjatë kohës së kryqëzatave. Megjithëse ishte plotësisht e dobët dhe e shtyrë në mbrojtje, mbretëria e krishterë e Bejt El-Makdisit i mbijetoi për rreth 80 vjet (1099-1187) sulmeve të vazhdueshme ushtarake, të udhëhequra nga komandantët muslimanë, ku përmendim udhëheqësin e shquar Nuredin Mahmud Zinki. Megjithatë mbretëria e krishterë do të rrëzohej më në fund nga heroi musliman Salahudin El-Ejubi.

[14] Për më shumë detaje për historinë e vjetër të Benu Israilëve, shih veprën e Zafar Al- Islam Khan, "*Tarikh Falastin al-Qadim" (Historia e vjeter e Palestines) 1220 B.C 1359 A.D.: Munzu Awwal Ghazu Jahudi hata Akhir Ghazu Salibi* (Bejrut, 1984) dhe *"Al-Mawsu'ah al-Falastiniyyah"* (Enciklopedia Palestineze) Vol.1, fq. 238. Vol: 3. fq.184-86, 266-68 dhe Vol.4, fq. 16-18.

Sundimi prej 12 shekujsh që muslimanët patën mbi Palestinën përfundoi në vitin 1917. Ai ka qenë sundimi më i gjatë dhe mbresëlënës në të gjithë historinë e këtij vendi. Njëkohësisht ky sundim nuk ka cënuar asnjë prej besimeve të tjera që kanë ekzistuar në këtë territor. Pushteti gjatë asaj kohe ka qenë tolerant në raport me fetë e tjera, duke mundësuar në këtë mënyrë bashkëjetesën me to. Kujtimi i muslimanëve që i kanë shërbyer tokës së shenjtë, mbrojtja e kësaj toke dhe shenjtërisë së saj është një veprim që ia vlen të vlerësohet.

Sundimi i pushtetit islam në Palestinë u konsolidua nëpërmjet përpjekjeve të shokëve të Profetit Muhamed (a.s.), të cilët u vendosën përgjithmonë në tokën e shenjtë dhe dhanë një ndihmesë të konsiderueshme dhe tepër të rëndësishme gjatë përhapjes së mesazhit islam në vend. Ndër ta përmendim Ubejde ibën Al-Samit, Shaddad ibën Aus, Usame ibën Zejd ibën Haritha, Uathilah ibën Al-Aska, Fairuz Al- Dejlemi, Dija Al-Kalbi, Abdurrahman ibn Ganam, Thu al-Asabi Al- Tamimi, Abu Ubej ibën Haram Al-Ansari, Unejf ibën Mileh Al-Xhudhami, Abu Rauajha Al-Fazai. Aus ibën Al-Samit, Masud bin Aus ibën Zejd, Zinbaa bin Ruh, Suejd ibën Zejd dhe të tjerë, të cilët jetuan dhe u varrosën në token e shenjtë.

Ndër tabiinët (brezi pasardhës i shokëve të Profetit) palestinezë më të famshëm përmendim Raxha ibën Hajuah Al-Kindi që jetoi në Bisan dhe këshilloi Sulejman ibën Abdul-Malikun që tia kalonte kalifatin Umer ibën Abdulazizit. Po ashtu, përmendim dhe Ubadah ibën Nusai Al-Kindin dhe Rauh ibën Zinba. Në mesin e tabiinëve që jetuan në Palestinë ishin edhe Malik ibën Dinar, Al-Auzai, Hani ibën Kalthum, Hamed ibën Abdullah Al-Lakhmi, Sufjan Al-Thauri dhe Ibën Shihab Al- Zuhri.

Teologu i shquar musliman imam Shafiu ka lindur në Palestine dhe pikërisht në qytetin e Gazës. Ndër dijetarët më të shquar muslimane që kanë vizituar apo kanë jetuar në Palestinë janë po ashtu edhe Ibrahim iben Edhem, Al-Lajth ibën Sead, Ebu Bekër Muhammed Al-Tartoushi, Ebu Beker Al-Xhurxhan dhe Ibën Kuddame Al-Makdisi.

Në mesin e heronjve të shquar muslimanë, komandatëve ushtarakë dhe dijetarëve të shquar ka qenë edhe Fatihu nga Andaluzia,

Musa ibën Nusejr Al-Lakhami, mjeshtëri i letërsisë dhe veprave letrare, shkrimtari Abdulhamid ibën Jahja Al-Katib dhe kimisti dhe studiuesi musliman Khalid ibën Jazid al-Umaui.

Me pak fjale Palestina ka qenë një qendër e spikatur e civilizimit islam dhe ka tërhequr shumë dijetarë muslimanë. Po ashtu bijtë e kësaj toke kanë luajtur një rol të madh e me ndikim në rilindjen e umetit musliman.[15]

## Pretendimet fetare dhe historike të çifutëve për Palestinën

Çifutët dhe mbështetësit e tyre i mëshojnë idesë së pushtimit të tokave palestineze dhe mbrojnë të drejtën që ata kanë edhe për pushtimin aktual të tyre me anë të disa pretendimeve historike dhe fetare. Ata theksojnë faktin se gjatë një periudhe të caktuar ata kanë jetuar dhe kanë sunduar në këtë tokë si dhe janë të lidhur me këtë vend përmes një lidhje historike dhe shpirtërore.

Në të vërtetë, çifutët duhet të kenë liri të plotë fetare dhe askush nuk ka të drejtë ti detyrojë ata të ndryshojnë besimin dhe parimet e tyre. Por është e papranueshme dhe e pavend që ata, të shtyrë nga pretendimet e tyre fetare, të dëbojnë dhe të nxjerrin jashtë trojeve të tyre një popullsi të tërë duke i konfiskuar tokën, pasurinë dhe vendet e shenjta.

Nga ana tjetër, muslimanët kanë bazat e tyre të forta, ku mbështesin tezën e tyre kundër pretendimeve te mësipërme të hebrenjve. Ata kanë një besim të patundur se Zoti u ka dhënë Benu Israilëve këtë tokë, me kusht që ata të pranojnë parimin e teuhidit nën udhëheqjen e

[15] Per me shumë detaje rreth sahabéve, tabunëve dhe muslimanëve të tjerë të mëdhenj që kanë jetuar në Palestine, shin Dija al-Din Muhammed al-Makdisi (botuar nga Muhammed Mutee Hafiz). Fadail Bayt al-Maqdis, (Vlerat e Kudsit) *Silsilat Fadail al- Sham*, (Vargu i mirësive te Shamit) Nr. 2 (Damask, 1985), fq.90-92 dhe dy librat e Mustafa Murad al-Dabag, "*Al-Kabail al-Arabija wa Salailuha fi Biladina Falastin*" (Bejrut, 1979), fq. 47-48, 111-113. 138-140 dhe 188, che "*Min Huma na Hanak*". fq 80-83 dhe 112.

profetëve të tyre dhe udhëheqësve fetarë. Por, duke pasur parasysh faktin se çifutët kanë qenë përgjegjës për vrasjen e disa profetëve, devijimit nga mesazhi hyjnor si dhe përhapjes së korrupsionit në tokë, atëherë ata kanë humbur një herë e përgjithmonë të drejtën dhe legjitimitetin mbi tokën e shenjtë.

Nga ana tjetër, duke qenë se muslimanët janë i vetmi popull që i qëndruan me vendosmëri zbatimit të urdhërave të Zotit, ata janë bërë automatikisht trashëgimtarët e vërtetë e të vetëm dhe legjitimë të teuhidit. Thinja islame është në thelb një vazhdimi mesazhit të teuhidit, të përhapur nga profetët Ibrahim (Abraham), Ishak (Isak), Jakub (Jakob), Ismail (Ishmael), Musa (Moisi), Daud (David), Sulejman (Solomon) dhe Isa (Jezus).

Kjo çështje është padyshim e lidhur me kombësinë dhe më së tepërmi me parimet hyjnore të paraqitura në ajetet e mëposhtme kuranore:

**"Ibrahimi nuk ka qenë as hebre as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë** (monoteist) **i përulur ndaj Allahut** (musliman) **dhe nuk ka qenë nga idhujtarët. Më të afërmit e Ibrahimit, janë ata njerëz, që e pasuan atë dhe ky Profet** (Muhamedi) **me besimtarët** (e tij). **Allahu është mbrojtës i besimtarëve".**[16]

**"Ibrahimi u dha këtë porosi fëmijëve të tij, po ashtu edhe Jakubi: "O bijtë e mi! Allahu me të vërtetë ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë!"**[17]

**"Dhe kujtoni, kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhëra, e ai i plotësoi ato. Allahu tha: "Unë do të bëj ty imam** (prijës) **të njerëzve!" "Po për pasardhësit e mi!" - pyeti ai.** (Allahu)

[16] Al-Imran, 67, 68.
[17] El-Bekare, 132.

**Tha: "Premtimi Im nuk i përfshinë zullumqarët të padrejtët."**[18]

Zoti ia ka bërë shumë të qartë Ibrahimit (paqja qoftë me të) se çështja e udhëheqjes duhet të jetë një çështje tërësisht e mbyllur brenda. rrethit të pasardhësve të tij. Po kështu, kjo çështje, pra udhëheqja, nuk duhet tu kalojë kurrë shtypësve dhe tiranëve.

Megjithatë, nëse shpallja e kësaj udhëheqjeje është një çështje që ka të bëjë me pasardhësit, atëherë përse duhet që izraelitët ta mbyllin këtë ligjshmëri mbi trashëgiminë e Ibrahimit vetëm për veten e tyre dhe tua mohojnë këtë të drejtë arabëve Adnani. Këta të fundit janë të lidhur përmes stërgjyshit të tyre, Ismailit, drejtpërsëdrejti me Ibrahimin (as). me të cilin Kurejshët dhe profeti Muhamed janë po aq të lidhur ngushtë.

Pretendimet historike të izraelitëve mbi Palestinën janë të pabaza. Ata kanë pasur nën udhëheqjen e tyre vetëm disa pjesë të Palestinës dhe kjo ka ndodhur për një afat kohor vetëm prej katër shekujsh. Ndërsa dominimi musliman i tërë territoreve të shenjta të Palestinës ka zgjatur dymbëdhjetë shekuj (636-1917), duke përjashtuar periudhat e shkurtëra të kryqëzatave. Për më tepër çifutët braktisën Palestinën dhe lidhja e tyre me të është ndërprerë për rreth tetëmbëdhjetë shekujsh, që nga viti 135 e.r deri në shek. XX.

Nga ana tjetër, palestinezët vendas nuk janë larguar asnjëherë nga Palestina gjatë 4,500 viteve të fundit, deri në momentin kar shumë prej tyre u dëbuan me forcë në vitin 1948 nga uzurpuesit çifutë. Megjithatë, ata kurrë nuk e dorëzuan tokën e tyre dhe ende edhe sot po vazhdojnë ta mbrojnë atë e po përpiqen me të gjitha mudësitë për tia kthyer territoret e rrëmbyera popullit të tyre.

Përveç kësaj, ashtu siç paraqitet nga disa studiues dhe kërkues çifutë, 80% e popullsisë së sotme hebreje nuk kanë lidhje të asnjë lloj forme etnike apo historike me fisin Benu Israil apo me Palestinën. Në mesin e këtyre studiuesve është dhe shkrimtari i njohur Artur Koestler, i cili ka shkruar librin me titull "The Thirteenth Tribe: The

[18] El-Bekare, 124.

Khazar Empire and its Heritage" (Fisi i trembëdhjetë: Perandoria Khazare dhe trashëgimia e saj).

Pjesa më e madhe e çifutëve të sotëm janë pasardhës të çifutëve të "Khazarit", të cilët e kanë origjinën tek disa fise të hershme turko- tartare që kanë jetuar në rajonin e Kaukazit, në pjesën jugore të Rusisë. Gjatë shekullit VIII ata u judaizuan nën sundimin e mbretit të tyre Bulan. Por mbretëria e tyre shumë shpejt ra dhe banorët e kësaj mbretërie emigruan në Rusi dhe nëpër Europën Lindore për të formuar atë grup që tashmë njihet si grupi i çifutëve Ashkenaz[19]. Pra, nëse ata kanë të drejtë të kthehen në ndonjë vend, ai vend është Rusia Jugore.

## Prapaskenat e çështjes palestineze në historinë moderne

Ashtu siç u tha edhe më sipër, përveç disa ndjenjave fetare të paqarta, çifutët nuk kanë pasur asnjë lidhje të fortë me Palestinën gjatë 18 shekujve të kaluar. Mëkatet e tyre mizore gjatë gjithë kësaj periudhe historike i kanë shtyrë udhëheqësit e tyre shpirtërorë që të udhëheqin në mënyrë të tillë që ta paraqesin si të merituar gjendjen e vështirë në të cilën ata ranë. Po ashtu, si pasojë e veprimeve të tyre, ata ishin të detyruar të qëndronin në mërgim, në pritje të ardhjes së Mesias, i cili do ti udhëhiqte drejt rikthimit dhe rivendosjes në shtetin çifut në Palestine.

Disa zhvillime të rëndësishme në Europë patën një ndikim të thellë në aspiratat e çifutëve dhe në të gjithë projektin zionist. Kjo ka të bëjë më së tepërmi me emergjencën që pati në shekullin XVI Lëvizja Reformuese Protestante që u bë më e njohur se kudo në Britani, Amerikë, Holandë dhe në gjysmën e Gjermanisë. Udhëheqja protestante bazohej në Testamentin e Vjetër, sipas të cilit çifutët e përhapur nëpër botë konsiderohen si banorët vendas të Palestinës. Sipas këtyre shkrimeve ata do të rimblidheshin në këtë tokë të shenjtë, në pritje të

[19] Per informacione rreth "Khazar Jews", shih Asma Fauur, "*Falastin wa al-Mazer im al-Jalmedija*" (Palestina dhe pretendimet hebreje), (Bejrut, 1995), fq. 235-241.

rikthimit të Mesias që do ti bënte ata të krishterë dhe do të fillonte një epokë e re njëmijëvjeçare lumturie në botë (kjo njihet si Mileniarizmi).

Kështu u shfaq ai që njihet si "Zionizmi joçifut", i cili u përkrah nga protestantët që mbështetën projektin çifut për tokat e shenjta.[20]

Për më tepër, Europa ishte dëshmitare e zhvillimeve të mëdha politike që ndodhën gjatë shekullit XIX. Nevoja e ngutshme e shteteve laike moderne për ta ndarë politikën nga feja, u shtua që me shpërthimin e Revolucionit Francez në 1789. Po ashtu nocionet nacionalizëm dhe patriotizëm filluan të dominojnë dukshëm në skenën europiane.

Në këtë atmosferë "lirie" çifutët u "liruan" dhe atyre iu garantuan të gjitha të drejtat e qytetarisë, veçanërisht në Europën Perëndimore. Ky lloj qetësimi i situatës u dha atyre shansin e vetëm për të depërtuar brenda këtyre regjimeve laike dhe për të promovuar qëndrimin e tyre social, ekonomik dhe politik në shoqëritë perëndimore.

Ndërkohë, nacionalizmi dhe patriotizmi në Rusi dhe në Europën Lindore mori një kthesë tjetër. Çifutët, të cilët ishin të përqendruar në këto territore u bashkuan me lëvizjet revolucionare radikale kundër carit të Rusisë dhe programeve të tij shtypëse dhe tiranike që kishin të bënin me modernizimin dhe asimilimin. Në këto rrethana dhe veçanërisht pas puçit çifut të organizuar për të vrarë carin, Aleksandrin e II, në vitin 1881, Rusia dhe Europa Lindore ushtroi një fushatë të dhunshme dhe të përgjakshme persekutimi kundrejt çifutëve. Ky antisemitizëm, i koduar kështu pasi çifutët i përkisnin races semitike, krijoi të ashtuquajturin "problemi çifut"[21]

Çifutët rusë me ankth kërkuan një operacion shpëtimi, ndërkohë që qindra mijëra prej tyre emigruan për në Europën Perëndimore, Amerikën e Jugut dhe atë Veriore. Koha dhe momenti ishin të përshtatshëm për Lëvizjen Zioniste që të shtonte fushatën e saj në ndihmë

---

[20] Për më shumë njohuri rreth kësaj teme, shih Rigina Al-Sharif (përkthyer nga Ahmed Abdullah Abdul-Aziz) *Al-Sahjumjah Ghajr Al-Jahudijah: "Zionizmi joçifut". Xhuzuruha fi al-Tarikh al-Gharbi*, Silsilat Alam al-Ma'rifah, Nr. 96 (Kuvajt, 1985).

[21] Për këtë temë shih Abdul-Wahhab al-Masiri, "*Al-Adilogivah Al-Sahjunijah*" (Ideologjia zioniste), Silsalat alam al-Marifah, Nr. 60-61 (Kuvajt, 1983). Vol. 1 fq, 89- 116, dhe Asad Abdul-Rahman, "*Al-Munazzamah al-Sahjunijah al-Alamijah 1882- 1892*" (Organizata Boterore Zioniste), (Bejrut, 1990), fq.23-26.

të zgjidhjes së "problemit çifut" me anë të krijimit të një bashkësie çifute në Palestinë. Shumë europianë dhe amerikanë e pëlqyen dhe e simpatizuan këtë thirrje. Kjo ndodhi si për arsye fetare, ashtu edhe për të ndaluar fluksin çifut në shtetet e tyre.

Shpërbërja e njëkohshme e Kalifatit Osman si dhe shtysa e shteteve europiane për të ndarë ndërmjet tyre territoret e kësaj perandorie siguroi një shtysë të re për krijimin e "projektit çifut". Në konferencën imperialiste të Londrës të vitit 1905-1907 u shfaq për herë të parë termi "shtet barrikade" që i referohej Palestinës dhe që aty ky term iu transmetua me të shpejtë kryeministrit britanik Kambell Banerman (Campbell Bannerman). Kjo ide në thelb ishte vendosja në pjesën lindore të Mesdheut të një bashkësie të huaj pro-perëndimore që do të strehonte një mburojë armike kundër (muslimanëve) popullsisë së këtij rajoni.[22]

Çifutët, pa dyshim, ishin vegla më e mirë për zbatimin e këtij projekti imperialist.

Në këtë mënyrë, faktori më i rëndësishëm për formimin e të ashtuquajturit "shtet barrikade" në zemër të botës muslimane ishte izolimi i anëve aziatike dhe afrikane nga njëra tjetra. Po ashtu, përmes këtij projekti, ata synonin ti shkëpusnin ose, nëse do të ishte e mundur, dhe të shtypnin çdo përpjkje për bashkimin e muslimanëve të këtyre vendeve.

Kjo bashkësi armike çifute ishte programuar që ta çonte umetin musliman në një mosmarrëveshje të gjatë dhe të ndërlikuar, e cila do të shteronte resurset e tij ekonomike dhe ushtarake e në këtë mënyrë do të çonte në paralizimin e vullnetit politik përballë Perëndimit dhesuperfuqive të tij.

Ndërsa Perëndimi garantonte vazhdimësinë e bashkësisë zioniste, mbijetesa e kësaj të fundit ishte një pikë kyçe për realizimin e qëllimeve imperialiste në këtë rajon. Për këtë arsye, muslimanët duhet ta kuptojnë mbështetjen e vazhdueshme të Perëndimit për Izraelin dhe aleancën jo të ndershme që nuk ka si synim të saj vetëm Palestinën, por tërë Umetin Musliman dhe aspiratat e tij për bashkim dhe zhvillim.

---

[22] *Shih Malaf Wathaik Falastin*. (Dosja e dokumenteve të Palestinës), përgatitur nga Ministria Egiptiane e Udhëheqjes Kombëtare (Kajro, 1969), Vol. I. fq. 121.

Perëndimi i krishterë pësoi vuajtje të shumta gjatë 11 shekujsh konfliktesh të stërgjata me shtetet e fuqishme muslimane. Kalifatët e njëpasnjëshëm muslimanë; Rashidinet, Umavitet, Abasitet dhe Mamluket, që të gjithë i kishin dhënë forca të reja umetit. Po ashtu, ata kishin ruajtur dinjitetin dhe integritetin e mbarë muslimanëve dhe, njëkohësisht, në mënyrë të efektshme, e kishin imponuar epërsinë e tyre mbi botën. Edhe Osmanët që erdhën pas Mamlukëve kanë qenë për shekuj të tërë mbrojtës dhe ruajtës të Islamit. Ata aneksuan pjesën më të madhe të Europës Lindore, bashkuan boten arabe nën kufijtë e tyre dhe mbrojtën umetin kunder invazionit kulturor perëndimor. Por erozioni i vazhdueshëm i pushtetit të tyre që nga shekulli XVIII i frymëzoi fuqitë imperialste europiane, dhe kjo veçanërisht gjatë shekullit XIX dhe XX, që të kërkonin mugë dhe mënyra që do të çonin në parandalimin e rigjallërimit te botes arabe. Ata ishin të gatshëm të përdornin edhe forcën nëse do të ishte e nevojshme për ta arritur këtë. Kësaj i shtohet edhe termi "shtet barrikade", i cili është kodi emëror për themelimin e një bashkësie zioniste në tokën palestineze.

## Zhvillimet politike të çështjes palestineze deri në vitin 1914

Pushtimi i shpejtë i Egjiptit nga ana e Napoleonit në korrik të vitit 1798 ishte një fakt bindës për fuqitë europiane rreth kushteve përfundimtare të "njeriut të sëmurë europian". Po ashtu kjo gjë u dha atyre shtysën dhe kurajon për të copëtuar osmanët në mes tyre. Pavarësisht nga disfata poshtëruese dhe katastrofale që pësuan francezët në portat e Akresë në vitin 1799, Napoleoni ishte i pari burre shteti europian që në 20 prill të vitit 1799 i ftoi zyrtarisht çifutët që të themelonin një bashkësi të tyre në territoret palestineze.[23]

Britania, e cila atëherë ishte nje superfuqi, ishte tepër e

[23] Rigina Al-Sharif, op.cit., fq. 106-10 dhe "*Al-Mawsuah al-Falastiniah*" (Enciklopedia Palestineze), Vol.2, fq.279.

vetëdijshme për rëndësinë tepër të madhe që paraqiste Egjipti dhe vendet e Shamit në lidhje me projektin e saj të madh për Lindjen e Mesme. Që në vitin 1838 u hap një konsullatë në Jeruzalem që u kthye në një parajsë për çifutët deri në momentin kur shpërtheu Lufta e Madhe në 1914.[24]

Në fakt, direktiva e parë që iu dërgua nga zyra e jashtme përfaqësuesit të konsullatës ishte sigurimi i mbrojtjes për të gjithë çifutët, pavaresisht nga shtetësia që ata kishin. Gjatë pushtimit të Qipros në vitin 1878 dhe më pas të Egjiptit në 1882, Britania u bë fuqia e vetme europiane që kishte baza ushtarake në Mesdhe. Por ajo i kishte ngulur sytë veçanërisht mbi Palestinën. Kjo vinte si rezulat i arsyeve fetare dhe historike që u përmendën më lart. Për më tepër, ai vend ishte i lakmuar dhe për pozitën tepër të favorshme mbrojtëse që kishte për Kanalin e Suezit dhe si rrjedhim dhe për pozitën strategjike të rrugëve komunikuese të kësaj perandorie me Indinë. Projekti zionist, i cili ishte i përqendruar në "shtetin barrikade" ishte ndërkaq i mbështetur dhe shfrytëzohej nga qeveria britanike. Kjo bëhej që kjo qeveri të përmbushte axhendën e saj imperialiste, fetare, kulturore, strategjike dhe politike në lidhje me këtë rajon.

Çifutët dhe zionistët i ishin përmbajtur pretendimeve të tyre për "rikthim" në tokën e shenjtë përpara fundit të shekullit XIX. Ky veprim ka lidhje me shekullin XVI, por më pas u formulua në një formë më të mirë dhe të gjallë në një libër të shkruar në vitin 1612 nga avokati britanik H.Finch. Ky libër përmban thirrje të ndryshme drejtuar çifutëve që të ktheheshin dhe të udhëhiqnin Palestinën.

Botimi i këtij libri u shoqërua me një mori literatuarsh të shkruara nga ana e të krishterëve si dhe nga intelektualët çifutë. Këtu mund të përmendim 4 shkrimtarë kristianë si Xh. Xh.Rusoi (1712-1778), Xh. Prisli. Shaftsbury dhe L. Olivent (1733-1804); dhe shkrimtarët hebrenj Isak Njutoni (1643-1727), Shabbetai Zvi (1626-1676), Judah Alkalai (1798-1878) dhe Moses Hess (1812-1875).[25]

[24] Albert Hyamson "*Palestine under the Mandate" 1920-1948* (Britani e Madhe.

[25] Methuen, 1950), fq.7 Rigina al-Sharif, op.cit.. fq.79-81 dhe Asad Abdul-Rahman, op.cit., fq. 27-30.

Por deri në këtë moment të historisë termi "rikthim i çifutëve" nuk ishte përdorur ende. Në vend të këtij termi më së shumti janë paraqitur ndjenjat fetare për ta vizituar këtë vend, për të jetuar afër tokës së shenjtë apo për të realizuar disa projekte "filantropike", që kishin të bënin me ngritjen e disa vendbanimeve atje. Në këtë kohë numri i çifutëve në Palestinë ishte relativisht i ulët në krahasim me popullsinë tjetër me origjinë arabe. Ky numër varionte nga 5000 që ishte në vitin 1799 në 13,920 në vitin 1876.

Acarimi i "problemit çifut" në Rusi bëri që që në vitin 1882 të shtohej emigrimi i çifutëve drejt Palestinës. Megjithatë, ky lloj fluksi u mënjanua në një farë mënyre nga masat që mori qeveria osmane dhe veçanërisht vendosja e një kontrolli të tyre të dretpërdrejtë administrativ në Jeruzalem në vitin 1887. Para kësaj Jeruzalemi ishte nën juridiksionin e zëvendësit të mbretit të Damaskut.[26]

Nga 2. 366 941 çifutë që u larguan nga Rusia dhe Europa Lindore vetëm 55.000 (2.32%) prej tyre emigruan për në Palestinë. Pjesa më e madhe e tyre shkuan në Amerikë, në Europën Perëndimore dhe në Amerikën e Jugut".[27]

Themelimi i Organizatës Botërore Zioniste nën udhëheqjen e Teodor Herzelit dhe konferenca e parë e mbajtur nga kjo organizatë në 27-29 gusht në Zvicër, çuan në fillimin e një fushate politike sistematike në lidhje me themelimin e një shteti çifut në tokën palestineze. Herzeli ndërmori një ofensivë tepër aktive diplomatike për të fituar mbështetjen e shumicës së fuqive botërore në lidhje me pretendimet çifute. Ai u përpoq që të fitonte në veçanti mbështetjen e Britanisë për "projektin çifut". Por oferta e tij "fitimprurëse" drejtuar sulltan Abdul-Hamidit (1876-1909) për tia shitur atij Palestinën dhe që ai më pas të themelonte në të një shtet çifut të vetudhëhequr nën juridiksionin osman, nuk u

[26] Hassan Halak, op. cit., fq.101-5.

[27] William Fahmi, "*Al-Hixhrah Al-Jahudijah ila Falastin*" (Emigrimi i çifutëve në Palestine), (Kajro, 1974), fq. 36. Sipas disa burimeve të tjera pretendohet se numri i emigrantëve çifutë gjatë periudhes 1882-1914 është ndërmjet 55 deri 70 000. Për më tepër shih Sabri Jiryes dhe Ahmed Khalifah "*Dalil Israel at-Am*", (Bejrut, 1996). fq.40.

pranua kategorikisht, pavarsisht nevojave të mëdha financiare që kishte Kalifati në ato momente.

Sulltan Abdul-Hamidi vazhdoi të mbante një qëndrim të hapur dhe të rreptë kundër projektit çifut dhe për këtë ai i jep një mesazh ndërmjetësit të Herzelit, i cili i paraqiti atij ofertën e bërë nga Herzeli. Ai i drejtohet Herzelit me këto fjalë:

“E këshilloj që të mos insistojë në këtë çështje. Unë nuk jam në gjendje të shes as edhe një pëllëmbë të kësaj toke, pasi ajo nuk më përket mua, por ajo i përket popullit tim. Populli im e themeloi dhe e mbajti këtë perandori me sakrifica dhe me gjak dhe po me gjak do ta mbrojmë nga ata që duan ta pushtojnë atë. Thuaju çifutëve që ti mbajnë miliardat për veten e tyre. Nëse do të vijë momenti që kjo perandori të shpërbëhet, atëherë ata do të mund ta marrin Palestinën pa paguar asnjë grosh. Por kjo gjë do të bëhet kur të kalohet mbi trupat tanë të vdekur. Prandaj une nuk do ta lejoj një gjë të tillë për asnjë lloj arsye".

Nuk ishte diçka e paimagjinueshme që çifutët të kishin pjesën e tyre në rënien tragjike të sulltan Abdul-Hamidit nga pushteti. Nëpërmjet ndikimit të tyre shumë të gjerë brenda rangut të "Xhon turqve" dhe krahut të tyre "Komiteti për Bashkim dhe Progres", ata planifikuan dhe arritën te realizonin goditjen e befasishme të vitit 1909 që rrëzoi nga pushteti sulltanin. Për ta bërë sa më fyese për sulltanin rrëzimin e tij nga froni, ata dërguan në delegacionin zyrtar që i kërkoi që të jepte dorëheqjen sulltanit, çifutin Emanuel Krasou, i cili më parë ishte përjashtuar nga pallati mbretëror për shkak të përpjekjeve të tij për të shitur Palestinen.

Në të vërtetë çifutët ushtruan nje ndikim të fortë mbi sunduesit e rinj që nga viti 1909-1914. Atyre iu dhanë tre ministi kyçe në kabinetin e vitit 1913 të kryesuar nga Xhon turqit (nga 13 kabinete që kishte gjithsej). Ndërsa arabëve që përfaqësonin gjysmën e popullsisë së perandorisë iu dha vetëm një post ministror në këtë kabinet.

Rezistenca palestineze kundër projektit zionist filloi që në vitin 1886, kur një grup fshatarësh u përleshën me disa pushtues çifute. Palestinezët i dërguan peticione Kostandinopojës dhe shtypi i tyre, veçanërisht gazetat "El-Karmel" dhe "Filistin" ishin mjaft aktive në atë kohë në paraqitjen hapur të rrezikut zionist. Në këtë rezistencë, që iu bë

projektit zionist, kishin pjesën e tyre dhe njerëz të shquar si reformatori i famshëm Rashid Rida me revistën e tij "El-Manar", Jusuf Dija El- Khalidi, Sulejman El-Taxhi dhe Isaf El-Nashashibi.

Politikat e fëlliqura të Xhon turqve për turqizimin e përgjithshëm, si dhe politikat e tjera të tyre në mbështetje të projektit zionist, bënë që shumë palestinezë të shtyheshin edhe më shumë për tu bashkuar me shoqëritë dhe organizatat arabe, te cilat kërkonin nje reformë të brendshme në Kalifatin Osman. Ndër këto organizata përmendim "Partinë e Decentarlizimit" (Hizb el-Lamarkazijeh) dhe "Shoqëria e re arabe" (Arabijah el-Fatah).[28] (Young Arab Society).

## Çështja palestineze gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918

Në momentet kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore, në vitin 1914, numri i çifutëve në Palestinë ishte rreth 80,000. Por me shfaqjen hapur të qëndrimit të tyre në favor të Britanisë dhe aleatëve të saj dhe kundër Perandorisë Osmane bene që kjo e fundit të merrte disa masa kufizuese për lëvizjen dhe për aktivitetet e tyre. Kjo bëri që numri i tyre në fund të luftës të ulej në rreth 55,000.

Megjithëse kjo luftë ishte katastrofale për të gjithë, secila parti apo kah politik ishte përpjekur që të përfitonte sa më shumë nga ajo situatë, duke krijuar lidhje dhe marrëveshje të fshehta. Në këtë kohë zionizmi ndërkombëtar po kalonte momente të vështira që kishin të bënin me çifutët që ndodheshin në diasporë dhe veçanërisht me faktin se disa prej krerëve të tyre ndodheshin në Gjermani. Megjithatë, zionisti i famshëm C.Weizman vazhdoi të kishte pozitën e tij të lartë, i ndihmuar edhe nga pozita e fuqishme dhe prestigjoze që gëzonte në Londër.

Gjatë përpjekjes për të fituar Luftën e Parë Botërore dhe për të

[28] Për me tepër detaje rreth kësaj teme shih Abdul-Wahab Al-Kayali, "*Tarikh Falastin al-Hadith*", (Historia Moderne e Palestines). (Bejrut. 1985). fq.37-67

ruajtur interesat e saj strategjike në vendet e Shamit dhe në Irak, Britania nga ana e saj ndërmori tre iniciativa diplomatike kontradiktore.

1-E para kishte të bënte me angazhimin e saj në një marrëveshje delikate me Husain ibën Ali, sunduesin e Hixhazit (sipas Husain MakMahon në korrik 1915-mars 1916), sipas së cilës ai do të shpallte fillimin e një revolucioni arab kundër osmanëve dhe për këtë Britania do ti siguronte atij pavarësinë e vendit nën udhëheqjen e tij. Këtu bëhej fjalë për pjesën më të madhe të territoreve arabe brenda Arabisë, për territoret e vendeve të Shamit dhe Irakut. Me gjithë interesin e madh që treguan në fillim të kësaj çështjeje që kishte të bënte me bashkimin në një xhihad kundër "jobesimtarëve", udhëheqësit arabë u zhgënjyen shume shpejt nga politikat e Xhon turqve, që shkatërruan besueshmërinë islame të shtetit osman. Përveç kësaj, ata u zemëruan furishëm për ekzekutimin e disa udhëheqësve të rinj arabo-siriane, të cilët u vranë nga Xhemal Pasha El-Sagiri, zëvendësi i sulltanit osman. Ndërkohë, Britania i rezistoi presionit të bërë nga El-Sherif Huseini dhe ishte shumë e lekundur në veprimet e saj, sidomos për atë që kishte të bënte me kufijte e shtetit arab të propozuar.

Ne 24 tetor 1915 Britania kërkoi "rregullim administrativ të veçantë" në Irakun Jugor si dhe njëkohësisht me këtë të bëhej përjashtimi i një sërë territoresh arabe nga shteti i propozuar për tu formuar. Ndër rajonet që do të përjashtoheshin përfshihen Marsini, Adana, Alepo, Hims, Hamah, Jemeni Jugor dhe vendet arabe të Gjirit. Al-Sharifi, megjithëse pa dëshirën e tij, bëri kompromis në lidhje me disa territore arabe të kolonizuara, duke insistuar në përfshirjen e rajoneve perëndimore të Alepos, Himsit dhe Hamah (që tani njihen si Libani i sotëm).

Si përfundim u ra dakord që këto mosmarrëveshje të liheshin mënjanë deri në fund të luftës. Kështu Al-Sharifi u bë aleat me britanikët dhe në 10 qershor 1916 deklaroi revolucionin arab kundër osmanëve. Për këtë ai kishte mbështetjen e disa organizatave të fuqishme arabe, siç ishin Al-Arabijah al-Fatah (Arabët e rinj), Al-Lamarkazijah (Decentralizimi) dhe Al-Ahdi (Besa) në vendet e Shamit.

2-Në kohën kur Britania ishte në bisedime me Al-Sharifin ajo, njëkohësisht, hyri në negociata të fshehta me Francën dhe Rusinë. Marrëveshjet e tyre kishin të bënin me të ardhmen e Irakut dhe vendeve të Shamit. Rezultati i këtyre bisedimeve ishte marrëveshja Sykes-Picot, që i jepte Britanisë pjesën më të madhe të Irakut, Jordaninë Lindore dhe zonën e Hajfas në Palestinë. Ndërsa Siria dhe Libani iu dhanë Francës. Toka strategjike e Palestinës u vu nën kontrollin ndërkombëtar.

3- Në të njëjtën kohë kur Al-Sharifi po kontaktonte me Francën dhe ishte në bisedime me ta, Britania ishte në negociata të rëndësishme me Organizatën Botërore Zioniste, me shpresën se lobi çifut në Amerikë do të ushtrote ndikimin e tij mbi qeverinë amerikane për ti shpallur luftë fuqive të Boshtit, gjë që ndodhi në mars të vitit 1917. Anglia mbështeti çështjen zioniste e nxitur më së tepërmi nga motive fetare, strategjike dhe politike, të cilat u përmendën dhe më lart. Po ashtu mbështetja e Anglisë ishte e nxitur nga lobi i fuqishëm çifut si dhe nga vetë kabineti i kësaj qeverie. Ndërsa kryeministri Lord Llojdi dhe ministri i jashtëm Belfor ishin mbështetës të fuqishëm të projektit zionist, ministri i brendshëm Herbert Samuel ishte një çifut i lindur. Rezultati i këtyre manovrave dhe intrigave ishte Deklerata e Belforit e 2 nëntorit 1917. me anë të së cilës Britania zotohej se do të ndërtonte për çifutët një strehim kombëtar në Palestinë. Kjo, pa dyshim, ishte një nga marrëveshjet më mizore në gjithë historinë e njerëzimit, pasi ajo shkelte të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe në mënyrë arrogante cënonte të drejtat dhe aspiratat e banorëve legjitimë të tokës palestineze. Në të vërtetë një hap i tillë u ndërmorr nga një popull, të cilit kjo tokë nuk i përkiste në asnjë lloj mënyre, pasi deri atëherë ajo nuk ishte nën pushtimin anglez dhe për më tepër iu premtua një populli, që nuk e meritonte të ishte trashëgues i saj. Kjo gjë, për ironi të fatit, ndodhte në një periudhë kur Britania ngrinte zërin për të reklamuar "Nderin anglez" që kishte të bënte me pozitën e saj si "mbrojtëse" e vlerave dhe parimeve njerëzore.

4. Përmbajtjet e këtyre dy marrëveshjeve dhe pikërisht marrëveshjes së Saiks-Pikot (Sykes-Picot) dhe Deklaratës së Belforit

iu bënë të ditura audiencës së gjerë brenda një kohe të shkurtër nga miratimi i tyre. Kjo u bë e mundur nga Rusia komuniste, e cila u tërhoq nga Lufta e Parë Botërore pas përmbysjes së sundimit të Carit në tetor të vitit 1917. Po ashtu lajmi për këto dy marrëveshje u dha edhe nga shtypi egjiptian. Tradhtia e britanikëve e tronditi rëndë revolucionin arab dhe i inatosi së tepërmi ushtarët e këtij revolucioni. Ata refuzuan të bashkëpunonin me përpjekjet luftarake të aleatëve derisa të kishin një sqarim nga qeveria britanike për këtë çështje, megjithëse kjo e fundit ishte përpjekur që ti qetësonte arabët dhe udhëheqësit e tyre me anë të mashtrimeve të njëpasnjëshme. Në janar të vitit 1918 Anglia nisi një të dërguar të saj, i cili me anë të garancive jo të qarta do të bindte Al- Sherif Huseinin se emigrimi i popullsisë çifute në Palestinë nuk do të ndikonte në "interesat legjitime ekonomiko-politike" të popullit palestinez.

Në qershor të vitit 1918, qeveria britanike i dha liderit të shtetit sirian një premtim tjetër të dyshimtë. Kjo e fundit kishte të bënte me tokat që ndodheshin nën pushtimin britanik dhe me saktësi për pjesën jugore të Palestinës dhe Irakun, të cilat, sipas tyre, do të qeveriseshin "në përputhje me dëshirën e banorëve" të këtyre tokave. Ndërsa tokat që ndodheshin nën pushtetin osman, që kishin të bënin me Palestinën Veriore, Jordaninë Lindore, Sirinë, Libanin dhe Irakun Verior do të deklaroheshin si të pavarura.

Po ashtu, në fund të Luftës së Parë Botërore, nëpërmjet një deklarate franko-angleze që i përket datës 7 nëntor 1918, arabëve që ndodheshin nën sundimin osman u premtohej pavarësia dhe liria."[29]

[29]Mbi negociatat e Britanisë me Al-Sharif Huseinin, me francezët dhe me Organizatën Botërore Zioniste, shih Ibid, fq. 72-84, George Antonius, *The Arab Awakening* (Londër, 1955), fq. 260-72 dhe versionin arab të raportit të Komisionit Mbretëror. *The White Book* No. 5479, botuar nga qeveria britanike e mandatuar në Palestine. (Jeruzalem, 1937), fq.23-31. Ky raport njihet si: "Peel Report." Raporti përmbledhes i historisë së dokumenteve nga shpërthimi i luftës ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Turqisë në vitin 1914 deri në shpërthimin e revoltës së Sherifit në qershor 1916. përgatitur nga Byroja Arabe, Kajro, 29 nëntor 1916, Zyra e të Dhënave Publike 158/ 624 dhe J. C. Hurewitz, Diplomacy in the Near and the Middle East 1914-1956 (Diplomacia në Lindjen e Afërme dhe atë të Mesme 1914-1956). (U.S.A., 1958). Vol.2. fq.26.

# KAPITULLI II

# PALESTINA NËN PUSHTIMIN BRITANIK

# GJATË VITEVE 1917-1948

Në dhjetor të vitit 1917 Britania arriti ta plotësojë pushtimin e saj në pjesën jugore dhe qendrore të Palestinës, duke përfshirë këtu edhe Jeruzalemin, që u pushtua zyrtarisht në 9 dhjetor 1917. Komandati i forcave ushtarake britanike, Lord Allenbai, me këtë rast u shpreh me mburrje duke thënë: "Tani përfunduan luftërat e kryqëzatave".[30]

Kjo nënkuptonte se europianët e konsideronin veten si vazhdues të luftërave 800-vjeçare të kryqëzatave kundër muslimanëve.

Britania e vazhdoi më tej politikën e saj ekspansioniste duke pushtuar në shtator-tetor 1918 pjesën veriore të Palestinës, pjesën lindore të Jordanisë, Sirinë dhe Libanin. Që nga ai moment Anglia ndërmori një fushatë të egër dhe të pamëshirshme për të vazhduar zbatimin e projektit që do të çonte në judaizimin e të gjithë Palestinës. Ajo e bindi Francën që të ndalonte angazhimin e saj ndaj marrëveshjes së Saiks-Piko (Sykes-Peaco) dhe në këmbim të këtij hapi Britania nuk do të mbështeste më qeverinë arabe në Damask, të themeluar nga Faisal ibën Al-Sharif Husain, duke i lënë kështu rrugë të hapur pushtimit të fshehtë francez të Sirisë. Për më tepër, Britania me anë të politikës së saj arriti që të bindë Kombet e Bashkuara, që në 24 korrik të vitit 1922 ato të diskutonin një dekret që e njihte Deklaratën e Belfurit, megjithëse pikat që paraqiteshin në të ishin në mënyrë paradoksale në kundërshtim me parimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe i jepnin Britanisë një mandat mbi Palestinën.

Pavarësisht këtij fakti dhe duke mos llogatitur këtë Deklaratë,

---

[30] Amil Al-Ghuri, "*Falastin Abr Siteen Aman*". (Palestina në gjashtëdhjetë vjet), (Bejrut, 1972), fq.28-30.

Britania ishte moralisht e detyruar nga virtytet e objektivave bazë të sistemit mandatues, i cili duhet të siguronte pavarësinë e popujve të mandatuar, të ruante të paprekuar të drejtat civile dhe fetare të palestinezëve të cilët përbënin 92 %[31] të popullsisë së vendit. Po ashtu ajo duhet të përkrahte zhvillimin e institucioneve lokale palestineze.

Në fakt Britania imperialiste i injoroi në mënyrë totale këto të drejta. Respekti që ajo tregonte në publik për të drejtat e këtij populli dhe inkurajimi që shfaqte për udhëheqësit palestinezë për ti shtyrë ata që ti arrinin të tilla standarte me anë të mjeteve "kushtetuese" dhe "civile", në fakt nuk ishin asgjë tjetër veçse pretendime false për një pozicionim neutral të saj në konfliktin e acaruar arabo-çifut. Po ashtu kjo pozitë që ajo donte ti siguronte vetes, por që në fakt nuk përkonte me politikat e saj në zbatim, ishte dhe një mjet mbrojtës kundër shpërthimit të gjerë të revolucionit. Por, ndërkohë, me anë të bisedimeve të dyfishta dhe taktikave ngadalësuese, Britania po punonte në mënyrë tepër energjike për ngritjen në Palestinë të një vendqendrimi kombëtar për çifutët.

Në fund të korrikut të vitit 1920, Britania e vendosi të tërë tokën palestineze nën pushtetin ushtarak, por që brenda një kohe të shkurtër zgjodhi që ta zëvendësojë atë me një kod civil nën komandën e Përfaqësuesit të Lartë Britanik. Përfaqësuesi i parë i lartë zionist, Herbert Samuel (1920-1925) dhe pasuesi i tij u angazhuan në mënyrë aktive për të zbatuar projektin zionist. Në mesin e tyre figura më spikatur ishte Arthur Wauchope, gjatë udhëheqjes së të cilit (1931-38) komploti zionist arriti kulmin e tij.

## Zhvillimi i projektit zionist

Pushtimi i drejtpërdrejtë i Britanisë në Palestine, siguroi komisionerëve të lartë fuqi të pakufizuara dhe nuk lejoi që populli

[31] Arabet numëroheshin 610 000, ndërsa çifutët varionin 50-55 000.

palestinez të kishte një vetëqeverisje kushtetuese. Politikat e tyre ekonomike në përkrahje të zionistëve si dhe politika "Përça e sundo" e thelluan edhe më tej vështirësinë e popullit palestinez për të pasur një jetë të përshtatshme. Kjo bëri që në mesin e tyre të shtoheshin ndarjet dhe mosmarrëveshjet. Megjithatë, këto intriga britaniko-zioniste dhe oferta financiare fitimprurëse dështuan në mënyrë të përgjithshme dhe nuk arritën që ta bënin për vete popullin palestinez që tia shiste tokën e tij çifutëve.

Në vitin 1948 përqindja e tokave që iu përkisnin tashmë çifutëve shkoi në 6.5% të territorit të përgjithshëm të tokës palestineze. Këto ishin toka që i përkisnin qeverisë apo toka që iu shitën jopalestinezëve nga pronarë tokash që banonin në Liban dhe Siri. Megjithatë çifutët kishin ndërtuar 291 koloni në këto sipërfaqe toke të kufizuara.

Përkrah këtyre masave të ashpra politike dhe ekonomike, britanikët vendosën një embargo të rreptë mbi palestinezët. Ata dënonin ashpër me afate të gjata burgimi çdo palestinez që mbante barut apo armë të ftohta, ndërsa poseduesit e armëve të zjarrit ndonjëherë arrinin edhe në dënim me vdekje.

Por, nga ana tjetër, autoritetet britanike bënë një sy qorr dhe një vesh shurdh për sa i përket armatimit të çifutëve dhe ndonjëherë edhe e inkurajonin një gjë të tillë. Kështu, çifutët arritën të formonin forca ushtarake të disiplinuara dhe të trajnuara në përputhje me standarte të kësaj fushe. Në këtë mënyrë, në vitin 1948 numri i banditëve të armatosur nga ana e çifutëve arriti në 70 000, nga të cilët 64 000 ishin nga Hagana, 5000 nga Irguana dhe më shumë se 2 000 nga Stern. Ky numër ishte sa trefishi i shtatë ushtrive arabe që morën pjesë në luftën arabo-izraelite që u zhvillua në vitin 1948.

Çifutët arritën të krijonin shumë institucione të rëndësishme so- cial-ekonomike dhe arsimore, siç ishte Histadrut që kishte të bënte me Unionin e Punëtorëve apo Universiteti Hebre në Jeruzalem i krijuar në vitin 1925. Po ashtu përmendim krijimin në vitin 1929 të Agjensisë Çifute, një agjensi tepër e fuqishme që u bë një organ përfaqësues i çifutëve në

Palestinë.[32]

Është e qartë që qëllimi i këtyre organeve ishte të siguronin një infrastrukturë të fortë për shtetin çifut që pritej të ngrihej dhe që u shpërngul për në Palestinë në 14 maj të vitit 1948.

## Nevoja për një Lëvizje Kombëtare Palestineze

Palestinezët vuajtën një dobësi dhe vështirësi të paparë në periudhën pas Luftës së Parë Botërore. Po ashtu shtetet arabe dhe e tërë bota islame në përgjithësi ishin nën dominimin e fuqive imperialiste. Mjetet ekonomike dhe politike që zotëronin palestinezët ishin të pallogaritshme në krahasim me projektin zionist të mbështetur si nga Jobi i fuqishëm ndërkombëtar çifut, ashtu dhe nga fuqitë e mëdha. Pavarësisht kësaj, palestinezët këmbëngulën për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për të fituar pavarësinë gjatë gjithë epokës së pushtimit britanik. Xhihadi (lufta) i tyre dhe levizjet politike që ata ndërmorrën u fokusuan më së tepërmi në këto kërkesa të rëndësishme:

- Nxjerrjen të jashtëligjshme të deklaratës së pandershme dhe shtypëse të njohur si Deklarata e Belforit.
- Ndalimin e menjëhershëm të emigrimit të çifutëve në Palestinë.
- Pezullimin e shitjes së tokave palestineze për qytetarët çifute.
- Themelimin e qeverisë kombëtare palestineze nëpërmjet një asambleje të zgjedhur në mënyrë të lirë.

Lëvizja Kombëtare Palestineze lindi e mbështetur mbi këto baza dhe e arriti kulmin e aktivitetit të saj në Konferencën e Parë Arabo-

[32] Per njohuri me të detajuara rreth projektit zionist, shih Muhamed Salamah al- Nahhal, "*Siyasat al-Intidab al-Biritani hawl Aradi Falastin al-Arabiyyah*", (Beirut, 1981) dhe Muhammed Abdul-Rauf Salim, *Nashat al-wakalah al-Yahudiyyah li Falastin: munzu Nashatiha wa hata Qiyam Dawlat Israel 1922-1948*, (Beirut, 1982).

Palestineze që u mbajt në Jeruzalem gjatë 27 janarit deri më 10 shkurt në vitin 1919. Kjo konferencë nuk pranoi ndarjen e vendeve të Shamit, në të cilën Palestina ishte pjesë përbërëse e brendshme e saj. Po ashtu ajo kërkoi një pavarësi përbrenda bashkësisë arabe si dhe formimin e qeverisë kombëtare palestineze. Deri në vitin 1928, nacionalistët palestinezë mblodhën shtatë konferenca të ngjashme me të parën dhe dy kryetare e udhëhoqën më tej këtë përpjekje. Ata ishin presidenti i Komitetit Ekzekutiv të Kongresit Palestinez, Musa Kazim al-Huseini dhe ai që ishte më i rëndësishmi ishte Haxhi Amin Al-Huseini, i cili ishte muftiu i Jeruzalemit si dhe kryetari i Këshillit të Lartë Musliman, që nga formimi i këtij të fundit në vitin 1922. Të gjitha qëllimet e këtij këshilli u bënë forca shtytëse dhe udhëheqja e padiskutueshme e Xhihadit Palestinez deri në fund të dominimit britanik të këtij vendi në 1948.

## Lëvizja Kombëtare Palestineze gjatë viteve 1918-1929

Lufta kombëtare palestineze kundër projektit zionist gjatë periudhës 1918-1929 ka qenë një luftë përgjithësisht e orientuar drejt sigurimit të paqes. Me anë të kësaj lufte ata u përpoqën që ta bindnin Britaninë që të ndryshonte qëndrim kundrejt Deklaratës së Belforit dhe të deklaronte që ajo nuk kishte forcë ligjore dhe se ishte e pavlefshme. Lidershipi palestinez ishte i mendimit se populli i tyre ishte shumë i dobët për të përzënë Britaninë dhe në një farë mënyre ata po prisnin me optimizëm një përgjigje perceptuese nga ana e Britanisë, që ajo të rreshtohej si aleate në krah të liderit të tyre të ri arab, Sherif Huseinit. Kjo gjë më së shumti shihej si e mundur gjatë periudhës kur projekti zionist nuk kishte pësuar jehonë të madhe rreth statusit të Palestinës. Në fakt ky mendim, i mbushur me vullnet të mirë, ishte tregues i pamaturisë politike të tyre si dhe i mungesës së ndjekjes së rrugës revolucionare për të zgjidhur këtë çështje. Lëvizja kombëtare në të vërtetë u dëmtua edhe nga gara tragjike e dy familjeve me rëndësi, asaj

Husejnije dhe famijes Nashashibija, luftë e cila bëhej për të fituar udhëheqjen e kësaj lëvizjeje. Ky konflikt u shfrytëzua dhe u acarua më shumë nga ana e britanikëve të cilët zbatonin teorinë e tyre "përça e sundo". Pavarësisht nga kjo mosmarrëveshje, nuk ndodhi që ajo të çonte në ndonjë ndryshim drastik të pozicionit bazë të palestinezëve përkundrejt projektit zionist dhe imperializmit britanik si dhe përkundrejt kërkesave të saj të rëndësishme politike.

Nderkohë, udhëheqja palestineze ndërmori një sërë lëvizjesh politike, duke përfshirë këtu dërgimin në korrik të 1921 të një delegacioni në Londër për të biseduar rreth çështjes së tyre me Uinston Çerçill (Winston Churchill) dhe ndihmësit e tij më të afërt. Ky i fundit mbante atëherë pozitën e Sekretarit të Shtetit për Kolonitë.

Por qeveria britanike bëri një vesh të shurdhët ndaj kërkesave palestineze, pavarësisht faktit se Dhoma e Lordëve, në 1923, në mënyrë zyrtare miratoi një rezolutë ku nuk e pranonte Deklaratën e Belforit. Nga fronti i brendshëm në vitin 1923 palestinezët bënë që të dështonte një përpjekje britanike për formimin e një këshilli legjislativ simbolik dhe joperfaqësues. Kjo u arrit me anë të një bojkoti dhe greve, të pasuara nga protesta të shumta publike gjatë vizitës së Belforit në Palestinë në vitin 1925. Gjatë Kongresit të Pestë Palestinez, të mbajtur në 22-25 gusht të vitit 1922 pjesëmarrësit në mënyrë jo unanime dhe nën betim miratuan një statut kombëtar, në të cilin citohej si më poshtë:

"Ne përfaqësuesit e popullit arab palestinez, në Kongresin e Peste Arabo-Palestinez të mbajtur në Nablus, marrim përsipër përpara Zotit, historisë dhe popullit që të vazhdojmë përpjekjet tona për arritjen e pavarësisë së vendit tonë dhe bashkësisë arabe duke përdorur të gjitha mjetet ligjore si dhe nuk do të lejojmë emigrimin e çifutëve apo krijimin e një strehe kombëtare çifute në Palestine".[33]

Gjatë periudhës 1918-1928 u vunë re tre kryengritje të mëdha palestineze që treguan kundërshtimin e thellë të popullit dhe zemërimin e tij përkundrejt projektit zionist dhe çifutëve në përgjithësi, Megjithëse

[33] Për këtë shih Al-Kayali, op cit, fq. 104-5 dhe 134-98.

të detyruar nga arsye praktike, nacionalistët iu shmangën paraqitjes hapur të armiqësisë me Britaninë. Kjo e fundit i shtypi me dhunë këto lëvizje të gjera protestuese.

Lëvizja e parë ishte revolta e emërtuar "Mausim Prophet Musa", që u zhvillua në Jeruzalem gjatë 4-10 prillit të vitit 1920, gjatë së cilës mbetën të vrarë pesë çifutë dhe katër arabë. Ndërsa gjatë një përleshjeje tjetër mbetën të plagosur 211 çifutë dhe 24 arabë.

Revolta e dytë ishte ajo e Xhafa s, që shpërtheu në këtë rajon si dhe në rajone të tjera të Palestinës Veriore. Gjatë kësaj revolte u vranë 47 çifutë e 48 arabë, si dhe u plagosën 146 çifutë të tjerë dhe 73 arabë.

Revolta e fundit ishte ajo e Murit të Al-Burakut (muri perëndimor i xhamisë së shenjtë Al-Aksa), e cila u përhap në të gjitha pjesët e tjera të Palestinës. Gjatë kësaj revolte u vranë 133 çifutë dhe 116 arabë, ndersa u plagosën 339 çifutë të tjerë dhe 232 arabë. Të vrarët apo të plagosurit çifutë u shkaktuan nga ana e arabëve, ndërsa për të vrarët arabe përgjegjësia binte mbi ushtrinë dhe policinë britanike. Është thelbësore të kujtojmë këtu se këto revolta ishin të motivuara nga parime islame dhe Haxhi Armin Al-Huseini, muftiu i Palestines, udhëhoqi revoltën e parë dhe të tretë. Ndërkohë udhëheqësit e moderuar zyrtarë palestinezë bënë çkishin mundësi për ta qetësuar situatën dhe për ta përmbajtur inatin kundër çifutëve.[34]

## Lëvizja Kombëtare Palestineze gjatë viteve 1929-1939

Kryengritja e Al-Burakut, e vitit 1929, ishte fillimi i një lëvizjeje të re pastruese të Xhihadit kundër projektit zionist dhe imperializmit britanik. Ajo arriti kulmin e saj me Revolucionin e Madh Palestinez të vitit 1936-

[34] Për këto revolta, shih Mohsen M. Saleh. *Al-Tayyar al-Islami fi Falastin wa Atharuha fi Harakat al-Jihad 1917-1948*, (Rryma islame në Palestine dhe ndikimi i saj ne lëvizjen e xhihadit në vitet 1917 1948), (Kuvajt, 1988), fq-165-91.

1939. Rreziku i pashmangshëm që vinte nga projekti çifut kishte dalë qartë gjatë periudhës së viteve 1930-1935, kur ndodhi dhe emigrimi i 152 000 çifutëve, të cilët më së shumti vinin nga Gjermania. Në mesin e tyre kishte dhe shumë biznesmenë dhe njerëz të profesioneve të ndryshme. Nga kjo lëvizje numri i çifutëve të mëparshëm, që ishte rreth 156 000, gati u dyfishua. Përveç kësaj gjatë kësaj periudhe çifutët arritën të përfitonin dhe toka të shumta që arrinin në rreth 229 000 dynymë. Po ashtu ata sollën kontrabandë në Palestinë armë dhe dy përpjekje të tilla arritën të kapen në flagrancë dhe përkatësisht ajo e 15 marsit 1930 dhe ajo e 16 tetorit 1935.[35]

Gjatë gjysmës së parë të viteve 1930 pësuan një rritje, si aktivitetet politike ashtu dhe përleshjet e drejtpërdrejta me autoritetet britanike që etiketoheshin si "origjina e dobësive dhe burimi i të gjitha të këqijave". Gjatë kësaj periudhe u formuan disa prej partive dhe organizatave

politike palestineze, ku ndër më të parat përmendim partinë e themeluar në vitin 1932, e cila mbante emrin Hizb Al-Istiklal (Partia e Pavarësisë). Kjo parti, pavarësisht nga rrëshqitjet që pësoi ndikimi i saj duke filluar që nga viti 1933, shquhej për qëndrimin e patundur anti-britanik. Pas kësaj partie rreshtohej partia më popullore e njohur me emrin Al-Hizb Al Arabi Al-Filistini (Partia Arabo-Palestineze), në mbështetje të së cilës ishte mufti Haxhi Amini.[36]

Veç këtyre dy forcave politike ekzistonin edhe një sërë shoqatash rinore islame, disa organizata shërbimesh informimi, si dhe disa organizata paramilitare sekrete siç ishin Xhihadija (Luftëtarët) dhe organizata Al-Xhihad Al-Mukaddas (Xhihadi i Shenjtë). Të dyja këto organizata ishin respektivisht nën udhëheqjen e Izudin Al-Kasamit dhe Abdul-Kadir Al-Huseinit.

Po ashtu në këtë kohë operonin dhe grupe më të vogla revolucionare, siç ishte Al-Kaff Al-Akhdar (Dora Jeshile), e cila kishte

[35] Shih raportin "Peels" fq. 266.

[36] Shih "Bayan al-Hut. *Al Kijadat wa al-Muassasat al-Sijastjah al-Falastinijal 1917-1948"(Krerët dhe institucionet politike palestineze 1917-1948*), (Bejrut. 1981). fq.301-14 dhe Kamil Khullah. *Falastin wa al-latidab al-Biritani 1922-1933* (Tripoli. 1982), fq.517-21

pasur shumë përplasje me autoritetet imperialiste.

Në këtë situatë palestinezët i kishin humbur të gjitha shpresat që ti arrinin aspiratat e tyre nëpërmjet mjeteve paqësore dhe ligjore.

Kjo gjë vihet re qartë dhe nga fjalët e mëposhtme të Haxhi Amin Al-Huseinit, i cili shprehet: "Deri në vitin 1932 tek ne ekzistonte në një farë mënyre një shpresë e zbehtë, e cila shumë shpejt u zhduk. Të gjitha vuajtjet dhe plaget tona u analizuan me kujdes dhe e kuptuam se për ne nuk kishte rrugë tjetër përveç sakrificës dhe martirizimit".[37]

Në një memorandum të shkruar nga drejtori i Shërbimit Sekret të Forcave Policore Britanike thuhet: "Ka një rritje të ndjenjës së pakënaqësisë së arabëve kundrejt mandatit britanik dhe administrimit të vendit. Kjo ndjenjë është e pranishme dhe dominon njerëzit e klasave shoqërore të ndryshme. Po ashtu keto ndjenja pakënaqësie dhe zemërimi janë të përgjithshme dhe kanë ardhur në rritje nga viti në vit. Arabët, që gjatë gjithë kësaj kohe kanë shpresuar se britanikët do të lejonin vendosjen e drejtësisë për çështjen e tyre, tashmë janë kapluar nga dëshpërimi."[38]

Këto ndjenja anti-britanike u theksuan nga disa zhvillime të mëtejshme. Ngjarja e parë që kishte të bënte me këtë ishte dështimi i delegacionit arabo-palestinez, i cili në vitin 1930 u dërgua në Londër nën udhëheqjen e Musa Kazim Al-Huseinit. Qëllimi i këtij delegacioni ishte që të merrte përgjigje pozitive nga ana e qeverisë britanike. Më pas autoritetet britanike refuzuan zbatimin e reformave për tokën, të cilat ishin sugjeruar nga ana e ekspertit britanik J.H. Simpson, të dërguar nga vetë qeveria britanike. Ky ekspert do të raportonte për konfliktet rreth tokës që kishin lindur në Palestinë. Pas një studimi të tërësishëm, ai shfaqi bindjen se nuk kishte më toka për tiu dhënë çifutëve dhe sugjeroi ndalimin ose uljen drastike të emigrimit të tyre drejt Palestinës[39].

Ajo çka i acaroi edhe më tepër gjërat ishte tërheqja e qeverisë britanike nga angazhimi i marrë më parë, që përmëndej në "Librin e

[37] Zuhair al-Mardini, "*Alf Jam mael-Haxh Amini al-Husaini*" (Nje mije dite me Al- Haxh Amini Al-Husaini), (Bejrut, 1980), tq 77.

[38] PR.O., C.O. 733/257/11. memorandumi sekret nga H.R. Rice, shtator 1933.

[39] Cmd 3686 (His Majestys Stationary Office, 1930). Report by Sir J.H. Simpson. entitled Palestine: Report on Immigration. Land settlement and Development"

Bardhe" (White Book) të tetorit të vitit 1930. Ky angazhim kishte të bënte me vendosjen e kufizimeve për emigrimin e çifutëve në Palestine. Ky mashtrim është regjistruar në "Librin e Zi" (Black Book) të vitit 1931, që kishte pranuar haptazi angazhimin e Britanisë për zbatimin e projektit Zionist.[40]

Ndërkohë palestinezët e rinovuan dimensionin arabo-islamik të çështjes palestineze. Relacione zyrtare flisnin në maj të vitit 1931 meth një plani revolucionar islamik për të shpëtuar vendet arabe, e në mënyrë të veçantë Palestinën dhe Sirinë. Ky masterplan u ideua nga lideri i mirënjohur musliman, libanez princi Shakib Arsalan, në bashkëpunim me Haxhi Amin Al-Huseinin dhe aktivistin e famshëm musliman me origjinë indiane Maulana Shaukat Ali. Princi Shakib, po ashtu, kishte siguruar mbështetjen e disa lëvizjeve arabe për liri në Arabi, Irak, Egjipt dhe Sham. Megjithatë, nga gjithë këto levizje islame dhe anti-britanike nuk rezultoi asgje konkrete.[41]

Duhet thënë se dimensioni islam që iu dha çështjes palestineze pati një paraqitje më të qartë në Kongresin e Përgjithshëm Islamik që u mblodh në Jeruzalem në 17 dhjetor 1931 nën drejtimin e Haxhi Amin Al-Huseinit. Në këtë paraqitje të fuqive islame mermin pjesë përfaqësues të njëzet e dy vendeve të ndryshme si dhe udhëheqës e dijetarë të shquar muslimanë, ndër të cilët përmendim: Shejh Rashid Rida, poeti dhe dijetari indian Muhamed Ikbali, udheheqësi indian Shaukat Ali dhe udheheqësi tunizian Abdul-Aziz Al-Thaalibi. Po ashtu të pranishëm në atë kongres ishin dhe ish-kryeministri iranian Dijaud-Din Al-Tabtabai dhe lideri sirian Shukri al-Kuathi.

Në këtë mbledhje islame u diskutuan një sërë çështjesh praktike si themelimi i një universiteti islam dhe i një kompanie tregtare për të shpëtuar tokat palestineze dhe për të formuar komitete palestinezësh

[40] "Black Book" (Libri i Zi) ishte një letër që kryeministri britanik, R.Mac Donald. in kishte adresuar presidentit të Organiz ates Botërore Zioniste, Weizman dhe e lexoi atë në Dhomën e Përfaqësuesve në 13 shkurt 1931, Shih: Parliamentary Debates (Diskutime parlamentare), House of Com- mons, (Dhoma e Përfaqësuesve), Vol.248. cols.751-757

[41] Al-Kayali, op.cit., fq.229.

në vende të ndryshme.[42]

Por dominimi imperialist në shumicën e vendeve muslimane dhe mashtrimet e komplotet britanike bënë që të gjitha këto projekte të dështonin.

Në fakt, rritja e rolit të dijetarëve palestinezë në lidhje me këtë çështje u tregua që në kongresin e parë të tyre, i cili u mbajt më 25 janar 1935. Po ashtu qëndrimi i tyre doli qartë dhe nëpërmejt fetvave (vendimeve fetare) të shumta të dhëna nga ana e tyre për moslejimin e shitjes së tokës për çifutët, duke i shpallur të gjithë ata që shkelnin një rregull të tillë si jobesimtare[43].

Në këtë kohë rezistenca kundër çifutëve dhe mbrojtësve të tyre britanikë mori një hov. Partia Al-Kaff al-Akhdar, nën udhëheqjen e liderit dhe themeluesit të saj Ahmed Tafish u bë nismëtare e kësaj lufte duke ndërmarrë një numër operacionesh që paraqitnin rrezikshmëri të madhe. Britanikët, duke përdorur forcën e tyre, e shtypën këtë organizatë dhe në shkurt 1930 arritën të arrestonin liderin e saj[44].

Në tetor të vitit 1933 lidershipi politik palestinez përshkallëzoi qëndrimin kundërshtues të tij dhe brenda një kohe të shkurtër organizoi dy demonstrata popullore të mëdha. Njëra nga këto u organizua në xhaminë Al-Aksa në Jeruzalem në 13 tetor, ndërsa tjetra u organizua në Xhafa, pas faljes së xhumasë, më 27 tetor.

Në këto demonstrata morën pjesë udhëheqësit palestinezë, të cilët u bashkuan me luftën mbarëkombëtare, në të cilën vdiqën 35 arabe dhe u plagosën 255 të tjerë. Demonstrata të dhunshme u zhvilluan dhe në qytete të tjera si Haifa, Jeruzalem, Naplus, Bir Al-Saba (Beersheba) dhe Al-Lud (Laida). I tërë vendi kaloi një luftë shtatëditore. Numri i të vrarëve dhe të palgosurve në këtë luftë ishte i lartë. Në këto përleshje u vra dhe Musa Kazim Al-Huseini, i cili u rrah barbarisht, derisa humbi

---

[42] Bayan al-Hut. fq. 216, 246-47 dhe 872-73.

[43] Ibid, fq.294-95 dhe Bayan al-Hut (editor). *Wathaiq al-Haraka al-Wataniyyah al-Falastiniyyah 1918-1939*, (Deshmi mbi Lëvizjen Kombëtare Palestineze 1918 1939). (Bejrut, 1984), fq, 381-91.

[44] Shih raportin "Safad Gang", Summary of Items of Interest, Air H.Q., Palestine Command, February 1930, Air Ministry. AIR 5/1245.

ndjenjat dhe vdiq nga plagët e shkaktuara në mars të viti 1934 në moshën 81 vjeçare.[45]

Po ashtu gjatë këtyre përleshjeve u arrestuan dymbëdhjetë

udheheqës palestinezë, tre nga të cilët ishin pjesëtarë të Komitetit Ekzekutiv.

Lëvizja Xhihadija ishte një tjetër organizatë sekrete e themeluar nga Shejh Izudin Al-Kasami në vitin 1925. Ajo luftonte me moton: "Ky është xhihad, o vdekje o fitore".

Kjo organizatë ishte më popullore në pjesën veriore të Palestinës dhe veçanërisht në mesin e punëtorëve dhe fshatarëve. Në këtë organizatë bënin pjesë rreth dyqind muxhahidinë dhe 800 simpatizues, me ndihmën e të cilëve ajo organizoi disa operacione të rëndësishme kundër çifutëve gjatë gjysmës së parë të viteve 1930. Por ajo vetëm në nëntor të vitit 1935 e shpalli hapur ekzistencën e saj. Lideri i saj Shejh Al-Kasami dhe dy nga kolegët e tij vdiqën në 20 nëntor të 1935, gjatë një konfrontimi me policinë. Në vendin e tij në krye të kësaj organizate u zgjodh Shejh Farhan Al-Sadi, nën drejtimin e të cilit kjo organizatë pati një rol nismëtar në revolucionin palestinez të vitit 1936-1939.[46]

Një lëvizje tjetër kombëtare islame ishte dhe Al-Xhihad Al-Mukadesi, i cili ishte i përqendruar në luftën në Jeruzalem dhe Hebron. Në krye të kesaj lëvizjeje ishte Abdul-Kadir Al-Huseini. Gjithashtu kjo lëvizje ishte nën patronazhin e vetë mufti Haxhi Aminit. Numri i anëtarëve të saj aminte 400 vetë në vitin 1935[47] dhe kjo organizatë pati një rol aktiv gjatë Revolucionit të Madh, veçanërisht në rajonet e Jeruzalemit dhe Hebronit.

---

[45] Mohsen M. Saleh, *Al-Kunwar al-Askarijah wa Al-Shurtah fi Falustin 1917-1939*. (Forcat ushtarake dhe policia ne Palestine 1917-1939). (Aman, 1996), fq. 408-418.

[46] Per me shume detaje rreth kësaj lëvizjeje. shih Mohsen M. Saleh, *Al-Tajar al-Islami fi* Falastin. fq. 229-79.

[47] Shih Amil al-Ghuri, tq.232-35.

## Revolucioni i Madh Palestinez i viteve 1936-1939

Shkëndija që ndezi këtë revolucion, një nga trazirat më të mëdha të historisë moderne dhe bashkëkohore palestineze, ishte ngjarja e vrasjes së dy çifutëve në 15 prill të vitit 1936. Ata u vranë nga grupi Xhihadija, i udhëhequr nga Shejh Farhan Al-Sadi.

Ky incident, që shakatoi tension midis arabëve dhe çifutëve, u pasua nga një numër hapash revolucionare, ndër të cilat përmendim: fillimi i një lufte 178 ditore mbarëkombëtare (më e gjata e këtij lloji në histori), bashkimi i të gjitha partive arabe në një front kombëtar të bashkuar, si dhe hapi që kishte të bënte me formimin e Komitetit të Lartë Arab në 20 prill, i cili do të vihej nën udhëheqjen e Haxhi Amin Al- Huseinit.

Anëtarët e kësaj lëvizjeje kombëtare u zotuan se do ta vazhdonin revolucionin deri në realizimin e qëllimeve të tyre themelore, e duke vazhduar më tej në formimin e një qeverie palestineze të zgjedhur me anë të mënyrave demokratike. Po ashtu, revolucioni do të vazhdonte deri në ndalimin e emigrimit të çifutëve dhe ndërprerjes së shitjes së tokave palestineze për ta. Në një apel të bërë nga mbretërit arabë dhe emirët, nacionalistët ranë dakord që në tetor të vitit 1936 ti ndërpritnin përkohësisht aktivitetet e tyre revolucionare, në mënyrë që ti lejonin një komisioni mbretëror (komisionit Peel), që të merrte në studim situatën e atëhershme dhe të raportonte në lidhje me situatat e nxehta në Palestinë. Por rekomandimet jo të kënaqshme që dha ky komision, të cilat u paraqitën në fillim të korrikut të vitit 1937, në lidhje me ndarjen e Palestinés midis arabëve dhe çifutëve, çuan në një kthesë të dhunshme të revolucionit.

Kjo kthesë arriti kulmin në 26 shtator 1937 me vrasjen e guvernatorit bitanik Andrews në Galile (Al-Xhalil). Britanikët e inatosur dhe të habitur e shpërndanë Këshillin e Larte Arab. Komitetin e Larte Arab së bashku me komitetet e tjera kombëtare. Ata u përpoqën që me këtë rast të arrestonin Haxhi Aminin. por ai u shpëtoi nga duart në

mesin e tetorit 1937 dhe vazhdoi ta udhëhiqte revolucionin në mërgim. duke qenë i detyruar të qëndronte në Liban.

Megjithatë, katër pjesëtarë të Komitetit të Lartë Arab u arrestuan dhe u dëbuan në mërgim në ishujt Sejcelles (Seychelles) në oqeanin Indian.

Në verën e vitit 1938 revolucioni arriti kulmin e tij. Autoritetet civile britanike kishin arritur pothuajse drejt shkatërrimit, pasi muxhahidinët dominuan rrethinat e qyteteve dhe arritën të pushtonin madje dhe disa qytete palestineze.

Nëse konfrontimet do të ishin vetëm midis nacionalistëve dhe fuqisë koloniale, Britania do të ishte ulur përpara kërkesave të popullit dhe do të ishte larguar nga ky vend, por prania e zionistëve dhe këmbëngulja e tyre për zbatimin e projektit që ata kishin ndërmend për territoret palestineze i dha kësaj situate një acarim më të madh. Lobi i tyre i fuqishëm arriti ta bindë Britaninë që të dërgonte një numër të madh ushtarësh si përforcim, nën komandën e të cilëve ishte Haining. Gjatë kësaj detyre ai asistohej nga disa komandantë ushtarakë të tjerë si Montgomeri, i cili arriti të ripushtonte fshatrat palestineze dhe u bë shkaktar i shkatërrimeve të mëdha dhe i një mjerimi të tejskajshëm për popullin e asaj pjese të Palestines. Shumë nga udhëheqësit e këtij revolucioni u vranë dhe ndër ta përmendim Farhan Al-Sadin, Muhamed Al-Salih al-Hamad, Abdul- Rahim Haxhi Muham etj.

Në verën e viti 1939 rvolucioni kishte mbërritur në fundin e tij, duke patur parasysh këtu qëllimet dhe synimet që kishte në fillim.[48]

Gjatë shtypjes së revolucionit, Britania nga ana e saj ishte përpjekur që në një farë mënyre të kërkonte një rrugëdalje politike nga përvoja e saj e hidhur në Palestinë. Ajo nxori të jashtëligjshëm projektin për copëtimin, liroi të burgosurit që ndodheshin në burgjet Seychelles dhe po ashtu në shkurt të vitit 1939 ajo organizoi një konferencë me një tryezë të rrumbullakët në Londër për të diskutuar rreth krizës në fjalë.

[48] Per informacione të detajuara rreth Revolucionit të Madh, shih: Al-Kayali, *op.cit.*. fq. 260-300 dhe Mohsen M. Saleh, *Al-Kuwwat al-Askarijah wa al-Shurtah fi Falastin*. (Forcat ushtarake dhe policia në Palestine), fq. 437-618.

Në këtë takim morën pjesë delegacionet arabe, palestineze dhe ato çifute. Por kjo konference nuk arriti ti bashkonte palët për një zgjidhje konkrete të problemit.

Pavarësisht nga qëndrimi i të dy palëve, Britania kishte vendosur që tu impononte atyre një zgjidhje të sajën për këtë problem. Zgjidhja e dhënë nga ana e Britanisë u paraqit në White Book-un e majit të vitit 1939. Në një farë mënyre kjo skemë ishte një fitore politike për palën palestineze, pasi Britania tregoi se nuk kishte ndërmend ndonjë plan për krijimin e shtetit çifut në Palestinë, por ajo synonte që brenda dhjetë vjetëve të krijohej një shtet palestinez, në të cilin arabët dhe çifutët të kishin pushtetin e tyre. Në këtë plan thuhej se brenda 5 viteve të para emigrimi i çifutëve nuk duhej ta kalonte shifren 75 mijë dhe, pasi ky numër të ishte plotësuar, atëherë emigrimi i tyre duhet të ndalonte menjëherë. Emigrimi i çifutëve pas këtij rasti do të behej vetëm me lejen konkrete nga ana arabe. Ndërsa përsa i përket shitblerjes së tokës nga ana e çifutëve, ajo do të ndalohej përfundimisht për pjesë të caktuara të Palestinës dhe në pjesë të tjera do të kufizohej.[49]

Pavarësisht nga këto pika, pala e lidershipit palestinez e refuzoi një skemë të tillë, pasi në të pavarësia palestineze ishte paraqitur e lidhur me miratimin dhe bashkepunimin e çifutëve. Nga ana tjetër, një arsye e fortë e refuzimit të kësaj skeme ishte se ata tashmë nuk kishin më besim tek Britania. Po ashtu në këtë plan të Britanisë për Palestinën nuk thuhej asgjë për falje të përgjithshme, që do të përfshinte të gjithë aktivistët palestinezë dhe as nuk përmendej mundesia që ata të rilidheshin me udhëheqësin e tyre të dëbuar Haxhi Aminin.

Mbi të gjitha lidershipit palestinez i dukej një veprim i pamatur dhe njëkohësisht i parakohshëm që ti jepej miratimi për një skemë, të cilën Britania ishte zotuar dhe më parë që do ta zbatonte. Me sa dukej zbatimi i politikes "wait and see" (prit dhe shiko) ishte një mënyrë e mirë për të testuar seriozitetin dhe besnikërinë e Britanisë. Nga ana tjetër edhe çifutët e refuzuan me forcë projektin britanik.[50]

---

[49] Shih: *Palestine Statement of Policy*, Maj 1939. Cmd. 6019. Londer HM.S.O..1939.

[50] Shih Al-Kayali, *op.cit.*, fq. 300-2 dhe Khullah, *op.cit.*, fq 733-43.

## Zhvillimet politike të viteve 1939-1947

Vitet e Luftës së Dytë Botërore (1939-1945) patën një rezultat katastrofal për palestinezët dhe çështjen e tyre. Gjatë kësaj periudhe ata panë se si ra forca e tyre ushtarake dhe fuqia politike. Edhe udhëheqësit e tyre, e veçanërisht Haxhi Amini, u detyruan të mërgonin jashtë vendit në situata të rrezikshme.

Sërish Haxhi Amini u detyrua që të emigronte nga Libani për në Irak, ku mori pjesë në themelimin e një rendi kombëtar anti-britanik. Por pas dështimit të shpejtë të kësaj lëvizjeje politike të tij ai u largua për në Iran, më pas në Turqi dhe në nëntor të vitit 1941 mbërriti në Gjermani. Armiqësia dhe mashtrimet e treguara nga ana britanike nuk i lanë atij asnjë zgjedhje tjetër, përveçse të kërkonte ndihmën e nazistëve gjermanë për çështjen palestineze. Këta të fundit, së bashku me aleatin e tyre, Italinë, përgatitën një deklaratë të përbashkët që kërkonte dhënien fund të përdorimit të termit "shtëpi kombëtare për çifutët dhe po ashtu, me anë të kësaj deklarate, ata i ofruan të gjithë ndihmën e mundshme vendeve arabe që ndodheshin nën pushtimin britanik, në mënyrë që ato të arrinin pavarësinë e tyre.

Me gjithë insistimin nga ana e gjermanëve që kjo deklaratë të mos bëhej publike deri në momentin e mbërritjes së trupave të tyre nga rajoni i Kaukazit, Haxhi Amini vendosi që të përfitonte nga qëndrimi i tij në Gjermani në të mirë të kësaj çështjeje. Ai më 2 nëntor 1943 formoi një ushtri arabe të trajnuar nga gjermanët, në të cilën u stërviten dhe u rekrutuan qindra të rinj arabe. Po ashtu kësaj ushtrie iu dha një sasi e madhe armesh të lehta dhe municione nga ana e gjermanëve ndërsa 30 000 pushkë u fshehën në Libi për tu përdorur në të ardhmen.[51]

Por fitorja e radhës e britanikëve në këtë luftë i vuri palestinezët dhe udhëheqësit e saj në një situatë kritike. Francezët arritën të arrestonin Haxhi Aminin, por ai u arratis për në Egjipt në qershor të vitit 1946.

---

[51] Shih Falah Khalid Ali, *Falastin wa al-Intidah al-Biritani 1939-1948*, (Bejrut, 1980) fq. 107-11 dhe Zuhair al-Mardini, op.cit.. fq. 157-62, 171, 200-2. 241 dhe 243.

Lajmi qe ai ishte i lirë u përhap gjerësisht dhe u festua me ngazëllim në Palestine dhe ky ishte një tregues i famës së tij te madhe në mesin e popullit palestinez.[52]

Në qershor të vitit 1946 Liga Arabe themeloi një zëdhënës zyrtar te palestinezëve, i cili ishte Këshilli i Larte Ekzekutiv Amb për Palestinen. Kryetar i tij u zgjodh Haxhi Amini. Por ky i fundit i tendosi marrëdhëniet me Jordaninë dhe Irakun dhe kështu që prezenca e tij në Egiptin e dominuar nga britanikët bëri që aftësitë e tij për të manovruar dhe mundësitë e tij për ta çuar përpara çështjen palestineze ishin të pakta.

Ndërkohë që ndodhte kjo, çifutët i dhanë një imazh të fryrë persekutimit të tyre në Gjermani dhe në Europën Lindore, duke bërë thirrje për mirëkuptim dhe keqardhje ndaj asaj që kishin kaluar. Përveç kësaj ata kërkonin që të shihej qartë si mundësi shpëtimi për ta krijimi i një shtëpie kombëtare në Palestinë.

Lobi i tyre ishte i suksesshëm sidomos në shtetin e fortë të Amerikës dhe kjo në mënyrë të veçantë pas konferencës së Biltmores së vitit 1942. Në këtë konference çifutët arritën të bindnin si krahun republikan, ashtu dhe atë demokrat se duhej shpallur si i tepërt Libri i Bardhë Britanik (British White Book) i majit të vitit 1939. Pushteti i çifuteve u forcua dhe u konsolidua më tej nëpërmjet ardhjes së prozionistit Truman në presidencën e Shteteve të Bashkuara. Në 31 gusht të vitit 1945 ai i kërkoi zyrtarisht kryeministrit anglez Atli (Attlee) që të lejonte emigrimin e 100 000 çifutëve për në Palestinë. Në këto kushte të përshtashme lufte, çifutët u organizuan dhe u forcuan ushtarakisht dhe politikisht. Nga 26.000 çifutë që ishin ne Palestinë, pjesa më e madhe e tyre ishin anëtarë të organizatës "Hagana". Më pas këto trupa iu bashkuan njësive të ushtrisë britanike, e cila do të përbënte bazën e forces ushtarake të shtetit të ardhshëm çifut.

Emigrimi i çifutëve drejt Palestinës arriti kulmin gjatë luftës dhe vazhdoi të shënoje ritme te larta dhe pas saj. Kështu, gjatë viteve 1939-1945, numri i çifutëve që emigruan ishte 92 000 dhe ne vitet 1946-1948

[52] Khalil al-Sakakini, Katha Ana Ya nia (Damask. 1982), fq.367

ky numër ishte 61 000. Po ashtu ata arritën të përvetësojnë 270 000 dynymë tokë gjatë periudhës 1939-1947 dhe arritën të ndërtonin 73 koloni në tetë vjet (1940-1948).

Duke qenë nën presionin e fortë amerikan dhe gjatë një periudhe rrëmuje për botën arabe, Emest Bevini, ministri i jashtëm britanik i asaj kohe, deklaroi publikisht në 14 nëntor të vitit 1945 vendimin e qeverisë së tij për tu tërhequr nga angazhimet e paraqitura në White Book-un e vitit 1939. Po ashtu ai sugjeroi që të formohej një komitet anglo-amerikan për të hetuar dhe raportuar rreth çështjes palestineze. Ky veprim pati një ndikim të mbrapshtë si në atë kohë, edhe në të ardhmen e çështjes palestineze, pasi në këtë çështje ishte parashikuar që në mënyrë të padrejtë të përfshihej dhe Amerika prozioniste. Ashtu siç pritej, ky komitet i njëanshëm rekomandoi që në vitin 1946 të bëhej emigrimi i 100 000 çifutëve të tjerë si dhe të hapeshin procedurat për shitblerjen e tokës palestineze nga ana e çifutëve.[53]

Në 2 prill të vitit 1947 çështja palestineze mori një dimension botëror, kur Britania kërkoi formalisht përfshirjen e saj në axhendën e Kombeve të Bashkuara. Pas pak kohe, u formua një komitet ndërkombëtar (UNSCOP) për të zhvilluar studime rreth kësaj çështjeje dhe për të raportuar për të. Rekomandimi bazë i këtij komiteti ishte ndarja tepër e padrejtë e vendit midis shtetit të pavarur arab dhe atij çifut. Ndërsa Jeruzalemi kishte një status të veçantë dhe ishte nën mbikqyrjen ndërkombëtare.[54]

Përgjigjja e Ligës Arabe për këtë veprim ishte e menjëhershme dhe shprehte një inat të hapur. Per kete u mbajtën dy konferenca të jashtëzakonshme; e para u mbajt në Safar më 6 shtator 1947 dhe e dyta në Alajh nga 7-15 tetor 1947. Liga Arabe refuzoi të pranonte këtë rekomandim dhe ofroi armatime dhe vullnetarë për palestinezët. Po ashtu ajo mori masa që të siguronte disa "masa paraprake ushtarake" si dhe të koordinonte rezistencën ushtarake.

---

[53]Per kete teme, shih Falah Ali, *op.cit.*. fq. 141, 181, 195-97 dhe 203-5 dhe *Harb Falastin*, fq 26 dhe 87.

[54] Falah Alt, *op. cit.*, fq.248-50.

Pavarësisht nga të gjitha këto, nën ndikimin e lobit të fuqishëm çifut nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovietik, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 29 nëntor 1947 mori një vendim që u votua nga 2/3 e saj dhe që ishte katastrofal për tokën palestineze. Kjo asamble vendosi ndarjen e Palestinës në dy shtete; në shtetin arab dhe atë çifut.

Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nuk janë të detyrueshme, madje dhe nga vetë konventat e saj, pa përmendur këtu faktin se ky vendim i saj hidhte poshtë dhe shkelte mbi të gjitha parimet mbi të cilat kjo organizatë ishte themeluar, duke përfshirë këtu të drejtën themelore të vetvendosjes për të gjithë popujt e botës. Për më tepër ky vendim i padrejte u mor duke mohuar faktin e shumicës që popullata palestineze kishte në këtë tokë. Padrejtësia vazhdoi dhe u thellua, kur një minoriteti të huaj çifut të ardhur nga jashtë kufinjve iu dha 54 % e tokës palestineze, duke anashkaluar faktin se ata posedonin vetem 6.5 % të saj dhe përbënin vetëm 31.7% të popullsisë.

Popullsia palestineze gjatë pushtimit britanik

| Viti | Arabë | | Çifutë | |
|---|---|---|---|---|
| | Përqindje | Numri | Përqindje | Numri |
| 1918 | 91.6% | 600.000 | 8.4% | 55000 |
| 1948 | 68.3% | 1390 000 | 31.7% | 646000 |

Pronësia e tokës gjatë periudhës së pushtimit britanik

| Viti | Arabë | Çifutë |
|---|---|---|
| 1918 | 98 % | 2% |
| 1948 | 93.5% | 6.5% |

## Lufta e vitit 1948 dhe pasojat e saj

Lufta e vitit 1948 arabo-zioniste nisi menjëherë pas vendimit për ndarjen e territoreve. Ushtria palestineze "*Al-Xhihad Al-Mukadas*" (Lufta e shenjte) i bëri rezistencë kësaj ndarjeje të padrejtë në një luftë të pabarabartë që zgjati 6 muaj. Po ashtu në këtë rezistencë morën pjesë dhe një numër vullnetarësh muslimanë dhe arabë, të cilët ishin të organizuar në të ashtuquajturën "*Xhajsh Al-Inkadh*" (Ushtria e Shpëtimit). Pavarësisht nga urmët e dobëta dhe tepër të papërshtatshme që kishin arritur të siguronin nga vendet arabe, ushtria palestineze luftoi trimërisht kundër çifutëve dhe me shume sukses për një kohë relativisht të gjatë. Gjatë këtij konfrontimi zionistët kishin një ushtri të fortë dhe një mbështetje të vazhdueshme nga forcat e tërhequra britanike.

Në fakt ushtria palestineze dhe populli i saj kishin arritur të ruanin të paprekur 82% të tokës palestineze dhe po ashtu ia kishin arritur ti shkaktonin dëme të mëdha çifutëve të demoralizuar, saqë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në mars të vitit 1948 vendosën të tërhiqeshin nga zbatimi i këtij plani të copëtimit të tokës së këtij vendi.

Një pikë tjetër tepër e rëndësishme ishte pozita jo e favorshme që pati ushtria arabe në këtë lufte. Ajo ishte një ushtri e kequdhëhequr dhe pjesmarrja e saj në luftë ishte një tragjedi e paprecedentë. Numri prej 24 000 ushtarësh që kishte kjo ushtri nuk mund të krahasohej me 70 000 ushtarë të mirëkompletuar çifutë. Po ashtu, ata nuk ishin të mirëinformuar për natyrën e vendit të betejës dhe midis forcave të tyre kishte një koordinim të dobët të veprimeve që ndërmerreshin. Një prob- lem tjetër i tyre ishte dhe mungesa e armatimeve si dhe udhëheqësit e korruptuar e të paaftë që drejtonin luftën. Ndër 50 komandantët e një prej ushtrive arabe 45 ishin komandantë britanikë që, në vend që të luftonin zionistët, ata i angazhuan disa nga këto ushtri amatore ne carmatimin dhe jo armatimin e luftëtarëve palestinezë. Mbi të gjitha këto probleme të rëndësishme qëndronte fakti që kishte të bënte me mosmarrëveshjet midis vendeve arabe si dhe dominimi imperialist britanik në shumicën e tyre.

Entuziazmi dhe devocioni i madh i palestinezëve si dhe i popullit të vendeve arabe për xhihadin ishte rrënuar që në themel nga udhëheqja e paaftë politike dhe ushtarake e këtij vendi.

Lëvizja *Al-Ikhuan Al-Muslimun* (Vëllezërit Muslimanë), e themeluar në Egjipt është një shembull i luftës këmbëngulëse për çlirimin e Palestinës. Po ashtu udhëheqësit e saj, të quajtur ndryshe Murshid- ër, ku përmendim martirin Hasan Al-Benna, dolën vullnetarë në tetor të vitit 1948 për të dërguar një grup prej 10 000 muxhahidinësh për në fushën e betejës. Megjithatë, pak prej tyre arritën të kalonin përmes barrierës së vendosur nga qeveria egjiptiane dhe luftuan me guxim atje ku vlonte lufta. Por, përpara se të arrinin të ktheheshin në shtëpi, ata u arrestuan dhe u burgosën. Autoritetet qeveritare vazhduan më tej duke e shkrirë këtë organizatë dhe madje duke vrarë edhe trurin e saj, si drejtuesin Al-Benna në 11 shkurt të vitit 1949. Kjo ndodhi pak para se të nënshkruhej një armëpushim i turpshëm me bashkësinë zioniste, "Izraelin".

Po ashtu në këtë luftë shkuan vullnetarë nga Jordania, Siria, Iraku si dhe nga vende të tjera muslimane dhe arabe, duke përfshirë këtu dhe 250 luftëtarë vullnetarë boshnjakë. Të gjithë ata, ashtu si dhe grupimi i Vellezerve Muslimane, luftuan heroikisht në këtë luftë. Por ajo çka i kishte vrarë më shumë palestinezët ishte fakti se ata ishin çarmatosur në mënyrë të turpshme nga trupat arabe dhe ushtarët arabë vetë ishin tepër të mërzitur nga armatimet tepër të vjetra që i ishin vënë në përdorim. që në raste të shumta u kishin shpërthyer në fytyrë.

Pasi arritën të shpartallonin ushtritë arabe dhe pasi shtinë në dorë 78% të territorit palestinez, çifutët, më 14 maj 1948, shpallën shtetin e tyre, Izraelin. Me këtë rast palestinezët shpallën, në konferencën e mbajtur në Gaza, në tetor të po atij viti, formimin e qeverisë së Palestinës, që nënkuptonte të gjithë territorin e Palestinës. Por trupat arabe të përqendruara në Palestinë nuk e lejuan që ajo të funksiononte dhe vetë Haxhi Amini Al-Huseini u débua nga Gaza për në Egjipt si person I padëshiruar.

Menjëherë pas luftës, bandat çifuto-zioniste përzunë me dhunë nga vatrat e tyre dhe dëbuan jashtë vendit rreth 60% të popullit palestinez

(afërsisht 800 mijë nga I milion 390 mijë banorë gjithsej). Ndërsa 30 000 të tjerë u detyruan të shpërngulen në rajone të veçanta brenda territoreve të pushtuara. Kriminelët zionistë shkatërruan 478 fshatra palestineze, nga 580 që ishte numri i tyre. Gjatë kësaj lufte zionistët kanë kryer 34 masakra, më barbarja e të cilave njihet të jetë ajo e 10 prillit 1948, e zhvilluar në Deir Jasin. Në këtë masakër, sipas burimeve zioniste, u therën 254 burra, gra dhe fëmijë.[55]

Ky ishte një nga të ashtuquajturit "mision civilizues", me të cilin mburren zionistët dhe mbështetësit e tyre.

Lufta e vitit 1948 e shkatërroi infrastrukturen social-ekonomike palestineze dhe ata u hodhën befas në një labirint, pas një rezistence 4500 vjeçare që ky popull bëri për mbrojtjen e vendit të tij.

Eshtë me të vërtetë gjëja më e padrejtë dhe më e pandershme që mund tju bëhet këtyre njerëzve të thjeshtë muslimanë, duke i bërë që të paguajnë për një gabim që nuk është aspak i tyre dhe që ka të bëjë me persekutimin që iu bë çifutëve në Europë nga ana e nazi-gjermanëve dhe Rusisë anti-semitike. Po ashtu, në vazhdimësi të kësaj padrejtësie, ata u përzunë nga shtëpitë e tyre për të lënë të zbatohej një kapriço e fuqive imperialiste prozioniste.

Çifutët që kishin kaluar vetë një persekutim në Europë, me anë të një rruge të përgjakshme dhe pa treguar as shenjën më të vogël të pendesës apo të ndjenjës së fajit, vendosën të themelonin një bashkësi të huaj në Palestinë.

Në të vërtetë komandanti i tyre ushtarak, që më vonë u bë ministri i mbrojtjes (i njohur ndryshe si arkeologjist) Moshe Dajan, pranoi hapur faktin se ky krim u krye në një formë të tillë ku: "Çdo fshat çifut u ndërtua mbi fshatin e mëparshëm palestinez."[56]

---

55 Shih Ibrahim Abu Xhabir, "Al-Mujtama al-Arabi fi Israel", (Shoqëria arabe në Izrael). Jawad al-Hamad (editor), *al-Madkhal ila al-Qadiyyah al-Falastiniyyah, (Hyrje në çështjen palestineze)*, (Aman. 1997), fq.427. p.427; dhe Salaman Abu Sitta, *Pales- tintan Right to Return*. (Londër, 1999), fq. 16 an 27.

56 *Haquiq ua Abatil fi al-Sira al-Arabi al-Israeli, (Të vërteta dhe të pavërteta në konfliktin arabo-izraelit)*, (Aman, 1992), fq.85. Teksti origjinal i ketij artikulli ndodhet ne arkivin eThe Guardian", te dates 14 nëntor 1973.

Kjo gjë ndodhi në shumë raste dhe, megjithëse nuk ishte e drejtpërdrejtë, u konfirmua nga vetë Kombet e Bashkuara në rezolutat e saj të njëpasnjëshme që kërkonin rikthimin në shtëpitë e tyre të 4.7 milionë refugjatëve palestinezë, që kishin dalë jashtë kufijve të atdheut të tyre. Një pjesë tjetër e përbërë nga 1.6 milionë palestinezë që jetonin në Bregun Perëndimor dhe në Gaza u detyruan që të shpërnguleshin me forcë nga shtëpitë ku banonin dhe u ndanë nga familjet e tyre me dhunë (bazuar në vlerësimet e bëra për vitin 2000).

# KAPITULLI III

## ÇËSHTJA PALESTINEZE NË VITET 1949-1967

Katastrofa e madhe që kaploi vendin në vitin 1948 bëri që të krijohej një ndjenjë hidhërimi dhe poshtërimi në mesin e palestinezëve, arabëve dhe muslimanëve në përgjithësi. Për të parën herë në histori populli palestinez e gjeti veten të dëbuar dhe të sunduar nga regjime që nuk u interesonte asgjë rreth të drejtave të tyre civile dhe dëshirës së tyre të zjarrtë për të arritur një organizim politik dhe ushtarak, në mënyrë që të fitonin pavarësinë dhe lirinë e tyre. Megjithatë këta njerëz me dhunti dhe krijues e përshtatën veten dhe reaguan pozitivisht ndaj këtyre sfidave, vështirësive dhe kushteve të papërshtatshme. Një armë e veçantë e tyre që i ndihmoi që të përballeshin me sfidat e së ardhmes ishte dëshira dhe entuziazmi për arsimim. Si rrjedhim palestinezët janë ndër popujt më të edukuar në gjirin e popujve arabë.

### Vendet arabe dhe Palestina

Gjatë periudhës së viteve 1949-1967 imperializmi fizik kishte arritur të subvencionohej në mënyrë progresive në shumicën e botës muslimano-arabe. Ky imperializëm luajti një rol përkrahës të hegjenomisë kulturore perëndimore, që kishte arritur të mbizotëronte regjimet ushtarake dhe civile të ashtuquajtura "të pavarura", qofshin keto regjime liberale, socialiste apo konservatore. Ata kishin një orientim laik dhe bënë çështë e mundur që të forconin udhëheqjen e tyre dhe kombëtarizmin sesa të forconin ndjenjën e të qënit një umet (popull). Këto zhvillime historike e bënë të pashmangshme fragmentimin

e botës arabe, ndonëse nocioni "beteja kombëtare arabe" ishte keqkuptuar dhe në një formë të tillë kishte mbizotëruar në arenën politike. Kjo gjë kishte ndodhur veçanërisht në Egjipt, nën udhëheqjen e Xhemal Abdul-Naserit. Gjatë kësaj faze të historisë palestinezët i kishin varur pothuajse të gjitha shpresat e tyre në këtë sllogan të famshëm, si dhe besonin shumë se regjimet e korruptuara arabe do të arrinin të çlironin vendin e tyre nga pushtimi zionist.

Sllogani i shumëpërsëritur dhe i shumëpërdorur "bashkimi është mjeti për të arritur lirinë" në fakt nuk ishte gjë tjetër vetëm një fasade e politikave shtypëse të përdorura nga disa udhëheqës të falimentuar që nuk kishin largpamësinë, vullnetin dhe vendosmërinë e duhur.

Rezultati i kësaj situate ishte përhapja në mase e dëshpërimit dhe mërzisë ndër masat dhe veçanërisht kjo erdhi pas deshtimit drastik të bashkimit egjipto-sirian (1958-1961) dhe ajo që pati një ndikim katastrofik ishte lufta Arabo-Izraelite e vitit 1967, pas së cilës pjesa e mbetur e Palestines, Sinait dhe Lartësive Golan i kaluan në mënyrë të turpshme sundimit zionist. Në kurriz të Lëvizjes Islame në këtë periudhë lulëzuan shumë ndjenjat e nacionalizmit dhe radikalizmit. Megjithatë kjo lëvizje pësoi goditje të rënda dhe të vazhdueshme nga Naseri dhe përkrahësit e tij.

Në të vërtetë regjimet arabe ishin aq të dobëta dhe pa vizion për të arritur çlirimin e Palestinës, saqë për të siguruar pushtetin e tyre punuan hapur dhe fshehtas për të pranuar fatin që u ishte përcaktuar me anë të një marrëveshjeje me shtetin zionist. Duke qenë se nuk ishin të zotë që ta shfaqnin hapur qëllimim e tyre, ata luajtën me ndjenjat e masave duke e fryrë dhe duke i bërë bujë betejës së pashmangshme të "lirise".

Në kohën që këto seri gënjeshtrash vazhdonin të qarkullonin në botën arabe, shteti i ri çifut do të konsolidonte fuqinë dhe sundimin e tij mbi Palestinën.

Ndërkohë, regjimet arabe nuk e konsideruan rezistencen palestineze si pjesë të strategjisë gjithëpërfshirëse, por si një lëvizje të thjeshtë taktike që do të shërbente për të konsoliduar dhe zgjatur sundimin e tyre. Shtetet e ashtuquajtura "shtete kundërshtare" kishin ndjekur dy

linja politike përballë rezistencës.

Së pari, për të siguruar regjimet e tyre dhe për ti mbajtur ata të gjallë nga çdo sulm raprezaljesh zioniste, ata mbanin nën kontroll rezistencën dhe ia mohonin asaj të drejtën e posedimit të një leje apo carte blanche për të zhvilluar operacione ushtarake guerrilase përgjatë kufijve të këtyre shteteve. Në të vërtetë kjo politikë që mbizotëronte atëherë në të gjitha shtetet arabe që janë fqinjë të Izraelit ekziston edhe sot.

Së dyti, ata lejuan që rezistenca ushtarake të përqendrohej në territoret e tyre si një mjet për të pasur arritje politike apo për të mënjanuar trazirat e brendshme. Duke përjashtuar disa raste të veçanta, përgjithësisht në pjesën jugore të Libanit, pjesë në të cilën është strehuar një bazë e fortë e rezistencës gjatë gjithë periudhës së viteve 1967- 1982, kufijtë e "shteteve kundërshtare (konfrontuese)" kanë qenë për pesëdhjetë vitet e fundit praktikisht të mbyllur për aktivitete revolucionare palestineze kundër bashkësisë zioniste. Megjithatë, në Liban elita udhëheqëse ka qenë shumë e dobët për ti mbyllur rrugën rrymës së gjerë revolucionare që ekziston atje dhe më gjerë në rajon.

## Lufta kombëtare palestineze

Përgjigjja e popullit palestinez për këtë bllokim të rezistencës së tyre të armatosur ishte praktike dhe pragmatike në të njëjtën kohë. Ndër karakteristikat e saj më kryesoret ishin:

- Në mënyrë që ti bënin ballë tronditjes së thellë dhe të përshtateshin sa më mirë me realitetin e ri, ata kultivuan sigurinë në vetvete dhe u përqendruan në edukimin e brezave të rinj palestinezë.
- Bashkimi me krahun e majtë; nacionalistët, komunistët, ashtu si dhe aleancat dhe grupimet politike islamike. Kështu u bashkëpunua me Nasirijunët dhe partinë al-Bathi nga komunistët, si dhe grupimet Al-Ikhvan al-Muslimin (Vëllezërit Muslimanë) dhe Hizb al-Tahrir

al-Islami (Partia Islame Çlirimi) që ishin prej grupimeve islame.

- Përpjekja për të arritur formimin dhe forcimin e identitetit kombëtar palestinez, pa pasur parasysh faktin se një detyrë e tillë dukej e vështirë përballë rrymës dominuese të të majtëve nacionalistë (formimi i Lëvizjes Fatah dhe Organizatës për Çlirimin e Palestinës).
- Eksodin e shume palestinezëve për të fituar jetesën përgjithësisht në bregun lindor të lumit Jordan dhe në shtetet e Gjirit, ku përmenden veçanërisht Arabia Saudite dhe Kuvajti.
- Nxjerrja në mënyrë graduale jashtë funksionit e lidershipit të Haxhi Amin Al-Huseinit.

Me iniciativën e qeverisë jordaneze, disa personazhe të shquar palestinezë organizuan në dhjetor të vitit 1949 mbajtjen e një konference në Xheriko (Ariha). Kjo konferencë e shpalli mbretin Abdullah ibn al-Husein mbret të Palestinës. Ky hap u pasua nga aneksimi formal nga ana e Jordanisë e Bregut Perëndimor, që përbënte territorin më të madh (rreth 5878 km², afërsisht rreth 21.77 % të sipërfaqes së përgjithshme të Palestinës) të asaj çka kishte mbetur nga Palestina. Po ashtu, si pasojë e këtij hapi, erdhi dhe deklarata e muajit prill 1950, që kishte të bënte me bashkimin e Bregut Lindor dhe atij Perëndimor. Nga ana tjetër, kontrolli administrativ i Rripit të Gazës (rreth 363 km², afro 1.34 % e sipërfaqes së përgjithshme të Palestinës) i kaloi Egjiptit.

Ndërkohë për Haxhi Aminin dhe kolegët e tij u vendosën kufizime të rrepta në Këshillin e Lartë Ekzekutiv Arab dhe në qeverinë e gjithë Palestinës. Ndër këto kufizime përfshiheshin dhe një embargo për aktivitetet politike në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës. Duke qenë se në Egjipt Haxhi Amini ishte në pozitat e një pengu, ai u detyrua të shkonte në Liban në vitin 1958 dhe "qeveria" së bashku me "këshillin" e tij u reduktuan në trupa ceremoniale, pa asnjë fuqi apo influence. Ne vitin 1952 presidenti i të ashtuquajturës "qeveri palestineze" u bë një simbol i vërtetë përfaqësues i Palestinës në Ligën Arabe.

Në fakt, roli që ka luajtur Haxhi Amini është shumë kontradiktor dhe i diskutueshëm. Ndërkohë që shumë e përmendin atë si udhëheqësin e padiskutueshëm kombëtar të palestinezëve deri në mesin e viteve

1950, disa të tjerë e dënojnë si përgjegjësin e drejtpërdrejtë për humbjen e madhe dhe tragjike të vendit të tyre, Palestinës. Megjithatë, ai ishte njeri i ndershëm dhe i vendosur dhe nga ana tjetër ishte figura bazë e Luftës Kombëtare Palestineze per tridhjetë vjet me radhë.

"Vëllezërit Muslimanë", që gëzonin një liri jo të plotë në Egjipt dhe Jordani gjatë periudhës 1949-1954, arritën të kishin një popullaritet të konsiderueshëm në mesin e palestinezëve në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës. Ky popullaritet vinte si pasojë e sakrificave të tyre në luftën e vitit 1948, si dhe për programin e tyre të bazuar në parime kombëtare dhe islame.

Hizbu al-Tahrir, grupacioni i cili ngriti flamurin e Kalifatit, ishte po ashtu në pozita të fuqishme dhe prestigjioze në Jordani në mesin e viteve 1950. Ndërkohë që i bënin thirrje studentëve dhe punëtorëve, slloganet e famshme të komunistëve, përfshi këtu dhe nxjerrjen jashtë loje të elitës duke shfrytëzuar akuzat si tradhëtarë dhe agjentë, kishin arritur që të dështonin plotësisht në kontrollimin e ngritjes së lëvizjes islame. Por lëvizja islame pati probleme nga vrasjet e kryera nga Naseri dhe fushata e tij jo e ndershme kunder "Vëllezërve Muslimanë", të cilët, me gjithë këtë, udhëhiqeshin nga mësimet e liderit të tyre për një mospërgjigje dhe mosreagim të përkohëshm ndaj këtyre veprimeve si dhe për të mbajtur të pastër shpirtrat e tyre kundrejt sulmeve që po pësonin.

Megjithatë, Lëvizja Islame pati një popullaritet në mesin e palestinezëve (e kjo deri në fundin e viteve 1950), ashtu siç dhe tregohet nga mbizotërimi që ata kishin në Unionin e Studentëve Palestinezë në Egjipt deri në vitin 1957, kryetar i së cilës ka qenë dhe Jaser Arafati, një mbështetës i Ikhuanëve.

Rezistenca palestineze gjatë kësaj periudhe të vështirë ishte padyshim në një pozitë shumë të rëndësishme. Gjatë gjysmës së parë të viteve 1950 ajo ndërmori sulme të shumta, por të veçuara dhe po ashtu drejtoi dhe mësymje përgjatë kufijve për të rimarrë territoret palestineze. Në të njëjtën kohë kjo lëvizje organizoi shpërthime të ndryshme kundër zionistëve.

Në rripin e Gazes Ikhuanët formuan një organizatë paramilitare

që planifikoi dhe drejtoi disa sulme ushtarake duke bashkëpunuar me beduinët e Naxhevit (al-Naqab) dhe me një oficer egjiptian që ndodhej në Rripin e Gazës dhe quhej Abdul-Munim Abdul-Rauf. Në atë kohë kishte njoftime se ata mund të kishin planifikuar një nga operacionet ushtarake më të fuqishme, siç ishte sulmi ndaj një autobuzi izraelit në 17 mars të vitit 1954. Në këtë sulm që ndodhi në vendin e quajtur Bir- Shepa vdiqën 11 zionistë.[57]

Reagimi i zionistëve kundrejt këtyre sulmeve, si ndaj atij të Bregut Perëndimor apo atij të Rripit të Gazës, ishte tepër i dhunshëm dhe arrogant. Ata ndërmorën ndaj popullsisë së pafajshme një sërë masakrash, si ajo e Kibjes e datës 14-15 Tetor 1953, në të cilën ranë shehide 67 vetë.[58]

Po ashtu përmendim masakrën e Gazës, më 28 shkurt 1955, numri i viktimave të së cilës ishte 39 të vdekur dhe 33 të plagosur.

Pas kësaj tragjedie të fundit dhe nën presionin e banorëve. lidershipi egjiptian ua kaloi palestinezëve përgatitjen e sulmeve dhe udhëheqjen e tyre e mori oficeri patriot Mustafa Hafiz. Një numër sulmesh të mëdha dhe të vogla u ndërmorrën në mënyrë të suksesshme gjatë periudhës së viteve 1955-1956.[59]

Ndër arsyet kryesore të pjesëmarrjes së zionistëve në agresionin tripalësh britaniko-francezo-çifut kundër Egjiptit ishte shtypja e rezistencës revolucionare palestineze në Rripin e Gazës, sigurimi i lirisë për lundrimin e anijeve izraelite në Detin e Kuq si dhe zbatimi i planeve të tyre ekspansioniste dhe imperialiste.

Nga ana e tyre britanikët ishin të vendosur ti bënin ballë veprimeve të guximshme që kishin një interes kombëtar në lidhje me Kanalin e Suezit dhe që sfidonte epërsinë e tyre të hershme mbi këto rrugë detare me rëndësi jetësore për ta.

Ndërsa francezët ishin të motivuar për të marrë drejtimin e një sulmi raprezaljesh kundër Egjiptit për mbështetjen që ky vend i kishte

[57]Rreth këtij operacioni, shih: P.R.O., FO. 371/111077. FO. 371/111098 111100
[58] *Al-Mawsuah al-Falastinijah*, (Enciklopedia Palestineze) Vol 3, fq.502-4
[59] Ibid, Vol.3. fq.393-98.

dhënë revolucionit algjerian.

Rezultat i këtij agresioni ishte shkatërrimi anglo-francez i aeroporteve dhe porteve egjiptiane. Po ashtu, si pasoje e kësaj erdhi dhe aneksimi i menjëhershëm i Rripit të Gazës dhe Sinait nga ana e izraelitëve. Kjo ngjarje nxori në pah një dobësi tronditëse të ushtrisë egjiptiane si dhe një paaftësi të madhe të lidershipit politik. Megjithatë, media egjiptiane e cila kontrollohej nga shteti bëri që kjo gjë të jepej në një formë shumë të butë dhe ky skandal të zvogëlohej. Ajo pati ndikim në anën emocionale të njerëzve gjatë paraqitjes jo të sakte që i bëri tërheqjes, nën presionin amerikan, të pushtuesve në 6 mars 1957 si dhe refuzimit publik të Naserit për tu dorëzuar si shenjë e një fitoreje të plotë ushtarake. Ky ishte një rast tjetër kur Naseri u vendos në qendër të vëmendjes.

## Themelimi i Lëvizjes Fatah

Shtypja dhe persekutimi i lëvizjes islame, veçanërisht në Egjipt dhe Gaza, provokuan polemika në mesin e rinisë muslimane palestineze rreth mënyrave dhe mjeteve më të mira të mundshme për të çliruar Palestinën. Një ndër mënyrat që mbizoteronte ishte përqendrimi dhe ruajtja e edukimit dhe besimit islam. Për këtë një grup militantësh vendosën të formonin një organizatë militante, që hapur do të dilte si kombëtare, por që në thelb do të ishte islame. Në këtë mënyrë ata do të arrinin të afronin rreth vetes dhe do të mbeshteteshin nga të rinjtë e drejtimeve politike të ndryshme.

Në këtë mënyrë, e modeluar sipas shembullit të asaj që ndodhej në Algjeri, levizja Fatah (Lëvizja për Çlirimin e Palestines) u themelua në 1957 në Kuvajt. Kjo gjë më së shumti u nxit nga pjesëtarët e "Vellezerve Muslimanë" në Rripin e Gazës. Nismëtar i këtij hapi ishte Khalil al-Vazir (Ebu Xhihad), i cili u bë numri dy i lëvizjes Fatah për tridhjetë vjet me radhë. Po ashtu ai ishte personi që hodhi në parim idenë e themelimit të lëvizjes Fatah si udhëheqje e lartë e Ikhuanëve në Gaza, megjithëse ai nuk gëzonte popullaritet. Megjithatë ai arriti ta zbatojë

projektin e tij dhe disa figura të rëndësishme të grupit të Ikhuanëve u bashkuan me lëvizjen Fatah. Ndër ta përmendim: Said al-Muzajin, Galib al-Vazir, Salim al-Zanun, Salah Khalaf, Asad al-Saftaui, Muhamed Jusuf Al-Naxhar, Kamal Uduan, Rafik Al-Natshah, Abdul-Fattah Hamud dhe Jusuf Amirah, të cilët zunë poste drejtuese në këtë lëvizje. Gjatë kohës së rekrutimit të rekrutëve deri në vitin 1963, lëvizja Fatah si rrjedhim i hapi dyert e saj për anëtarë nga lëvizje të ndryshme, e veçanërisht pasi udhëheqja e Ikhuanëve ndaloi që anëtarët e saj të ishin njëkohësisht anëtarë në dy organizata.[60]

Që nga ai moment dhe deri sot lëvizja Fatah filloi të kishte një orientim kombëtar dhe laik. Në datën 1 janar 1965 krahu i saj ushtarak Al-Asifah (Stuhia) nisi rezistencën ushtarake dhe pas shpërthimit të luftës së qershorit 1967, ky krah ushtarak organizoi 200 operacione ushtarake kundër zionistëve.[61]

Shumë nga themeluesit e Lëvizjes Kombëtare Arabe (Al- Kaumijun Al-Arab) të mesit të viteve 1950 ishin studentë palestinezë nga Universiteti Amerikan i Bejrutit, ndër të cilët me i njohuri ishte Xhorxh Habash. Kjo lëvizje vuri gurin themeltar për themelimin e Bashkësisë Arabe (Arab Unity) dhe çlirimin e Palestinës. Po ashtu ajo mbështeti politikat e ndjekura nga Naseri dhe formoi më 1958 Komitetin e Palestinës. Pas dështimit të bashkimit siriano-egjiptian, kjo lëvizje ndoqi rrugën e luftës popullore dhe mendimit socialist. Në maj të vitit 1964, ajo themeloi "Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Palestinës" dhe krahun e saj ushtarak që njihej me emrin Shabab al-Thar (Rinia hakmarrëse). Në vitin 1966 kjo lëvizje adoptoi idetë marksiste dhe në aleance me forcat e tjera në dhjetor të vitit 1967 themeloi "Frontin Popullor për Çlirimin e Palestines"[62].

---

60 Shih Abdullah Abu Azzah. *Ma al-Haraka al-Islamiyyah fi al-Duwal al-Arabijah* (Me levizjet islame në vendet arabe). (Kuvajt, 1986), fq.71-96 dhe Mohsen M. Saleh, *Al-Tariq ila al-Knds, (Rruga për ne Kuds)*, (Londër, 1998), fq 160-63.

61 Salah Khalaf, *Falastini bila Hawijah* (Palestinez pa identitet), (Aman, 1996), fq. 75-83

62 Fawzi Taim. "The Palestinian political forces", n*e Al-Madkhal ila al-Kadijah al-Falastinijah*, (Hyrje në çështjen palestineze), *op.cit.*, fq. 357-8. Shih gjithashtu: Riyadh Al-Rayyis and Dunya Nahhas, *Al-Masar Al-Sa'b. Al-Makawamah Al-Filistinijah: Munazamatuha, Ashkhasuha, Alakatha, (Rezistenca palestineze; institucionet, personalitetet dhe lidhjet mes tyre)*, (Bejrut, 1976), fq 49-52.

## Themelimi i Organizatës për çlirimin e Palestinës: (O.Ç.P.)

Lëvizjet e shumta e të fshehta politike dhe ushtarake nga ana e palestinezëve rrezikonin të provokonin një krizë në rajon, që mund të çonte në veprime ndëshkuese nga ana e izraelitëve kundër regjimeve të dobëta arabe. Për të siguruar që një gjë e tillë të mos ndodhte dhe për tu ruajtur nga një rrezik i tille, elita e udhëheqjes arabe, e në veçanti ajo që kishte lidhje me Naserin nga Egjipti shprehën idenë e formimit të një trupi zyrtar palestinez i cili do të ishte nën kontrollin e tyre.

Në vitin 1959 këshilli i Ligës Arabe kaloi një rezolutë për riorganizimin e palestinezëve nëpërmjet një trupi të bashkuar përfaqësues. Por nga ky plan asgjë nuk doli në dritë deri në vitin 1963, kur përfaqësuesi i Palestinës në Ligën Arabe Ahmed Hilmi Abdul-Baki, u largua nga posti i tij.

Vendin e tij, me anë të mbështetjes që i dha Naseri, e zuri Ahmed al-Shukairi. Këtë të fundit samiti arab i Kajros i datës 13 janar 1964 e delegoi që të raportonte në Këshill përsa i përket mënyrave dhe mjeteve që duheshin përdorur që populli palestinez të arrinte të gjente forcën që do e çonte drejt çlirimit dhe vetvendosjes. Al-Shukairi ishte në dijeni për intrigat dhe konfliktet që ekzistonin brenda Liges Arabe dhe për këtë ai i ndryshoi termat e referimit të tij dhe me ndihmën tepër aktive të Egjiptit formoi Organizatén për Çlirimin e Palestinës ( O .C.P.) .

Nën patronazhin e mbretit Husein të Jordanisë, më 28 maj 1964, u mbajt në Jeruzalem Kongresi i Parë Kombëtar Palestinez, në të cilin morën pjesë 422 përfaqësues palestinezë. Në këtë kongres u vendos që O.C.Ptë kalonte nën udhëheqjen e Al-Shukairit. Po ashtu ky kongres miratoi statutin kombëtar palestinez si dhe bëri thirrje për luftë të armatosur për çlirimin e të gjithë Palestinës, duke mos pranuar të dorëzohej asnjë pjesë të saj.

Kjo organizatë e re formoi gjithashtu dhe krahun e saj ushtarak që u njoh me emrin Ushtria për Çlirimin e Palestinës. Nga ana tjetër kjo organizatë ndërmori një fushatë mediatike të mirëplanifikuar për njohjen e saj. Në përgjithësi palestinezët e mirëpritën këtë organizatë të re (O.C.P.), si një mjet për të theksuar ekzistencën dhe identitetin e tyre kombëtar. Kjo pa pasur parasysh se Lëvizja Fatah vuri në dyshim arsyet e vërteta të kësaj lëvizjeje si dhe mundësitë e saj për të arritur objektivat e deklaruara.[63]

## Lufta e vitit 1967 dhe pasojat e saj

Xhemal Abdul-Naseri herë pas here ishte gjendur në një përshkallëzim të natyrës së tij të kapardisur dhe njëkohësisht të ashpër. Kjo gjë arriti kulmin në fund të majit 1967 me anë të mbylljes së njëanshme, që ai i bëri lundrimeve në ngushticën e Tiranit në Detin e Kuq si dhe dëbimin e vëzhguesve të paqes të dërguar nga Kombet e Bashkuara përgjatë gjithë vijës kufitare egjiptiane. Regjimet arabe e shpallën veten të gatshme ndaj asaj që ata e quanin "beteja e shumëpritur për çlirim". Kështu lufta e qershorit shpërtheu kur forcat izraelite papritmas sulmuan dhe dëmtuan rëndë në 5 qershor 1967 të gjithë forcën ajrore egjiptiane, jordaneze dhe siriane. Zionistët arritën të aneksonin dhe pjesën e mbetur nga Palestina brenda një kohe mjaft të shkurtër prej 6 ditësh. Ndër to përfshiheshin Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës, secili nga 5878 dhe 363 km, shkretëtira egjiptiane e Sinait (61 198 km$^2$) si dhe Lartësitë Siriane Golan (1 150 km$^2$).

Në këtë konflikt u shkatërrua 80 % e armatimit egjiptian dhe u vranë 10 000 egjiptianë, 6094 jordanezë dhe 1 000 sirianë. Po ashtu 33000 palestinezë u dëbuan nga trojet e tyre. Tregohet se ushtarët zionistë

[63] Për më tepër rreth O.C.P-se shih Asad Abdul-Rahman, *Munzamat al-Tahrir al-Falastiniah*,(Organizata per Çlirimin e Palestines), (Nikozia, 1985) dhe *Al-Mawsuah al-Falastinija*, (Enciklopedia palestineze). Vol 4, fq. 313-25 dhe Helena Cabban. *The Palestinian Liberation Organisation: People power and Politics* (U.S.A., 1991).

hynë në Jeruzalem dhe në xhaminë Al-Aksa duke ulëritur në mënyrë histerike: "Feja e Muhamedit tashmë është një gjë që i përket së shkuarës", "Muhamedi ka vdekur....ai ka lënë pas gra", "Hakmarrja për Hajberin!" etj.

Kjo katastrofë e paprecedentë e befasoi dhe e tronditi popullin arab, i cili, pas nëntëmbëdhjetë vjet iluzionesh, zbuloi mashtrimin që i kishte bërë shtresa hipokrite elitare që udhëhiqte vendin.

Shkëlqimi i famës së Xhemal Abdul-Naserit u venit dhe populli arab i humbi shpresat në regjimet që i qeverisnin.

Megjithatë, nga ana tjetër, populli palestinez mori iniciativën dhe lëvizjet e tyre kombëtare lulëzuan drejt zhvillimit. Por një veprim për të ardhur keq ishte që pas kësaj, regjimet arabe dhe O.C.P u përqendruan në rimarrjen e tokave të pushtuara në 1967, Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës që përbëjnë rreth 23 % të Palestinës. Në këtë mënyrë ata i lanë në harresë dhe i neglizhuan tokat e tjera palestineze që u humbën në luftën e viti 1948, për të cilat u bë gjithë kjo sakrificë dhe përpjekje.

# KAPITULLI IV

# ÇËSHTJA PALESTINEZE GJATË VITEVE 1967-1987

## Nevoja e menjëhershme e identitetit kombëtar palestinez

Për ti bërë ballë pakënaqësisë gjithnjë në rritje të pasluftës dhe apatisë, regjimet arabe u detyruan që të lejonin krijimin e një force rezistence komando, e cila mori hov në Liban dhe Jordani. Nën udhëheqjen lëvizjes Fatah, organizatat komando arritën të kishin në dorë udhëheqjen e O.C.P-së dhe bënë thirrje për luftë të armatosur dhe guerilase kundër zionistëve.

E udhëhequr nga Jaser Arafati, O.C.P-ja arriti të sigurojë në samitin e Rabatit në tetor të vitit 1974 njohjen e saj nga shtetet arabe si përfaqësuese më legjitime e popullit palestinez. Në nëntor të vitit 1974 kjo lëvizje shënoi një arritje tjetër politike, kur Arafati iu drejtua Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe organizatës së tij O.Ç.P- së iu dha një statut vëzhguesi në Organizatën të Kombeve të Bashkuara. Ndryshe nga mënyra e vjetër, tashmë Kombet e Bashkuara nuk e trajtuan më çështjen palestineze thjesht si një çështje refugjatësh, por që nga dhjetori 1970 ata e njohën ekzistencën dhe identitetin e popullit palestinez. Gjatë viteve 1970, kjo organizatë miratoi disa rezoluta dhe mbështeti të drejtat e palestinezëve për vetvendosje si dhe doli në mbrojtje të luftës së tyre për të fituar të drejtat legjitime nëpërmjet mënyrave të ndryshme, përfshirë këtu dhe përleshjet e armatosura.

Që nga viti 1974 çështja palestineze ishte bërë për të parën herë një pikë e veçantë në axhendën e Kombeve të Bashkuara. Rezoluta

numër 3236 e 22 nëntorit të vitit 1975 e emëruar "Të drejtat e popullit palestinez", pohoi të drejtat e tyre për vetvendosje pa pasur ndërhyrje nga jashtë si dhe të drejtën e tyre për të zgjedhur pavarësinë, sovranitetin kombëtar, kthimin në atdheun e tyre dhe luftën për të rivendosur të drejtat e tyre me anë të mënyrave të përcaktuara nga statuti dhe konventata e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kjo rezolutë dhe të tjera i shqetësuan izraelitët dhe sidomos në vitin 1975, kur Organizata e Kombeve të Bashkuara e konsideroi "Zionizmin" si një formë "apartedi". Megjithëse Shtetet e Bashkuara të Amerikës vunë veton e tyre në të gjitha këto rezoluta[64], lufta e armatosur palestineze tërhoqi vëmendjen e të gjithë botës dhe bëri që e gjithë shoqëria botërore të dëgjonte zërin e Palestinës.

Po të mos ekzistonin mosmarrëveshjet që filluan brenda lëvizjes së rezistencës si dhe po të mos ndodhte shpërbërja e brendshme e botës muslimano-arabe, mbështetja e rëndësishme e komunitetit ndërkombëtar mund të ishte shfrytëzuar në mënyrë më dobiprurëse në shërbim të çështjes palestineze.

Kjo çështje kishte arritur të shënonte nivele të kënaqshme arritjesh gjatë viteve 1967-1987. Gjatë kësaj periudhe ajo përfitoi shumë nga ana politike si nga fronti ndërkombëtar, ashtu dhe ai rajonal. Përveç këtij fakti, mbështetja e dobishme arabe gjatë gjysmës së parë të periudhës së ngjarjeve ishte një nxitje për shtimin e forcave dhe luftën guerilase.

## Lufta e armatosur palestineze

Vitet 1967-1970 ishin vitet e një periudhë të artë për rezistencën e armatosur palestineze, pasi si kufijtë e Jordanisë (360 kilometra), ashtu dhe kufijtë e Libanit (79 kilometra) me Palestinën ishin të hapura për operacionet komando. Beteja e famshme e Karamës, e zhvilluar në 21 mars 1967, u kushtoi shtrenjtë zionistëve. Ajo ishte një fitore aq e madhe

[64] Për çështjen e Palestinës në Kombet e Bashkuara, shih Ibid, Vol. 1, fq. 360-62, 552- 63; dhe Vol.2, fq.260.

morale dhe materiale për rezistencën palestineze, saqë shumë vullnetarë u sulën të mbushin radhët e saj. Këto operacione komando që bëheshin çdo muaj vazhduan të shtoheshin dhe nga 12 që ishin në 1967 arritën të bëheshin 52 në vitin 1968. Më pas numri i tyre në 1969 arriti në 199 dhe në muajt e parë të vitit 1970 ky numër shkoi në 279 operacione.[65]

Por përjashtimi i rezistencës palestineze nga Jordania në periudhat e mëvonshme dhe përplasjet e saj të përgjakshme me ushtrinë jordaneze në shtator të vitit 1970 dhe korrik 1971 e penguan atë nga ngjarjet më të rëndësishme të saj. Megjithatë, pas një raundi tjetër të mbushur me konflikte të dhunshme me ushtrinë libaneze, lëvizja e rezistencës arriti tu imponijë atyre me anë të një marrëveshjeje të nënshkruar në Kajro në 1969 lirinë e saj për të ndërmarrë veprime përgjatë kufirit me Libanin. Por kjo marrëveshje e humbi fuqinë e saj në 1975 gjatë luftës civile libaneze, e cila u fillua nga partia e Al-Kataibit (Christian Maronite) dhe aleatët e saj. Qëllimi i tyre ishte që ti jepnin fund prezencës palestineze në vendin e tyre.

Lufta e gjatë kundër kësaj aleance fanatike si dhe betejat kundër aleatëve të saj bënë që Lëvizja Amel të kthehej në armike dhe kampet e palestinezëve të rrethoheshin për më shumë se dy vjet (1985-1987). Kjo situatë, e shoqëruar me problemet e brendshme, kishte bërë që rezistenca përgjatë këtij fronti të paralizohej. Një gjë akoma më e dëmshme se kjo ishte dhe mbyllja e kufijve egjiptianë dhe sirianë për ushtarët komando dhe fedaijinët palestinezët. Në fund të periudhës në fjalë u bë e qartë se ishte e pamundur që të drejtoje operacione komando nga jashtë në drejtim të Palestinës së pushtuar.

Ndërkohë zionistët filluan të përdornin mjete barbare ndaj popullit jordanez dhe libanez, të cilët vazhdonin ti jepnin një mbështetje logjistike komandove apo i strehonin ata. Në këto veprime barbare përfshiheshin vrasjet e pamëshirshme të civilëve të pafajshëm si dhe shkatërrimi i infrastrukturës, ku përfshihej shkatërrimi i fabrikave, urave, stacioneve elektrike dhe të mbjellave.

---

[65] Salah Khalaf, op. cit., fq 96-98.

Në Liban, zionistët i shtuan veprimet e tyre gjatë periudhës 1970- 1972 dhe fushatat e tyre hakmarrëse kundër rajonit të Al-Arkubit, si dhe vranë në vitin 1973 tre krerë të lartë palestinezë. Në mars të vitit 1978 ata arritën të hyjnë në brendësi të territorit jugor libanez dhe themeluan për veten e tyre në bashkëpunim të ngushtë me Sead Hadadin. i cili ishte udhëheqësi i të ashtuquajturës Ushtri e Jugut të Libanit, një zonë sigurie brenda territoreve të Libanit. Zionistët e financuan dhe e trajnuan këtë ushtri e cila më vonë u vu nën urdhërat e tyre.

Në betejën e Al-Shakifit në gusht të vitit 1980 rezistenca palestineze arriti një fitore të bujshme kundër ushtrisë zioniste që po përparonte. Por një valë tjetër e dhunshme dhe e madhe në përmasa arriti që në qershor të vitit 1982 të kalojë në mënyrë të shpejtë kufirin jugor të Libanit derisa arriti në rrethinat e Bejrutit. Megjithatë ajo u detyrua që të ndalonte hapin e saj atje pas një rezistence të fortë nga ana e palestinezëve dhe aleatëve të tyre që zgjati tetëdhjetë ditë. Ndërkohë bota e pafuqishme muslimane arabe dhe komuniteti ndërkombëtar në përgjithësi ishin në pozitat e një spektatori pasiv të këtyre zhvillimeve tragjike.

Zionistët arritën të shtypin logjistikën e rezistencës palestineze dhe me anë të një marrëveshje armëpushimi arritën të dëbonin 6 000 komando palestinezë në kampet e largëta të Jemenit, Tunizisë, Algjerisë dhe Sudanit. Për më tepër ata vendosën një vëzhgim të rreptë mbi çdo formë të rezistencës së jashtme palestineze, por nuk qenë në gjendje që ta bllokojnë atë të gjithën apo të asgjësojnë udhëheqësit e saj.

Si pasojë e zhvillimeve të mësipërme, operacionet e jashtme të komandove patën një ulje të thellë gjatë viteve 1980. Megjithëse edhe gjatë këtyre viteve u organizuan disa operacione dramatike dhe spektakolare, ulja e këtyre veprimeve u ndje shumë. Dy operacione të ideuara nga Lëvizja Fatah ia vlen të theksohen në këtë pikë e ato janë: Operacioni i Savoit në 6 mars të vitit 1975 në Tel Aviv, në të cilin gjetën vdekjen 50 izraelitë dhe 50 të tjerë u plagosën. Po ashtu një operacion tjetër ishte dhe ai i Kemal Uduanit i datës 11 mars 1978, gjatë të cilit u vrane 37 zionistë dhe 82 të tjerë u plagosën.

Ndërkohë Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës ishte aktiv në organizimet e sulmeve ndaj aeroporteve dhe rrëmbimit të avionëve, ku është për tu veçuar sulmi ndaj aeroportit të Al-Ludjës në 30 maj 1972, në të cilin u vranë 31 vetë dhe u plagosën 80 të tjerë. Në 11 prill të viti 1974[66] komanda e përgjithshme e lëvizjes Fronti Popullor për Çlirimin e Palestines organizoi operacionin e Al-Khalisahit si dhe operacionin e nëntorit 1987.

Që nga viti 1982 u pa se nga ana ushtarake kishte një vazhdimësi të rënies së aktiviteteve të O.C.P-së dhe kjo sidomos gjatë periudhës së vështirë të viteve 1983-1987. Ky fakt kishte çuar në një dobësim të konsiderueshëm brenda radhëve të saj, kishte ulur ndikimin e saj në politikat e vendeve arabe dhe u kishte dhënë atyre që mbronin të ashtuquajturin "pragmatizëm" një hov të ri në rrugën drejt një vendosjeje të paqshme, me anë të së cilës organizata në mënyrë graduale u ritërhoq nga motoja e saj e fillimit që kishte të bënte me çlirimin e të gjithë Palestinës nëpërmjet luftës së armatosur.

Në fakt shenja të ketij ndryshimi kishin filluar të paraqiteshin që në fillimet e viteve 1960, kur O.C.P bëri thirrje për një shtet laik dhe demokratik që ti përkiste si izraelitëve ashtu dhe palestinezëve. Ishte e qartë që domethënia e një veprimi të tillë do të thoshte tërheqje e kërkesave që kjo organizatë kishte bërë më parë për rikthimin e të gjithë çifutëve në vendet nga kishin ardhur.

Në vitin 1974 kjo levizje nënshkroi programin me dhjetë pika,. sipas së cilit "lufta politike" ishte një mundësi tjetër për çlirimin e Palestinës dhe pas kësaj bisedimet e vazhdueshme për një zgjidhje "hap pas hapi të çështjes palestineze si dhe themelimin e shtetit palestinez në njërën prej pjesëve të "çliruara" apo "të rimarra nën kontroll" në territorin palestinez.

Në vitin 1982, me miratimin e organizatës, u aprovua projekti i paqes i njohur me emrin projekti Fez-Arab. Sipas këtij projekti sigurohej e drejta e secilit shtet të rajonit që të jetonte në paqe dhe kjo ishte e

[66] Per me shumë rreth ketyre operacioneve, *shih Al-Mawsuah al-Falastiniyyah*, (Enciklopedia Palestineze). Vol.2, fq.313-14, 567; Vol.3, 661-62 dhe Vol.4, fq.42.

barazvlefshme me njohjen e zionistëve dhe tokat palestineze që ata i kishin pushtuar në vitin 1948. Pak pas kësaj O.C.Pra dakord në mënyrë zyrtare që të hynte në negociata për të arritur një marrëveshje politike paqësore.[67]

## Qeveritë e vendeve arabe dhe çështja palestineze

Konsolidimi i identitetit palestinez me anë të njohjes së O.C.P së, si e vetmja përfaqësuese legjitime e popullit palestinez, ishte më të vërtetë një mundësi shumë e mirë për regjimet arabe. Që nga ky mo- ment e më tej ata i mëshuan qëndrimit të tyre se përgjegjësja kryesore për rifitimin e të drejtave palestineze të shtypura ishte O.Ç.P-ja, duke bërë në këtë mënyrë të mundur që ata vetë të ishin të përjashtuar nga përgjegjësia ushtarake dhe detyra e tyre për të luftuar me zionistët. Ata menduan se pas vitit 1973 përgjegjësia e tyre do të kufizohej në mbështetje politike dhe ekonimike për O.C.P-në, ndërkohë që kjo e fundit ka ardhur duke u zbehur që nga vitet 1980 si pasojë e uljes së çmimit të naftës.

Mosmarrëveshjet dhe konfliktet gjatë gjithë kësaj periudhe midis OCP-së dhe regjimeve arabe të Jordanisë, Libanit, Sirisë dhe Egjiptit e gjymtuan dhe më tej organizatën. Në vitin 1983 Jaser Arafati u dëbua nga Siria dhe në të njëjtin vit u bë një përpjekje për ti përzënë përkrahësit e tij nga Libani Jugor dhe sidomos ata që ndodheshin në kampet e Nahr al-Barid dhe al-Badaui.

Nënshkrimi i marrëveshjeve të paqes në kampin David në shtator 1978 nga ana e Enver Al-Sadatit bëri që Egjipti, fuqia më e madhe ndër shtetet arabe, të hynte në konflikt edhe më tepër me O.Ç.P-në. Ndërkohë Iraku ishte shumë i zënë me luftërat e tij me Iranin (1980- 1988) dhe nuk i dha një mbështetje te konsiderueshme qëndresës

[67] Per keto projekte të paqes, shih Munir Al-Hur dhe Tarik al-Musa, *Mashari al- Taswijah lil Kadijah al-Falastinijah 1947-1985*, (Aman, 1986).

palestineze.

Kur filloi kjo fazë, regjimet arabe kishin treguar vendosmëri për të vazhduar luftën. Samiti i Khartumit i liderve arabë, i cili u thirr pas katastrofës së madhe të Nakbahut, dekretoi një vendim të njohur si "Tre Jo-të" që do të thotë: Jo paqe, Jo negociata dhe jo dorëzim në duar të zionistëve." Siria dhe Egjipti u bënë protagonistët e një lufte të përplasjeve me shtetin zionist dhe në 6 tetor 1973 shpërtheu lufta e treté arabo-çifute.

Shtetet arabe kyçe në këtë luftë, Siria dhe Egjipti, në fillim arritën të korrin fitore dhe egjiptianët avancuan drejt pjesës lindore të Kanalit të Suezit drejt shkretëtirës së Sinait, ndërsa ushtria siriane arriti të hyjë deri në Lartësitë Golan. Megjithatë, zionistët, të mbështetur nga forcat ajrore amerikane, rimoren hovin duke thyer mbrojtjen egjiptiane në vendin e quajtur Al-Difriswar, në pjesën lindore të Kanalit të Suezit si dhe shtinë në dorë territoret e Lartësive Golan, që i kishin humbur përkohësisht dhe përveç tyre arritën te pushtojnë edhe 39 fshatra të tjerë sirianë. Me gjithë përmirësimet e pakta që pati ushtria arabe dhe humbjet e mëdha që iu shkaktuan zionistëve, lufta e tetorit i dha fund një miti të krijuar për ushtrinë izraelite si një ushtri e pamposhtur.

Suksesi i paktë që patën ushtritë arabe në luftën e tetorit u paraqit shumë i fryrë nga media arabe si një fitore tepër madhështore dhe liderët egjiptiano-sirianë, veçanërisht Sadati, u portretizuan si heronj kombëtar. Dhe ajo çka ka më shumë rëndësi është se kjo luftë u përdor nga Sadati për të forcuar pretendimin se Egjipti e bëri detyrën e tij ndaj çështjes palestineze dhe kështu që përgatiti një axhendë për paqe. Ai i befasoi popujt arabo-muslimanë me vizitën e tij surprizë në Izrael në nëntor të vitit 1977, si dhe nënshkrimin e mëvonshëm të marrëveshjes së paqes, që u realizua në vitin 1978 në vendin e quajtur Camp David. Kjo marrëveshje i jepte fund përplasjeve të Egjiptit me "Izraelin" dhe në shkëmbim të kësaj ajo rimori kontrollin mbi shkretëtirën e Sinait.

Tërheqja tragjike e Egjiptit, që ishte një nga shtetet partnere me të rëndësishme të shteteve arabe që ishin në konflikt me zionistët, i kishte dhënë fund një shprese për konfrontim të mëvonshëm me ushtrinë zioniste.

Mund të jetë me vend që të kujtohet këtu djegia që zionistët i bënë më 21 gusht 1969 xhamisë Al-Aksa dhe ky veprim çoi në formimin e Organizatës së Konferences Islamike (O.K.I) në shtator të vitit 1969, në të cilën u anëtarësuan të gjitha vendet muslimane. Kjo konferencë organizoi shumë takime dhe nxori rezoluta të shumta në mbështetje të çështjes palestineze dhe luftës politike, financiare dhe ekonomike të palestinezëve.

Por, megjithatë, nuk pati ndonjë rezultat thelbësor nga këto premtime madhështore dhe në fund të premtimeve palestinezët u lanë të vetëm për të mbajtur barrën e rëndë të luftës kundër zionistëve dhe shtetit të tyre. Jo vetëm kaq, por shtete muslimane, si për shembull Turqia, kanë mbajtur marrëdhënie të ngushta me shtetin zionist. Ndërsa disa vende të tjera kanë penguar rezistencën palestineze dhe një pjesë tjetër e vendeve muslimane ishin shumë të zëna me konflikte midis tyre, sidomos Iraku me Iranin në luftën e tyre të viteve 1980-1988 dhe kështu nuk mund ta ndihmonin këtë çështje. Të tjera vende dhanë vetëm premtime dhe shpresa.

Shkurt, mund të themi se ky konflikt u kufizua brenda kufijve kombëtarë palestinezë dhe dimensionet e vendeve arabo-muslimane u zhdukën.

## Nevoja për një lëvizje islame palestineze

Dështimi i ideologjive nacolonaliste, laike dhe radikale për të gjetur një zgjidhje për çështjen palestineze çuan në rizgjimin e ndjenjave islame dhe në shtimin e përkushtimit të palestinezëve për Islamin. Një tregues i këtij rizgjimi është pjesëmarrja e Al-Ikhwan al-Muslimun në atë që njihet si "Kampi i Shaikh". Në bashkëpunim me lëvizjen Fatah në këtë vend u rekrutuan 300 burra gjatë viteve 1968-1970, të cilët u pozicionuan në shtatë kampe komando dhe më vonë morën pjesë në shumë operacione.

Në 1980 organizata islame "Usrat Al-Xihad" që kishte ndërmarrë një sërë operacionesh në territoret e pushtuara të vitit 1948 u shpërbë

dhe gjashtëdhjetë anëtarët e saj u arrestuan.

Më pas, në vitin 1984, pas zbulimit të disa armëve të zjarrit në një dyqan pranë një prej xhamive çoi në arrestimin e Shejh Ahmed Jasinit dhe disa prej shokëve të tij. Akuza për ta ishte organizimi i xhihadit kundër forcave zioniste.

Lëvizja Islamike për Xhihad u formua në vitin 1980 dhe pjesa më e madhe e anëtarëve të saj ishin anëtarë të lëvizjes Al-Ikhwan. Kjo lëvizje organizoi një sërë operacionesh kundër pushtuesve zionistë. Megjithëse aktivizmi ushtarak islamik ishte thuajse modest gjatë kësaj periudhe në krahasim me lëvizjet e organizatave të tjera palestineze, veçanërisht lëvizja Fatah, u bë e mundur përgatitja e terrenit për një rol popullor të islamikëve në territoret e pushtuara, Kuvajt, Jordani, Liban dhe shtete të tjera.

Që nga vitet e fundit të 1970-es ata filluan të viheshin në krye të sindikatave të punëtoreve dhe lëvizjeve studentore në universitetet jordaneze dhe palestineze, siç ishte universiteti Al-Naxhah në Nablus dhe Universiteti Islamnik në Gaza. Po ashtu ata arritën suksese në fushën sociale, arsimore dhe humanitare, duke ndërtuar kështu për veten e tyre një bazë të shëndoshë për zgjerim në të ardhmen.

Shumë shpejt lëvizja islamike, dhe për të qënë më të saktë lëvizja e Ikhuanëve u bë rivali kryesor i lëvizjeve me drejtime laike dhe veçanërisht të lëvizjes Fatah që dominonte O.C.P-ne.[68]

[68] Rreth levizjes islamike, shih Mohsen M. Saleh, *Al-Tarik ila al-Quds*, (Rruga për në Kuds), fq.164-70.

# KAPITULLI V

## ÇËSHTJA PALESTINEZE NË VITET 1987-2000

Palestinezët e vendosur dhe largpamës zhvilluan gjatë kësaj periudhe në territoret e pushtuara luftën e tyre të njohur si "Hedhja e gurëve" *(Intifadatu al-Hixharah)*.

Rezultati i pafat i Traktatit të Oslos së bashku me politikat shtypëse të autoritetit palestinez kundër popullit të tij e dëmtuan rëndë rezistencën. Shkurtimisht zhvillimet më të mëdha gjatë kësaj faze ishin:

- Shpërthimi i Intifadës dhe emergjenca e rrymës militante islame.
- Leshimet katastrofike që iu bënë zionistëve në Traktatin e Paqes së Oslos, i cili u nënshkrua nga O.C.P-ja në vitin 1993.
- Konfliktet midis vendeve arabe që u pasuan me pushtimin e Kuvajtit nga Iraku bashkë me pasojat mjerane që rrodhën më pas si dhe arritja e traktatit të paqes midis Jordanisë dhe shtetit zionist.
- Rënia dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe si pasojë hyrja në masë të gjerë e çifutëve në Palestine. Amerika, fuqia e padiskutueshme mori rolin e drejtuesit të politikave botërore.

### Intifada

Intifada e famshme nisi si një reagim ndaj një aksidenti të planifikuar me makinë që shtypi katër punëtorë palestinezë në 8 dhjetor të vitit 1987. Kjo intifadë që zgjati gjashtë vjet (1987-1993) tronditi themelin e imperialistëve zionistë që ndodheshin në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Lëvizja islame ishte e hapur për tiu bashkangjitur

kësaj revolte që po lindte dhe kjo lëvizje u bë një nga të parat që organizoi demonstratat që shpërthyen pas faljes së namazit të sabahut të datës 9 dhjetor në xhaminë Xhebelia. Në mesin e martirëve të parë që ranë në këto demonstrata ishin Hatim Abu Sis dhe Raid Shahadah. Më vonë, demonstratat u përhapën në të gjithë territorin e Rripit të Gazës dhe Bregut Perëndimor. Kjo kryengritje militante popullore kishte katër tipure kryesore:

1. Ndërsa rezistenca para kësaj ishte e planifikuar dhe e kontrolluar nga "jashtë", kjo intifadě u udhëhoq dhe u zbatua nga vetë populli palestinez "nga brenda" që do të thotë "nga Rripi i Gazës dhe Bregu Perëndimor."
2. Lëvizja Islame kishte një pozitë të shënuar dhe të dobishme në këtë kryengritje dhe si rrjedhim ishte si forca kyçe e luftës palestineze në të gjithë rajonin.
3. Në këtë intifadë u përfshinë gjerësisht të gjithë sektorët e jetës palestineze pa dallim moshe apo orientimi politik.
4. Fëmijët palestinezë, të quajtur "Fëmijët e gurëve" ("Atfal al- Hixharah) dhe gratë ishin pjesëtarë kyçë të intifadës që nxiti në masë bashkëpunimin dhe vlera të tjera si altruizmin dhe zemërgjerësinë. Po ashtu ky bashkëpunim çrrënjosi korrupsionin dhe tradhëtinë.

Katër vitet e para të intifadës u karakterizuan nga pjesëmarrja e gjerë popullore në protesta, sulme, bojkotime të administartës civile zioniste, si dhe pastrimi i shoqërisë nga të gjitha llojet e korrupsionit. Më pas populli pati një rol të rëndësishëm në befasimin që iu bë zionistëve dhe në operacionet ushtarake heroike kundër tyre. Pas Traktatit të Paqes, të nënshkruar në Oslo në vitin 1993, lëvizja Fatah dhe aleatët e saj në O.C.P kishin deklaruar fundin e intifadës. Por organizatat me drejtim islam si Xhihadi dhe Hamasi vazhduan luftën dhe e përshkallëzuan xhihadin. Megjithatë, formimi i mëvonshëm në maj 1994 i Autoritetit Palestinez në territoret e pushtuara e pengoi intifadën nga shkëlqimi që kishte pasur më pare dhe nga natyra masive qe e karakterizonte këtë

lloj proteste. Në atë kohë barra e konfrontimeve ushtarake me zionistët i kishte rënë në masë të gjerë anëtarëve ushtarakë të organizatave islame.

Sipas statistikave të O.C.P-së, gjatë intifadës gjashtëvjeçare janë vrare 1 540 palestineze, ndërsa 130.000 të tjerë janë plagosur dhe 116 000 persona janë arrestuar[69].

Sipas të gjitha standarteve, këto janë sakrifica të shumta që reflektojnë vendosmërinë dhe përkushtimin e masave palestineze për çështjen e tyre të drejtë.

## Hamasi

Hamasi është një lëvizje rezistence islame, e cila është themeluar në 14 dhjetor 1987 dhe ka zhvilluar aktivitetin e saj të të njëjtën kohë me Intifaden. Kjo si fillim ka qenë një degë e "Vellezërve Muslimane" dhe si rrjedhim ideologjia që e udhëhiqte këtë lëvizje ka qenë ideologjia islame, e cila në të njëjtën kohë ishte dhe burimi i vetëm i misionit dhe vizionit të tij. Standarti i lëvizjes Hamas deklaronte një angazhim të plote për një edukim të gjerë islam, çlirimin e të gjithë Palestinës, si dhe themelimin në territorin e saj të një shteti të orientuar tërësisht drejt Islamit.

Hamasi gëzonte një popullaritet të gjerë në mesin e popullit palestinez, sidomos në mesin e studentëve dhe punëtorëve të profesioneve të ndryshme. Deri në ditët e sotme, kandidatët e kësaj lëvizjeje zakonisht arrijnë të fitojnë 30-50 % të votave të përgjithshme popullore në sindikatat e studentëve dhe punëtorëve, ku përmendim universitetet e Naxhahit, Gazës, Khalilit, Birzeitit dhe Kudsit. Në mesin e këtyre përmenden gjithashtu dhe shumë inxhinierë, doktorë, farmakologë, avokatë, mësues, tregtarë etj.

Dr. Hisham Sharabi, një intelektual palestinez me drejtime laike,

---

[69] Gazeta Sawt al-Shab, Jordani, 8 dhjetor 1993.

pranon faktin se Hamasi arriti atë që nuk e arriti dot O.C.P-ja dhe përkrahësit e saj për rreth çerek shekulli. Kjo gjë ishte riorganizimi i masave palestineze në një kornizë atdhetare, të pavarur dhe të përforcuar nga ana ushtarake, gjë kjo që i dha rezistencës një iniciativë të shumëpritur dhe të nevojshme për luftën kundër armikut.[70]

Figura bazë që themeloi Hamasin ka qenë një person me të meta fizike, por me mendje brilante dhe me shumë dhunti të tjera. Ky është Shejh Ahmed Jasini, i cili zëvendësohej në Rripin e Gazës nga Abdul- Aziz Al-Rantisi, Mahmud al-Zahhar dhe Abdul-Fattah Dukhani, ndërsa kryetarët e parë të lëvizjes Hamas për Bregun Perëndimor janë Xhemal Salim[71], Hasan Jusuf dhe Xhemal Al-Natasha.

Ndër liderët e shquar të kësaj lëvizjeje në diasporë janë presidenti i tanishëm dhe i mëparshëm i byrosë politike, përkatësisht Khalid Mishal dhe Musa Abu Marzuki, ndërsa zëdhënës zyrtar është Ibrahim Gushah. Duke iu referuar këtij të fundit. Hamasi ka dhënë 700 dëshmorë

të cilët kanë dhënë jetën për Intifadën që nga momenti kur ajo shpërtheu e më saktësisht që nga viti 1996. Po ashtu numërohen mijëra të plagosur dhe të arrestuar për këtë çështje. Në fakt kjo është një shifër viktimash shumë e madhe, duke marrë parasysh natyrën e ndërlikuar të xhihadit dhe qellimin e tij të kufizuar.

Për shkak të superioritetit që pala zioniste kishte përballë dobësisë politike të palestinezëve, mosmarrëveshjet në botën arabo-muslimane si dhe mbështetjen e vazhdueshme të fuqive të mëdha për shtetin zionist, levizja Hamas arriti në përfundimin se nuk mund të arrihej një çlirimi menjëhershëm i atdheut të tyre. Udhëheqja largpamëse me vizionet e saj realiste arriti në përfundimin se beteja do të vazhdojë dhe do të mbahet në kurriz nga një brez në tjetrin. Por, njëkohësisht, kjo lëvizje po bën më të mirën që ka në dorë që të pëballoje këtë fazë në të cilën ndodhet duke i rikujtuar herë pas here komunitetit botëror se çështja e tyre ekziston dhe duke e mbajtur gjithmonë të ndezur shpirtin e xhihadit nëpërmjet sakrificave te inuxhahidinëve.

[70] Gazeta Al-Hajat, 5 mars 1995.
[71] Ai ka rënë shehid në 30 korrik te vitit 2001.

Ata janë kaq të vendosur dhe të dedikuar ndaj kësaj çështjeje, saqë analistët izraelitë janë shprehur se këta martirë të rinj janë të një kalibri të paparë më parë. Një ekspert tjetër izraelit për më tepër thekson dinamizmin dhe gjallërinë e lëvizjes Hamas, ndërsa gjenerali Uri Sagi, drejtor i Shërbimit Sekret Ushtarak, pranon faktin se në këtë lëvizje ka një organizim të një niveli të lartë, mirëbesim dhe efektshmëri që duket qartë nga operacionet ushtarake që kjo lëvizje organizon.

Dinamizmi i Hamasit vihet re sidomos në aftësitë e kësaj lëvizjeje për të qenë e shpejtë dhe konçize në veprimet që merr përsipër. Po ashtu ajo shquhet për aftësinë që ka në zëvendësimin e udhëheqjes në momente krize si në raste kur figura kryesore të saj burgosen, arrestohen apo vriten. Kështu ndodhi me rastin e arrestimit të Shejh Ahmed Jasinit në vitin 1989 dhe të Abu Marzukut në vitin 1995, po ashtu përmendet dhe rasti vrasjes së Imad Akl në vitin 1993, Jahja Ajashit në 1996 dhe Muhji-Din Al-Sharifit në vitin 1998. Për tu përmendur është dhe rasti i arrestimit të Muhammed al-Daif në maj të vitit 2000, duke vazhduar kështu edhe me momentet kur u vranë dy liderët e mëdhenj të saj Shejh Ahmed Jasini dhe Abdul-Aziz Al-Rantisi.

Megjithëse lufta e xhihadit është bërë pothuajse e pamundur pas marrëveshjes së vitit 1994 midis O.C.P-së dhe zionistëve si dhe pas vetëpërcaktimit të këtyre të fundit si vetëudhëheqës të rajoneve të populluara të Rripit të Gazës dhe Bregut Perëndimor, Lëvizja Hamas arriti të ideojë gjatë periudhës së viteve 1994-1998 disa operacione heroike që i befasuan zionistët, ndër të cilat përmendim pesë operacionet hakmarrëse të masakrës së 1994-ës në xhaminë Al-Aksa si dhe disa operacione që erdhën si kundërpërgjigje për vrasjen e Jahja Ajashit, i cili ka qenë arkitekti i shumë operacioneve gjatë periudhës shkurt-mars 1996, në të cilat janë vrarë 70 zionistë dhe janë plagosur 340 të tjerë.

Izraeli dhe aletatët e tij ishin të shqetësuar nga ky përshkallëzim i veprimeve dhe për këtë organizuan një konferencë ndërkombëtare për të luftuar të ashtuquajturin "terrorizëm". Ky hap u pasua nga një fushatë e dhunshme e drejtuar nga zionistët dhe autoritetet palestineze në bashkëpunim me amerikanët, të cilët u angazhuan që të shkulnin nga rrënjët rrymën islame që ekzistonte në Palestine. Autoriteti palestinez e

kuptoi se projekti i tij për arritjen e paqes, sipas fjalëve të liderit të shquar palestinez Saib Urajkat "sipas drejtimit të erës", çoi në sulme të pakuptimshme dhe të dhunshme kundër lëvizjes Hamas.

Përveç faktit që kjo lëvizje u bë subjekt i presionit dhe agresionit të jashtëm, veprim ky që çoi në arrestimin e Abu Marzukut në Amerikë (Korrik 1995-maj 1997), duke vazhduar me një tentativë vrasjeje për Khalid Mishalin në shtator të vitit 1997 si dhe rasti i mbylljes së zyrave të Hamasit në Jordani në gusht 1999 që u pasua nga një arrestim dhe përjashtim i katër perj ushëheqësve të rëndësishëm nga Katari, veprim ky që ndodhi në nëntor të vitit 1999.

Në të vërtetë Hamasi po kalon një moment të vështirë krize, por. megjithatë, po e merr veten shumë shpejt. Ajo si lëvizje ka popullaritet të jashtëm dhe të brendshëm. Kandidatët e saj zakonisht fitojnë mbi kandidatët e lëvizjes Fatah në zgjedhjet që bëhen nga unionet studentore dhe të punëtorëve[72] ose marrin vota shumë të përafërta me kandidatët e kësaj lëvizjeje.

Megjithatë, ashtu si lëvizja Hamas edhe Xhihadi Islam është një lëvizje që po vuan në kurriz shtypjen dhe agresionin. Kjo lëvizje ka ndërmarrë një numër operacionesh heroike dhe të një cilësie të lartë kundër zionistëve. Ndër këto përmendim operacionet e Netsarimit në nëntor të vitit 1994, opercionet e Bejt Lidit në janar 1995 dhe të Tel- Avivit në mars të vitit 1996. Lideri i kësaj lëvizjeje Fethi Al-Shikaki u vra më 26 tetor 1995 gjatë një opercioni spiun të organizuar nga Shërbimi Sekret Izraelit.

Megjithatë statistikat tregojnë se lëvizja e Xhihadit ka tërhequr vetëm 3-5% të studentëve.

[72] Per me shume informacione neth Hamasit, shih Muhsin M. Saleh, *Al-Tarik ila al- Quds*, (Rruga për në Kuds) fq 183-205 dhe Khalid al-Hroub, *Hamas* (Bejrut. 1997).

## Lëvizja Organizata për Çlirimin e Palestinés

## - Nga lufta deri në Traktatin e Paqes -

Përpjekjet e vazhdueshme dhe agresive për të çrrënjosur këtë lëvizje (O.C.P) nga ana ushtarake çoi në një rënie të rëndësishme politike brendapërbrenda radhëve të saj dhe u kufizua ndjeshëm në samitin arab që u zhvillua në tetor të vitit 1987.

Megjithatë intifada i dha O.C.P-së një ngritje të konsiderueshme, saqë ajo e përdori menjëherë këtë dhe me zgjuarsi arriti të risigurojë lidershipin e saj politik mbi popullin palestinez.

Lëvizja Fatah dhe grupet e tjera morën pjesë aktive dhe të dobishme në luftë dhe O.C.P-ja arriti të krijojë udhëheqjen e bashkuar kombëtare për intifaden.

Zionistët iu kundërpërgjigjën këtyre lëvizjeve me fushata të përgjakshme dhe djallëzore, gjatë të cilave mbeti i vrarë numri dy i O.C.P-së Ebu Xhihadi dhe kjo ndodhi më 16 prill 1988. Megjithatë, O.C.P-ja menjëherë shfrytëzoi vendimin e qeverisë jordaneze të datës 31 korrik 1988, sipas të cilit kjo qeveri çangazhohej nga përgjegjësia ligjore dhe administrative e Bregut Perëndimor për tu paraqitur ajo vetë (O.C.P-ja) si përfaqësuese e vetme e popullit palestinez. Gjithashtu O.C.P-ja paraqiti dhe të ashtuquajturën "Fushata palestineze për paqe".

Gjatë periudhës 12-15 nëntor 1988 dhe nëpërmjet Këshillit të 19- të Kombëtar Palestinez, O.CP-ja adoptoi një program politik të bazuar mbi njohjen e rezolutës 181 të Kombeve të Bashkuara të vitit 1947, që e ndante Palestinen në dy shtete rhidis arabëve dhe izraelitëve dhe për herë të parë në 21 vjet kjo lëvizje pranoi publikisht se e njihte rezolutën 242 të vitit 1967, që e trajtonte problemin e palestinezëve si një çështje refugjatësh.

Për ta zbutur këtë shije të keqe që la kjo te masa e gjerë e popullit, Këshilli Palestinez deklaroi "pavarësinë e Palestinës", i cili ishte një veprim i mirëpritur nga komuniteti ndërkombëtar. Brenda pak muajsh. 120 shtete e njohën këtë shtet të ri, ndërsa jo i habitshëm ishte fakti se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Europa nuk pranuan ta njihnin

atë. Megjithëse në një formë "teorike" dhe "formale" ky shtet arriti të rikthente në qendër të vëmendjes çështjen palestineze dhe të risiguronte ndikimin politik të O.C.P-së, pavarësisht nga zmbrapsja vulgare dhe pranimi i këtij pozicioni të pamendueshëm.

Ndërkohë, ndodhën zhvillime dramatike dhe armiqësore gjatë viteve të fundit të 1980-es dhe viteve të para të 1990-es, si nga niveli arab ashtu dhe ai kombëtar. Pushtimi i Kuvajtit nga Iraku në 2 gusht 1990, si dhe lufta e Gjirit që erdhi më pas patën dhe ende vazhdojnë të kenë një ndikim katastrofik ne këtë rajon edhe për çështjen palestineze. Ky konflikt çoi në armiqësi të hidhur midis vendeve arabe dhe bëri që të thithen burimet e pasurisë së tyre. Po ashtu kjo çoi dhe në asgjësimin e kapaciteteve të forta logjistike të ushtrisë irakiene, dëbimin e qindra mijërave palestinezëve jashtë Kuvajtit si dhe pezullimin e mbështetjes ushtarake dhe financiare të O.C.P-së.

Në arenën ndërkombëtare kjo periudhë u bë dëshmitare e rrëzimit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik si dhe bllokut socialist në përgjithësi. Këta kunkurues dhe kundërsharë të mëparshëm të Perëndimit shumë shpejt u frenuan nga Amerika dhe aleatët e saj e më pas kërkuan mbështetje financiare. Po ashtu ata i imituan demokracitë kapitaliste të tyre dhe i morën si model për ti zbatuar në vendet e tyre.

Kjo gjë i dha një emër serioz balancës politike ndërkomëtare, qe si arabët ashtu dhe palestinezët kishin arritur ta përdornin në avantazhin e tyre.

Ne fillimet e viteve 1990 Amerika doli si një superfuqi botërore. Akoma më e keqe ishte influenca në rritje e çifutëve në administratën pro-zioniste të presidentit amerikan Klinton. Ky i fundit u dha çifutëve katër poste shumë të rëndësishme ministrore, siç ishin Ministria e Punëve të Jashtme e kryesuar nga Medlin Ollbrait (Madeline Albright), Ministrinë e Financave të kryesuar nga Robert Robini, Ministrinë e Mbrojtjes, në krye të së cilës ishte William Kohen dhe në krye të Ministrisë së Bujqësisë u vu Gilkmeni (Gilkman). Përveç kësaj, shtatë nga njëmbëdhjetë anëtarët e Këshillit Kombëtar të Sigurimit ishin hebrenj, po ashtu edhe presidenti Bankës Qendrore, Grinspeni (Greenspan), si dhe drejtori i Shërbimit Sekret Amerikan (C.I.A) Xhorxh Tenet (George Tenet).

Amerika e fuqishme ka qenë shumë aktive për të arritur ti imponojë botës konceptet e saj për një rend të ri botëror, që e mbyll njëherë e përgjithmonë "dosjen palestineze" në favor të aleatit të saj strategjik, Izraelit.

Pas rrëzimit të bllokut socialist, Rusia dhe vendet e Europës Lindore dolen vullnetare për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me Izraelin si dhe lejuan emigrimin masiv të çifutëve për në Palestinë. Në 7 maj 2000 zionistët festuan mbërritjen e emigrantit rus që shënonte plotësimin e numrit të 1.000.000-të që nga fillimi i shtatorit 1989. Ky emigrant u prit nga vetë kryeministri zionist[73].

Kjo valë emigrantësh përfshin dhe 92 000 punëtorë të profesioneve të ndryshme, ndër të cilët disa mijëra janë ekspertë bërthamore[74] dhe shumë të tjerë janë oficerë të lartë të ushtrisë, një fakt ky që rrit rrezikun e Izraelit dhe projektit të tij zionisto-imperialist në rajon.

Në këto kushte shumë të favorshme për zionistët, Amerika i mblodhi shtetet arabe në Konferencën Arabo-Izraelite të Paqes që u zhvillua në Madrid, në tetor 1991, dhe që u zëvendësua nga negociata të drejtpërdrejta zyrtare midis dy kundërshtarëve që u zvarritën për dy vjet me radhë pa asnjë ndryshim thelbësor në qëndrimin e papajtueshëm zionist.

Megjithatë, pas delegacionit zyrtar palestinez të kryesuar nga Hajdar Abdul Shafi dhe shumë udhëheqës të O.C.P-së u zhvillua një raund tjetër takimesh konfidenciale midis dy palëve që nga 20 janari 1993 në Oslo të Norvegjisë.

Një fakt befasues ishte formulimi në 19 gusht 1993 i Traktatit të Paqes së Oslos, që zyrtarisht u nënshkrua më 13 shtator nën kujdesin e Bill Klintonit dhe në prezencë të Jaser Arafatit dhe kryeministrit izraelit Rabin (Yitzhaq Rabin). Personi që firmosi nga pala palestineze ishte Mahmud Abas, ndërsa nga pala tjetër ishte ministri i jashtëm Shimon Peres, ndërsa ministrat e jshtëm të Rusisë dhe Amerikës firmosën si

[73] Gazeta *Al-Khaleej* (Emiratet e Bashkuara Arabe), 8 Maj 2000.

[74] Sipas llogaritjeve të gazetës Al-Khaleej, ku 10000 shkencetare atomike në bashkësinë çifute. Ibid, 25 Janar 2000.

dëshmitarë.

Marrëveshja e Oslos ishte teorikisht një marrëveshje e përkohshme, që u siguroi palestinezëve vetëqeverisjen në Rripin e Gazes dhe Xheriko (Jericho), që në të ardhmen do të shtrihej dhe në zona të tjera palestineze, sidomos në ato të populluara.

Autoritetit palestinez iu dha përgjegjësia për fushën e arsimit, shëndetit, çështjeve sociale, taksat e drejpërdrejta dhe turizmit. Negociatat u programuan që pas dy vjetësh të fillonin për trajtimin e "çështjeve delikate" si dhe për "statusin final". Por zionistët vepruan në mënyrë të tillë që dorëzimi i këtyre përgjegjësive në dorë të palestinezëve të vonohej sa më shumë, duke lënë pezull të tjera lëshime, në mënyrë që të vinin në provë ndërkohë sigurinë e autoriteteve për të zbatuar kushtin e vënë nga zionistët për një shtypje të përgjithshme të Hamasit dhe lëvizjeve të tjera të rezistencës. Për më tepër, në mes dy palëve u nënshkruan traktate që në thelb ishin prozioniste, siç ishin marrëveshjet e Kajros dhe ajo e Tebës, përkatësisht në 4 maj 1994 dhe 28 shtator 1995. Po ashtu përmendim marrëveshjen e Lumit Wye në 23 tetor 1998 dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të Sharm Al-Sheikut më 4 shtator 1999. Zonat që vetëqeveriseshin ishin ndarë në dy kategori të emëruara kategoria A dhe B. Autoriteti palestinez kishte të drejtën administrative dhe kontrollonte sigurinë në 17% të territoreve të kategorisë A dhe 25 % të tokave në kategorinë B.

Në këto të fundit siguria ruhet në bashkëpunim me zionistët. Autoriteti palestinez deri më sot ka dështuar në arritjen e marrjes së vendimeve përfundimtare rreth të ashtuquajturave çështje të ndjeshme dhe thelbësore.

Kritikat më të rëndësishme rreth Traktatit të Oslos mund të përmblidhen në pikat e mëposhtme.

1. Çështja e drejtë palestineze është një shqetësimi të gjithë umetit musliman dhe ky shqetësim nuk është i një pjese të caktuar apo një brezi të caktuar dhe as palestinezët apo dikush tjetër nuk ka të drejtë të heqë dorë nga ajo. Të gjithë ulemate (dijetarët) e njohur kanë deklaruar se një marrëveshje e tillë është e paligjshme dhe

kanë kërkuar vazhdimin e xhihadit deri në çlirimin e plotë të këtij vendi.

2. Udhëheqja e O.C.P-së e ka nënshkruar një dokument të tillë (Traktatin e Oslos) pa u këshilluar më parë me popullin palestinez, në mesin e të cilëve janë një sërë grupesh si ato islamike, të majtë e nacionalistë. Madje ata nuk janë këshilluar as me anëtarët e tjerë brenda radhëve të lëvizjes Fatah, që i kundërshtuan fuqishëm këto marrëveshje të turpshme me zionistët.

3. Me anë të njohjes së "të drejtës për ekzistence" për Izarelin, udhëheqja e O.C.P-së në fakt ka hequr dorë përgjithmonë nga 77 % e tokave palestineze të cilat u pushtuan më 1948.

4. Marrëveshja e nënshkruar nuk ka vendime për çështjet më delikate dhe më të rëndësishme që u lanë pezull nën "bujarinë" e madhe të shtetit manipulues dhe të fuqishëm zionist. Këto çështje më saktësisht janë:

   I. E ardhmja e qytetit të shenjtë të Jeruzalemit që zionistët e kanë deklaruar njëzëri si kryeqytetin e përhershëm të shtetit të tyre, pasi konfiskuan 86 % të tokave të tij dhe vendosën në të më shumë se 200 mijë çifutë të organizuar në koloni, të cilët u vendosën në veçanti në pjesën lindore të qytetit të shenjtë, pikërisht për këtë arsye.

   II. Një çështje tjetër e lënë në hije është e ardhmja e 5 milionë refugjatëve palestinezë të lënë pa asnjë lloj zgjidhjeje në mes të katër rrugëve.

   III. Po ashtu, është lënë pa asnjë zgjidhje dhe e adhmja e 160 kolonive çifute që ndodhen në Bregun Perëndimor dhe 16 koloni të tjera që ndodhen në Rripin e Gazës, të cilët janë vendosur në 62 % të tokave që u janë konfiskuar palestinezëve dhe në to janë strehuar 200 mijë çifutë. Duket qartë se lenia pa u diskutuar e një çështjeje të tillë është një spekullim dhe një veprimi qëllimshëm.

5. Siguria e jashtme dhe ruajtja e kufijve nuk është një e drejtë e autoritetit palestinez, ndërsa hyrja e personelit dhe e armatimit në territoret që vetqeverisen është rreptësisht e ndaluar pa pasur më parë një leje "izraelite". Po ashtu autoritetitit palestinez nuk i lejohet që të rekrutojë ushtrinë e tij.

6 . Gjatë periudhës së tranzicionit, shteti zionist ka të drejtën e vetos për të gjitha ligjet dhe legjislacionet që diskutohen nga palestinezët. 7. Këto traktate nuk qartësojnë të drejtat e palestinezëve për vetvendosje dhe të drejtën për të themeluar një shtet të pavarur. Për më tepër ata nuk i referohen Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës si territore të pushtuara, gjë që bën të kuptohet se ato janë "toka në diskutim".

8. Duke qenë përpara faktit se kishte nënshkruar traktatin që nuk i jepte të drejtën e formimit të një ushtrie për të bërë rezistencë kundër shtetit zionist, O.C.P-ja u gjend e detyruar të luftonte dhe kundër popullit të saj, në raste kur grupe të caktuara ndërmerrnin nisma te rezistencës. Në fakt ajo u bë mbrojtësja e sigurisë izraelite në territoret që ishin nën administrimin e saj. Në ankth për të ruajtur paqen e brishtë me Izraelin, si dhe për të treguar haptazi "qëllimet e mira" që ajo kishte ndaj zionistëve. autoriteti palestinez ndërmori fushata të egra kundër kundërshatëve të tij.

Dilema që e përshkonte O.C.P-në përshkruhet më saktësisht nga shkrimtari i shquar palestinez Edward Said, i cili shprehet: "Arafati e ka futur popullin e tij në një grackë nga e cila nuk mund të dilet.[75] Në një thënie të ngjashme dijetari palestinez Hisham Sharabi në mënyrë sarkastike u shpreh se "udhëheqja palestineze është e paaftë për të marrë apo zbatuar vendime me vendosmëri"[76]

[75] Gazeta *Al-Hayat*, 12 gusht 1995.

[76] Ibid, 5 mars 1995.

## Autoriteti palestinez dhe situate aktuale

Policia palestineze hyri në Gaza më 18 maj 1994 dhe anëtarët e administratës së re u betuan nga ana kushtetuese përpara Arafatit në Ariha në datën 5 korrik. Megjithatë shumë shpejt u pa se kundërshtimet ndaj marrëveshjes së paqes ishin me vend. Natyra tranzitore e rendit të vetëvendosjes çuan në mënyrë të pashmangshme në një copëtim të ngadaltë të tokave të lëna nën autoritetin palestinez, i cili në fakt u kthye gati në një të burgosur të shtetit zionist dhe varej plotësisht nga dëshira e tij për të arritur çfarëdolloj suksesi, sado i parëndësishëm që mund të ishte.

Nga ana e tyre zionistët e egër, luajtën një lojë të ftohtë, vazhduan të kërkonin më shumë kritere dhe kushtëzuan çdo përparim nën shtypjen e rezistencës ushtarake. Shteti zionist, në mënyrë ironike, e paraqiti Hamasin dhe Xhihadin Islamik si pengesa të pakapërcyeshme, duke i mëshuar faktit se autoriteti palestinez duhet ti shtypë ata me forcë për të realizuar qëllimet kombëtare të popullit.

Deri në ditët e sotme, zionistët po luajnë lojën e tyre të preferuar, e cila është "prit dhe shiko" dhe, ndërkohë, asnjë nga çështjet e rëndësishme të renditura nga vetë marrëveshja e Oslos për tu zgjidhur ne 1998 nuk është përcaktuar.

Pushteti i autoritetit palestinez ishte i kufizuar qëllimisht në zonat e populluara dhe kjo pasi zionistët dëshironin që ky autoritet të zbatonte nën përgjegjësinë e tyre "misionin e fëlliqur" të masave të forta për islamiket si dhe mbledhjen e taksave së bashku me disa veprime të tjera. Shkurtimisht ata kishin llogaritur të kishin si të thuash një "imperializëm të pastër" në ato territore.

Ndërkohë kostoja e burokracisë dhe sigurisë kishin arritur pikat më të larta. Policia e shtetit numëronte në radhët e saj 40 000 vetë (përqindja më e lartë në botë krahasuar me popullsinë). Po ashtu buxheti i përcaktuar nga zyra e Arafatit për sigurinë përbënte rreth 70% të buxhetit total për vitin 2000, ndërsa pjesa e pakët që kishte mbetur iu shpërnda ministrive të tjera, institucioneve dhe shërbimeve të tjera si

shëndetësisë, edukimit, shërbimeve sociale, energjitikës etj.[77]

Përhapja e madhe që mori "policia e shtetit" ishte në kurriz të mirëqenies dhe lirisë politike të popullit. Sipas një raporti të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, i cili u publikua në maj të vitit 1995, thuhej se të ardhurat për frymë në Rripin e Gazës ranë në 500 dollarë, gjë që ishte 38 % më pak se në vitin 1993.[78]

Në prill të vitit 2000 një grup me personalitete të spikatura palestineze dhe aktivistësh të të drejtave të njeriut publikuan në Uashington një dokument që e cilësonte Traktatin si një "katastrofe politike dhe ekonomike", si dhe i kërkonte me ngulm Arafatit që të jepte dorëheqjen. Ajo paraqiste uljen prej rreth 30 % të të ardhurave për frymë dhe një rritje të trefishtë të nivelit të papunësisë në krahasim me vitin 1993.[79]

Burime të besueshme dëshmojnë për paefektshmërinë. korrupsionin dhe neopotizmin që ekzistonte brenda institucioneve dhe organizatave të autoritetit palestinez. Duke iu referuar Muhamed Xhihadit, një lider kryesor i lëvizjes Fatah, thuhet se "Arafati mblodhi rreth vetes n j hat e grup hajdutësh dhe oportunistësh,[80] ndërsa të tjerë ankoheshin për pamaturi, rryshfetet dhe egoizmin e shoqëruar me paturpësi.

Korrupsioni financiar, i cili ishte shumë i përhapur, u pranua po ashtu në një raport të paraqitur në maj të vitit 1997 nga Komiteti Mbikqyrës i Këshillit Legjislativ të autoritetit palestinez, ku tregohej përvetësimi i 326 milionë dollarëve amerikanë nga një buxhet 1500 milion dollarësh. Këshilli u indinjua aq shumë nga kjo shifër e lartë, saqë votoi gati unanimisht kundër qeverisë së Arafatit, 56 vota pro dhe vetëm 1 kundër. Një grup prej njëzet intelektualëve palestinezë që jetonte në të ashtuquajturat zona të vetëqeverisura nënshkruan një peticion të njohur si "peticioni i të njëzetëve", në të cilin dënohej korrupsioni, neopotizmi



[77]www.palestine-info.org./news, 2 mars 2000
[78] Gazeta *Al-Rai* (Jordani), 2 maj 1995.
[79] Gazeta *Al-Khaleej*, 16 prill 2000.
[80] Gazeta *Al-Siyasah* (Kuvajt), 27 prill 1995.

dhe politikat shtypëse të autoritetit palestinez. Për këtë Hisham Sharabi shprehet: "Autoriteti i sotëm palestinez nuk përfaqëson popullin e Palestines... Ai nuk është në gjendje të ndryshojë kushtet mjerane në të cilat populli po jeton dhe në fakt ky autoritet është vetë një nga burimet e kësaj katastrofe."[81]

Një nga "arritjet më të rëndësishme të autoritetit në fjalë ishte fushata shtypëse dhe e pamëshirshme për të çrrënjosur opozitën. Në vitin e saj të parë të udhëheqjes, ajo ndërmori më shumë se dymbëdhjetë fushata arrestimesh, ndërkohë që ngriti në rajonin e vogël të Rripit të Gazës (që ka një sipërfaqe vetëm 363 km2) njëzet e katër rajone policie dhe njëzet e tre postblloqe ushtarake. Duke vazhduar fushatën e saj të terrorit kundër lëvizjes islame, ky autoritet sulmoi në më pak se një muaj (nga 19 prilli deri më 9 maj të 1995) 57 xhami 138 herë.[82]. Po ashtu ata u hakmorrën pas çdo operacioni të xhihadit kundër zionistëve. Por në veçanti ky autoritet ishte i pamëshirshëm me operacionet e ndërmarra nga Hamasi si shenjë hakmarrjeje për vrajsjen e Jahja Ajashit nga ana e zionistëve. Madje autoriteti palestinez arriti deri aty sa te arrestojë dhe të dënoje disa nga liderët e Hamasit, të cilët ishin planifikuar që të hynin në bisedime me autoritetin. Ndër ta përmendim Hasan Jusufin dhe Xhemal Salimin.

Koordinimi i vazhdueshëm ndërmjet sigurimit zionist, palestinez dhe amerikan beri që shumë operacione të Xhihadit të dështonin si dhe çuan në arrestimin e një sërë luftëtarësh. Në janar të vitit 1997, organizatat e të drejtave të njeriut raportuan për 1600 të burgosur në burgjet palestineze. 700 nga të cilët nuk ishin as të dënuar dhe as të gjykuar.[83]

Për më tepër, më shumë se njëzet persona deri në atë kohë ishin torturuar deri në vdekje në këto burgje.

Ndërkohë që zionistët ndërmerrnin veprime shumë të padrejta si

[81] Gazeta *Al-Hayat*, 5 mars 1995

[82] Daud Sulejman, *Al-Sultah al-wataniyyah al-Falastiniyyah fi Am 1994-1995*" (Autoriteti Kombëtar Palestinez ne vitet 1994-1995), (Aman, 1995), fq. 135.

[83] Passia.org/palestine-facts/chronology/1997.

konfiskimin e tokës, ngritjen e kolonive në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës, shpejtonin eksodin e çifutëve për në Palestinë dhe zhduknin identitetin islam të Jeruzalemit, autoriteti palestinez në mënyrë të turpshme pengonte xhihadin dhe torturonte luftëtarët muxhahidinë që luftonin për çlirimin e vendit të tyre.

Vlen të përmendim se qëndrimi i autoritetit palestinez përkundrejt opozitës ka ndryshuar që nga kryengritja që shpërtheu në xhaminë Aksa në 28 shtator 2000. Autoriteti në fjalë e kuptoi se ishte e pamundur të vazhdonte të përdorte të njëjtat masa shtypëse, në një kohë kur vetë zionistët po i braktisnin traktatet e tyre dhe po shtonin arrogancën dhe shtypjen ndaj popullit palestinez, i cili, nga ana e tij, i bëri rezistencë të guximshme dhe fisnike pushtuesit në mbrojtje të dinjitetit dhe vendeve të shenjta të tij.

Në këtë mënyrë autoriteti bëri lëshime në kufizimet që kishte vënë për aktivitetet e opozitës, liroi nga burgu një numër të konsiderueshëm personash si dhe u la rrugë të lirë demonstratave dhe protestave kundër zionistëve. Megjithëse publikisht ata e dënonin vrasjen e civilëve izraelitë, autoriteti nga ana tjetër i ka justifikuar këto veprime si një reagim të natyrshëm ndaj barbarizmit zionist që vret palestinezë të pafajshëm, konfiskon pronat dhe sulmon vendet e tyre të shenjta.

## Shteti zionist dhe situata aktuale

Në agimin e shekullit të XXI shteti zionist ka të gjitha arsyet për tu mburrur dhe për të qenë i vetëkënaqur për forcimin nëpërmjet mbështetjes aktive që i kanë dhënë superfuqitë - e pushtimit dhe sundimit të tij mbi Palestinën.

Brenda pesëdhjetë e dy vjetëve që nga krijimi i tij (1948-2000). Izraeli ka arritur të përfitojë nga dobësitë dhe ndarja e botës arabo- muslimane për të sjellë 2 milionë e 900 mijë emigrantë, të cilët e rritën në mënyrë të menjehershme numrin e çifutëve në Palestinën e pushtuar. Numri i tyre në vitin 1948 ishte 650 mijë, ndërsa në fund të vitit 2000

arriti në rreth 4 milionë e 947 mijë, që përbëjnë rreth 38% të bashkësisë botërore çifute.[84]

Shpërbërja e Bashkimit Sovietik dhe bllokut komunist shënoi fundin e izolimit më të gjatë të çifutëve. Rusia dhe vendet e Europës Lindore nxituan që të vendosnin dhe të përforconin lidhjet diplomatike, politike dhe ekonomike me shtetin zionist. Lufta shkatërrimtare e Gjirit (1990-1991) si dhe traktati i padrejtë i Oslos e shtynë Jordaninë të nënshkruajë një marrëveshje paqeje me zionistët. Po ashtu disa vende të tjera arabe si Katari, Omani dhe Tunizia shkëmbyen dhoma tregtie me shtetin zionist. Rreth pesëdhjetë vende për më tepër vendosën marrëdhënie diplomatike dhe ekonomike me këtë shtet zionist.

Pezullimi i "projektit të çlirimit" dhe shtypja e rezistencës ushtarake i dha shtetit zionist një stabilitet relativ që i mundësoi të dyfishonte rritjen ekonomike. Shuma e të ardhurave te tij lokale kapi shifrën e 15.3 miliardë dollarë amerikanë në 1983 dhe arriti në 105.4 miliardë në vitin 2000. Kjo do të thotë që pati një rritje të shtatëfishuar dhe për të qenë më të saktë një rritje prej 689 %.

Kjo rritje ekonomike e uli ndjeshëm varësinë e këtij shteti nga Amerika dhe ndihmat e tjera të jashtme, të cilat patën një rënie të thellë nga 25% të të ardhurave kombëtare që përbënin në vitin 1983, në 4% të të ardhurave kombëtare në vitin 2000, megjithëse sasia vjetore vazhdoi të mbetet e njëjtë, rreth 4 miliardë dollarë.

Të ardhurat për frymë në shtetin zionist kapën majat në vitin 2000, kur arritën ne 18 300 dollarë. Kjo shifër është një nga më të lartat në të gjithë botën. Vlera e eksporteve të Izraelit u dyfishua nga 11.6 miliardë dollarë në 1990 në 23.6 miliardë dollarë në vitin 2000.

Te ardhurat vjetore në vitin 2000 ishin rreth 40 miliardë dollar krahasuar kjo me një harxhim të 42.4 miliardë dollarëve. Kjo shifër e të ardhurave vjetore është 8 miliardë më e lartë se të ardhurat vjetore të

---

[84] Per informacione dhe statistika rreth emigrimit çifut, shih Zyren Qendrore te Statistikave të qeverisë së Izraelit në: http://www.cbs.gov.il/yahran/bl/e.htm dhe Umran Abu Sabih, *Al-Hijrah al-Yaheliyyah. Haqaiq wa Arqam*, (Emigrimi çifut: fakte dhe te dhena). (Aman, 1991).

Egjiptit, Sirisë dhe Libanit të marra së bashku.[85]

Ushtria e Izraelit është ushtria më e fortë në të gjithë Lindjen e Mesme në lidhje me personelin dhe armatimin. Numri i ushtarëve të rregullt të kësaj ushtrie shkon në 178 000 dhe mund të rritet brenda shtatëdhjetë e dy orëve në 700 000, madje sipas disa pretendimeve të tjera ky numër mund të shkojë dhe në 1 milion së bashku me forcat rezervë. Kjo ushtri është superiore nga ana e armatimeve tradicionale dhe bërthamore. Ajo furnizohet brenda një kohe të shkurtër me armët dhe pajisjet më të përparuara amerikane.

Në industrinë e luftës janë angazhuar dyqind kompani çifute dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës sigurojnë sipas një traktati zyrtar në shtetin zionist-superioritetin e ushtrisë së Izraelit ndaj forcave të bashkuara arabe. Shteti zionist posedon më shumë se dyqind bomba bërthamore dhe është eksportuesi i pestë i armëve në botë. Vetëm në vitin 1999 ai ka lidhur kontratë për të shitur armë, vlera totale e të cilave shkonte në më shumë se 2 miliardë dollarë amerikanë.[86]

Megjithatë, shteti zionist ka problemet e tij politike, ushtarake dhe shoqërore. Pikësëpari renditet paqëndrueshmëria politike që vjen si pasojë e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve që ekzistojnë midis partive me të mëdha politike. Ndërsa ushtria e Izraelit është e mbimbushur, është e demoralizuar ashtu siç tregohet nga disa raste dezertimi apo vetvrasjeje. Infrastruktura sociale e kësaj shoqërie është në rrënim gradual për shkak të mosmarrëveshjeve raciale dhe fetare që ka në mes bashkësive të ndryshme çifute; Ashkenazi, Sefardimi si dhe rritja e rasteve të divorceve.

Përveç problemeve të sipërpërmendura ekziston dhe problemi i

---

[85] Per me shume informacione mbi ekonomune e bashkësisë zioniste, shih http://www.cbs.gov.il/yahran/bile.htm, http://www.cia.gov/cia/publications/factbook/geos/is.html dhe Fadl al-Naqib, "Al-Iqtisad", ne *Dalil Israel al-Am* (Bejrut, 1996), fq. 183-212.

[86] Për më shumë njohuri rreth fuqise ushtarake të Izraelit, shih Muhammed Zuhair Diab, "Al-Muasasah al-Askarijah", ne Datil *Israel al-Am, op. cit.* fq.285-313 dhe Abdul-Wahhab al-Masin, "Sina at al-Silah al-Tajamu a al-Istitani al-Sahyuni" gazeta *Al-Khaleej*, 11 qershor 2000 dhe "The Military Balance" 1998/99. Instituti Nderkombetar për Studime Strategjike, Londer.

nivelit të ulët të lindjeve, burimet e pakta për të siguruar emigrimin e çifutëve nga Rusia dhe vendet e Europës Lindore, ngurrimi i çifutëve që jetojnë në Amerikë dhe Europë për të emigruar drejt një shteti problematik çifut. Të gjitha këto vënë në rrezik zbatimin e projektit ekspansionist zionist, si dhe rrezikojnë shtetin e tyre.

Por këto probleme ende nuk janë aq serioze sa për të minuar dhe zhdukur tërësisht shtetin zionist. Ai është akoma superior nga ana ushtarake dhe më i fuqishëm se më parë po ta krahasojmë me botën arabo-muslimane që është e dobët si nga ana politike ashtu dhe nga ajo social-ekonomike. Në të vërtetë sfida që kemi përpara është e vështirë dhe mund të përballohet vetëm më një projekt rilindjeje e rizgjimi të botës arabo-muslimane.

# KAPITULLI VI

# ÇËSHTJA PALESTINEZE NË VITET 2000-2005

## Kryengritja e Al-Aksasë (Intifada)

Ndërkohë që ky studim i shkurter po arrinte në fund ndodhi një ngjarje shumë e rëndësishme e cila kërkon një vëmendje të menjëhershme. Kjo është intifada e xhamisë Al-Aksa, që i dha një dimesion të ri luftës palestinezo-arabo-islame kundër pushtimit zionist. Më poshtë do të paraqesim një përmbledhje të shkurtër të karakteristikave të saj më të rëndësishme.

Shumë faktorë që kanë çuar në krijimin e një situate shpërthyese në territoret e pushtuara kanë funksionuar edhe kohë më parë. Refuzimi i fortë i Izraelit për ti venë veshin zërit të arsyes të bashkësisë botërore si dhe mospajtimi i çifutëve me vendimet rreth çështjeve më të rëndësishme, siç është çështja e refugjatëve dhe kolonive hebreje. konfirmon ambicien e tyre të mëtejshme për Jeruzalemin, xhaminë Al- Aksa dhe tokat e tjera palestineze. Rrjedhimisht çifutët arritën të vënë ë rrezik të gjithë procesin e paqes.

Kryeministri i dëshpëruar i Izraelit në një takim sekret më datë 25 tetor 2000 u shpreh se zgjidhja më e mirë në këto rrethana kritike do te ishte qe "çeshtjet te shtyheshin drejt nje pike acarimi.[87]

Me fjalë të tjera ai e ndjente se sa më shumë kokëfortë që të ishin, aq më shumë do të rritej fama e tyre dhe do të pezullohej procesi paqes. duke e lënë pezull çështjen e dorëzimit dhe kufizimeve të mëtejshme që priteshin nga autoriteti palestinez, i cili nuk ishte në pozita të qëndrueshme.

[87] Gazeta *Al-Khaleej*, 10 nëntor 2000

Por veprimi që indinjoi së tepërmi intifadën ishte vizita provokuese e terrorristit Ariel Sharon, liderit të partisë Likud, në oborrin e xhamisë Al-Aksa më 28 shtator 2000. Ai ishte i shoqëruar nga 600 ushtarë të armatosur dhe 3000 të tjerë i kishte urdhëruar të merrnin nën kontroll Jeruzalemin dhe rrethinat e tij. Eshtë e qartë se ky shou zyrtar i forcës shpreh miratimin e heshtur dhe njëkohësisht mbështetjen dhe nxitjen e kryeministrit zionist për aktin provokues dhe fyes i cili është një veprim arroganti pashembullt.

Por muslimanët e shprehën në mënyrë madhështore qëndresën e tyre ndaj ketij provokimi. Kjo gjë çoi në vrasjen e pesë personave dhe në plagosjen e më shumë se njëqind të tjerëve. Gjithashtu kjo u pasua nga një valë urrejteje dhe zemërimi në të gjithë botën muslimane, gjë e cila ishte një tregues i vendosmërisë së popujve muslimanë për të mbrojtur me shpirtin dhe gjakun e tyre këtë tokë të shenjtë.

Intifada e ndërmarrë në xhaminë Al-Aksa nxori në pah faktet e mëposhtme:

Së pari: Intifada vërtetoi se shpirti i xhihadit dhe vullnetit për tu sakrifikuar ende vazhdon te gjendet në mesin e popullit musliman, pavarësisht nga vështirësitë dhe katastrofat që kanë kaluar. Demonstratat popullore që shpërthyen në të gjithë vendet muslimane, duke filluar që nga Rabati që ndodhet në skajin perëndimor e deri në Xhakarta që ndodhet në skajin lindor, të gjithë bënin thirrje për xhihad ne Jeruzalem dhe Palestine në mbrojtje te xhamisë Ai Aksa. Nga shumë drejtime filluan të buronin donacione të shumta për çështjen palestineze që ishte një tregues i fortë i potencialeve të këtij umeti dhe aftësive të tij për të arritur fitore.

**Së dyti**: Çështja palestineze dhe toka e shenjtë, Jeruzalemi dhe xhamia Al-Aksa, treguan se janë një pikë që i bashkon muslimanët në të gjithë botën dhe i bën që ti kapërcejnë mosmarrëveshjet dhe dallimet që i ndajnë për tu bashkuar në një betejë të bashkuar kundër armikut të përbashkët zionist. Shkurtimisht, kjo çështje u bë pika qendrore e vëmendjes se umetit musliman dhe gjithashtu u kthye në një çështje thelbësore për të.

**Së treti**: Intifada i dha një goditje të rëndësishëme projektit të paqes si dhe normalizimit të procesit me zionistët. Këtu doli si zgjidhja më e mirë mundësia e xhihadit.

**Se katërti**: Intifada pati një ndikim pozitiv në orientimin e popullit dhe jetës së përditshme. Armiqësia kundrejt projektit të zionistëve dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u shtua së tepërmi dhe popujt muslimanë iu përgjigjën pozitivisht thirrjes për bojkotimin e mallrave dhe produkteve amerikane dhe çifute. Shitjet në restorante amerikane (MacDonald dhe KFC) ranë në mënyrë drastike në disa vende si Arabia Saudite (rreth 80 %), ndërsa në Egjipt përdorimi i pijes së famshme Pepsi u ul rreth 46%. Njerëzit filluan të zgjidhnin për përdorim ushqime dhe pije të prodhimit kombëtar dhe një gjë e tillë u bë aq e përhapur, sa disa kompani amerikane u detyruan të deklaronin hapur distancimin e tyre të plotë nga shteti zionist. Një shembull i kësaj është kompania MacDonald në Arabinë Saudite, e cila ka dhuruar një rijal për çdo vakt për palestinezin e plagosur gjatë intifades.[88]

**Së pesti**: Vendosja e paqes është një çështje e pandershme dhe asgjë e dobishme nuk arrihet nëpërmjet saj. Populli arab dhe ai palestinez nuk pranojnë të heqin dorë nga asnjë e drejtë që u takon në lidhje me çështjen e tokës së shenjtë.

**Së gjashti**: Intifada, sidomos në fazat e para të saj tregoi rëndësinë e masmediave muslimane, si stacionet televizive dhe postat elektronike për të paraqitur paragjykimet e palës kundërshtare zioniste dhe asaj perëndimore. Po ashtu, kjo masmedia arriti të sigurojë dhe mbështetje për çështjen e drejtë palestineze.

Fakti që pati një dyndje të palestinezëve nga të gjitha anët e vendit dhe nga të gjitha rrymat politike për të marrë pjesë në intifadë bëri që pala kundërshtare zioniste të shtonte terrorin e saj duke përdorur armë

[88] Per shembuj te tjerë në kete drejtim, shih raportet e internetit nga tetori në dhjetor 2000 në adresen: www.palestine-info.org. and www.islam-online.net.

që ishin të ndaluara nga bashkësia ndërkombëtare dhe në mjaft raste vrau shumë fëmijë dhe njerëz të pafajshëm.

Është fakt se gjatë viteve të intifadës forcat izraelite kanë ushtruar presion vazhdimisht duke e thelluar më tej armiqësinë kundër palestinezëve.

Tanket e tyre kanë vazhduar të imponojnë konflikte, të ushtrojnë dhunë ndaj palestinezëve e të konfiskojnë pasuritë e tyre, në një kohë kur mjetet e tyre të informimit (të pasuara dhe nga media perëndimore) nuk reshtin së ankuari nga mungesa e dëshirës së palës palestineze për paqe. Kjo është një pjesë e "serialit", me të cilin bota është mësuar që ta konsiderojë palën e nervozuar që ka pushtuar një poppull tjetër dhe që posedon të gjitha llojet e armëve të shkatërrimit në masë, se është ai që duhet të qetësohet e ti ulen nervat, ndersa "viktima", që në rastin konkret është populli palestinez, të cilit i është bërë padrejtësi, është dhunuar e pushtuar, ai duhet që të dëshmojë "qëllimet e tij të mira" dhe të pranojë "paqen".

Në vitin 2005 u ul disi vala e intifadës së Al-Akses dhe kjo erdhi si rezultat i ngjarjeve që ndodhën, siç ishte vdekja e Jaser Arafatit, zgjedhja e Mahmud Abasit si president dhe për shkak të angazhimit të palestinezëve në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazes me zgjedhjet lokale dhe përgatitja për zgjedhjet parlamentare. Po ashtu, grupet palestineze bënë thirrje në 22 janar për qetësi nga ana e tyre dhe me pas u deklarua edhe ndalimi i përdorimit të zjarrit ndërmjet autoritetit palestinez dhe Izraelit në 8 shkurt.

Gjithashtu në vitin 2005 sulmet e rezistencës kanë qenë më tepër në formën e sulmeve hakmarrëse apo kundërpërgjigje për sulmet dhe dhunimet çifute.

Sipas Qendrës Palestineze për Informim, numri i shkeljeve të çifutëve që llogariten të jenë bërë pas deklarimit të ndalimit të zjarrit që nga 8 shkurti deri në 2 janar 2006 arriti ne 23427, nga të cilat 2366 kanë qenë sulme të armatosura.[89]

[89] Qendra Kombetare Palestineze për Informim, 2 shkurt 2006. Per me teper shih adresën e eposhtme: http://www.pnic.gov.ps/arabic/quds/arabic/viol/2-1-2006.html

Gjatë periudhës nga 28/9/2000 deri në 31/12/2005 numri i dëshmorëve të vrarë arriti në 4242, prej të cilëve 293 ishin fëmijë dhe 270 të tjerë ishin gra dhe vajza.

Autoritetet hebreje bënë shumë vrasje politike për të hequr qafe palestinezët aktivë. Ata arritën të vrasin 376 shtetas, ndërkohë që 140 të sëmure: fëmijë, gra dhe pleq, të cilët vuanin nga zemra, veshkat dhe tumori vdiqën për shkak të rrethimit të murit çifut. Ndërsa numri i të plagosurve arriti 46 068.[90]

Me gjithë deklarimin për qetësi të palestinezëve dhe rënien e intifadës, sërish numri i të burgosurve u rrit ndjeshëm. Pasi kishte qenë rreth 7800 të burgosur në fillim të vitit 2005, ky numër u rrit në 9200 në fund të po këtij viti. Po ashtu, gjatë vitit 2005 u arrestuan 3495 palestinezë, 1600 prej të cilëve mbetën të ngujuar pas hekurave.[91]

Në të njëjtën kohë numri i shtëpive të rrënuara tërësisht dhe pjesërisht arriti në 71470. Edhe numri i institucioneve arsimore dhe edukative që u bombarduan ishte 316 shkolla, zyra, biblioteka dhe universitete, ndërkohë që tre shkolla palestineze u shndërruan në kazerma ushtarake të zionistëve. Jo vetëm kaq, por çifutët kanë shkulur dhe kanë shkatërruar edhe 1 355 290 pemë.

Në vitin 2005 përqindja e papunësisë arriti në 28.4 %, ndërkohë që varfëria në tokat palestineze gjatë izolimit dhe rrethimit çifut deri në fund të vitit 2004 arriti në 42.0 % dhe më konkretisht 63.2 % në Rripin e Gazës dhe 31.2 % në Bregun Perëndimor.

Llogaritjet tregojnë se ekonomia palestineze ka humbur që nga shpërthimi i kryengritjes (intifades) më 29/9/2005 rreth 15.6 miliarde dollare.[92]

Duhet theksuar se gjatë kohës së intifades bijtë e Palestinës qëndruan trimërisht dhe vazhdojnë të qëndrojnë edhe sot.

---

90

91 Sipas nje raporti për çështjet e te burgosurve te vitit 2005 dhe sipas burimeve të sigurise dhe ushtrise izraelite, numri i te burgosurve palestineze ne fillim te vitit 2005 ka qene 7838, ndersa ne fillim te vitit 2006 ky numër arriti ne 8238. Per me shumë shih www.pnic.gov.ps/ambic/social/prisoners/2005.html

92 Qendra Kombetare Palestineze per Informim. Per me teper shih: http://www.pnic.gov.ps/arabic/quds/arabic/losses/28-9-2005.html

Të gjitha mënyrat që u përdorën nuk mundën ta shtypin kryengritjen (intifaden), e cila mori një natyrë ushatrake dhe u fuqizua jashtë mase përherë e më tepër.

Nga ana e tyre, zionistët u përpoqën që të jepnin gjithmonë informata të errëta e shpesh edhe ti fshihnin informacionet për humbjet e tyre, përveç atyre që nuk mund ti fshihnin dot. Ata deklaronin gjithmonë shifra sa më të ulëta për humbjet, për të mos ulur moralin e shoqërisë zioniste dhe ushtarëve të saj.

Ndodhi që të gjitha grupet palestineze të përfshiheshin në sulmet ushtarake. Sipas statistikave çifute, rezistenca palestineze ka realizuar 22406 sulme në periudhën 29/9/2000-24/7/2005.[93]

Lëvizja Hamas u dallua për rolin e saj të madh me sulmet e saj luftarake, të cilat e tronditën pushtuesin dhe sigurinë e zionistëve. Pjesa më e madhe e këtyre sulmeve u bënë në Palestinën e pushtuar në vitin 1948. Deri në 1/12/2005 ndodhën rreth 135 sulme, pjesa më e madhe tyre u bënë nga Hamasi, por në to morën pjesë dhe brigadat Al-Aksa dhe Xhihadi Islamik.[94]

Shërbimet Sekrete Izraelite tregojnë se, që nga fillimi i intifadës e deri në korrik të vitit 2005, janë vrarë 1513 izraelite dhe janë plagosur 3380 të tjerë.[95]

Me gjithë metodat barbare dhe të dhunshme që përdorën zionistët, sërish intifada arriti të bëhet shkas për rrëzimin e qeverisë së Partisë Laburiste të Barakut dhe humbjen përfundimtare të tij në zgjedhjen e kryetarit të qeverisë në 6 shkurt 2001.

Zionistët zgjodhën në krye të qeverisë së tyre një tjetër çifut, më gjakësor dhe më ekstremist, i njohur për masakrat e tij barabare që ka bërë kundër palestinezëve. Ai ishte Ariel Sharoni, kreu i Partisë Likud. Zionistët bënë të mundur që Sharoni dhe partia e tij të vazhdonin të

[93] Web site i ushtrise izraelite: http://www.idf.il/SIP STORAGE/DOVER/files/9/ 21829.doc
[94] Web site i ushtrise izraelite; http://www.idf.il/SIP STORAGE/DOVER/files/6/ 31646.doc
[95] Raportin e ka publikuar gazeta "Mearif" dhe e ka botuar përkthimin e saj gazeta "As-Safir"me 15 qershor 2005.

qëndronin në pushtet dhe kjo pas zgjedhjeve të 28 janarit 2003, në mënyrë që ai të vazhdonte politikën e tij shfarosëse dhe gjakatare në përpjekjet për të ndalur intifaden. Mirëpo përpjekjet e tij dështuan. Shoqëria zioniste e humbi shpresën për siguri. Njerëzit filluan ti shmangen hipjes nëpër autobuza dhe dilnin nëpër tregje rrallë, sipas mundësisë, për tiu shmangur çdo shpërthimi të mundshëm që mund të ndodhte nga çasti në çaste në çdo vend.

Endrrat e tyre për tua imponuar rregullat e tyre të turpshme muslimanëve dhe arabëve janë zhdukur si pluhuri në erë dhe projekti i paqes ka marrë një rrugë të sigurt për në koshin e historisë.

Edhe një herë bota e pa se kush ishte fytyra e shëmtuar e zionizmit dhe kjo sidomos në vrasjen e kohëve të fundit të fëmijës dëshmor Muhamed al-Durrah, i cili u vra nga duart barbare dhe hakmarrëse të ushtarëve zionistë dhe bota e pa se kush ishin në të vërtetë çifutët.

Po ashtu, shteti çifut e hoqi mbi kurriz rënien e ekonomisë, ndërkohë që para intifadës ekonomia e tij kishte marrë një hov të fuqishëm. Pothuajse turizmi u pezullua gjatë dy viteve të para të kryengritjes, ndërkohë që duhet të përmendim se vetë turizmi është në vend të dytë të të ardhurave më të mëdha që përfiton shteti zionist.

Sipas një raporti që publikoi Shoqëria e Sigurimeve Kombëtare Qeveritare, numri i çifutëve nën nivelin e varfërisë u rrit në 22 % në fund të vitit 2004 dhe më konkretisht ata ishin 1 milion e 534 mijë".[96]

Ndërsa sipas një raporti zyrtar të publikuar nga Zyra Qendrore e Statistikave Hebreje, viti 2002 ka qenë viti më i mbrapshtë për ekonominë çifute gjatë 50 vjetëve të fundit (që nga viti 1953). Po ashtu ky raport përmend se burimet e përgjithshme lokale ranë 1% në vitin 2002 në vazhdimësi të rënies prej 0.9 % që ishte në vitin 2001 dhe në krahasim me rritjen prej 0.74 % që ishte në vitin 2000.[97]

Edhe përqindja e papunësisë u rrit në 10.5 % në vitin 2002 dhe parashikohej që kjo shifër të rritej në 12% në vitin 2003. Po ashtu, u rrit

---

[96] Web site arab 48. 8 gusht 2005: http://www.arabs48.com/ display.x?cid=16&sid=66&id=30295

[97] Shih www.cbs.gov.il dhe "Quds Press", periodiku "Panorama", 2 janar 2003.

numri i izraelitëve që ishin nën nivelin e varfërisë në masën 20 %, pra 1 milion e 200 mijë vetë.

Gjithashtu u ul sasia vjetore e të ardhurave për frymë në rreth 3000 dollarë (nga 18 600 $ në vitin 2000 në 15 600 $ në vitin 2002). Sipas një raporti të Departamentit të Ekonomisë në Unionin e Pavarur "Lahaf në vitin 2002 u mbyllën 50 000 dyqane, ashtu siç parashikohej që të mbylleshin dhe dhjetëra mijëra projekte tregtare dhe biznese të tjera të mesme në vitin 2003.[98]

Sipas disa perllogaritjeve, totali i humbjeve ekonomike çifute për dy vitet e para të intifadës arriti në 8 miliardë dollarë, e thënë më konkretisht 11 milion dollarë në ditë.

Në këtë mënyrë dallimi esencial që shfaqi intifada ishte se populli palestinez nuk duhet të konsiderohej si pala e vetme që paguan çmimin e pushtimit dhe pretendimeve të kota çifute. Kjo u arrit duke sakrifikuar njerëz, të plagosur dhe shkatërrime. Në të vërtetë u shndërrua bashkësia zioniste ajo që paguante më shumë për uzurpimin dhe padrejtësitë e shumta që kishte bërë.

Kjo intifadë solli diçka të re, tronditje të thellë për bashkësinë zioniste. Dy bazat, mbi të cilat u ngrit ekzistenca materiale e kësaj bashkësie, siguria dhe hovi i ekonomisë tashmë ishin në dilemë. Kështu me dhjetëra mijëra çifutë, përgatisin çantat dhe nisen për Evropë, Amerikë. Australi e gjetkë, duke lënë pas bashkësinë çifute dhe problemet në vend.

Disa sondazhe të opinionit publik nxjerrin në pah se 25 % e çifutëve në Palestinë mendojnë seriozisht që ta lënë atë vend. Një sondazh i bërë nga gazeta izraelite "Jerusalem Post", e datës 29 nëntor 2002, bëri të ditur se 69% e izraelitëve jetojnë me frikë për shkak se mund të plagosen apo mund të vdesin si rezultat i sulmeve kamikaze.[99]

Nga ana tjetër, me gjithë vuajtjet e shumta të palestinezëve, një sondazh më datë 18 dhjetor 2002 botoi se 80 % e palestinezëve e

---

98 -Quds Press", periodiku "Panorama". 3 janar 2003.

99 Eshte marrë nga http://news.bbc.co.uk, 30/11/02

perkarahnin vazhdimësinë e intifadës dhe 63 % e tyre mbështesnin sulmet kamikaze. [100]

Nuk duhet harruar se dhe numri i viktimave të intifadës është me të vërtetë kolosal. Deri në mars 2001 u vranë rreth 420 palestinezë, u plagosën 20 mijë dhe qindra shtëpi të palestinezëve u bombarduan (duke iu referuar një statistike të Ministrisë Palestineze të Shëndetësisë, numri total i viktimave deri më 3 gusht 2001 arriti në 634 të vrarë dhe 28 007 të plagosur).

Një detaj i rëndësishëm është se 13 nga dëshmorët që u vranë ishin bashkatdhetarë nga tokat palestineze të pushtuara në vitin 1948, të cilët u bashkuan me vëllezërit e tyre në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës kundër imperializmit zionist.

Rrethimi mizor që zionistët i bënë vendbanimeve palestineze çoi në humbje të mëdha për ekonominë palestineze, që shkon në 8 milionë dollarë në ditë (505 milionë në 60 ditë).

Zyra e një koordinatori special të Kombeve të Bashkuara tregon se 190 mijë palestinezë humbën punën, numër ky që i shtohet numrit të atyre që iu bashkuan ushtrisë përpara intifadës, numër i cili shkonte në 70 mijë (kështu numri i përgjithshëm i të papunëve arriti 260 000). Po të llogarisim dhe familjet e tyre ata përbëjnë I milionë e 270 mijë veta që do të thotë 45.5% të popullsisë së përgjithshme të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. [101]

Sipas statistikave të siguruara nga Organizata Arabe e Punës, humbjet ditore që i shkaktohen sektorit të punës, tregtisë, industrisë dhe sektorit të bujqësisë janë respektivisht 6.6, 5.5, 3.3 dhe 3.2, milionë dollarë.[102]

Policia dhe forcat e armatosura zioniste i qëllonin "protestuesit e gurëve" me paramendim dhe kjo vërtetohet se 65 % e viktimave janë qëlluar në pjesët e sipërme të trupit si koka, kraharori dhe stomaku. Po ashtu janë përdorur armë të ndaluara nga faktori ndërkombëtar dhe

[100] Gazeta "Al-Khaleej", 18 shkurt 2003.
[101] Gazeta Al-Khaleej, 18 dhjetor 2000.
[102] Ibid, 6 dhjetor 2000.

përdorimi i tyre është regjistruar në 40 % të viktimave. Humbjet e shkaktuara në radhët e fëmijëve dhe moshës së re përbëjnë 40 % të numrit total të viktimave. Nga ana tjetër sigurimi zionist ka përdorur metoda barbare për eleminimin e një numri liderësh palestinezë, veçanërisht ata të Hamasit dhe lëvizjes Fatah. Të gjitha këto akte mizore vërtetojnë pa pikë dyshimi se pretendimet e shtetit zionist për "demokraci" dhe "modernizëm" janë të pavërteta dhe mashtrime.

Megjithatë, i gjithë ky brutalitet nuk arriti ta mposhtë intifaden, e cila, ndryshe nga ajo çfarë prisnin zionistët, mori një hov të madh dhe numri i ushtarëve në radhët e saj u rrit ndjeshëm.

Izraelitët, nga ana e tyre, pranuan faktin se ndaj shënjestrave zioniste u ndërmorën operacione që zgjatën 50-70 ditë, shifër kjo që është me të vërtetë shumë e lartë. Po ashtu kjo gjë bëhet më mbresëlënëse kur përmendet fakti se kjo gjë është publikuar nga media zioniste që zakonisht e nënvlerëson forcën e rezistencës dhe humbjet që shkaktohen nga ajo në mënyrë që të ngrejë moralin e publikut dhe ushtarëve zionistë. Në këtë mënyrë media kërkon që luftëtarët muxhahidinë të demoralizohen dhe vendet arabo-islame që janë përfshirë në luftë të shkurajohen.

Të gjitha grupet palestineze kishin pjesën e tyre në rezistencën që u organizua, por operacionet e Hamasit ishin dhe janë ende më befasuesit nga ana e cilësisë, precizionit dhe ndikimit që kanë. Dy nga këto operacione u ndërmorën në Rafah në 7 nëntor 2000, gjatë të cilit u shkatërrua një barkë izraelite, u vranë 21 zionistë dhe 65 të tjerë u plagosën. Gjatë opercioneve të tjera përmendim vrasjen e zionistit djallëzor Binjamin Kahana më 31 dhjetor, i cili ishte lideri i lëvizjes ekstremiste Kakh. Po ashtu përmendim operacionin për hedhjen në erë të dy tankeve në janar 2001 dhe operacionin e Natanijes të datës 4 mars, gjatë të cilit u vranë 8 çifutë dhe u plagosën 23 të tjerë.

Shteti zionist e pranoi vetë faktin se operacionet e udhëhequra nga Hamasi, Xhihadi Islamik, Fatah dhe frontet popullore e demokratike gjatë pesë muajve çuan në vrasjen e 70 zionistëve dhe në plagosjen e 750 të tjerëve.

Në 15 gusht 2001 numri i përgjithshëm i viktimave shkonte në 155 të vdekur dhe 1500 të plagosur.

Në të vërtetë shteti zionist e shikonte këtë fakt si një humbje tepër të madhe, përderisa për të u desh një numër më i paktë viktimash. 20-30 të vdekur në vit, që e bënë shtetin zionist që të tërhiqej nga Libani.

Kështu mund të themi se intifada i ka kushtuar shumë shtrenjtë zionistëve dhe në 6 shkurt 2001 çoi në humbjen e qeverisë Laburiste të Barakut.

Intifada po ashtu e ka goditur rëndë dhe ekonominë e bashkësisë çifute. Sektori i turizmit ka pësuar një humbje prej një miliardë dollarësh amerikanë dhe produkti kombëtar i Izraelit ka pësuar një rënie prej 9.8 %, pas një rritjeje të madhe rreth 9 % gjatë tremujorit të fundit të vitit 2000. Në këtë mënyrë balancat tregtare pësuan një rënie me 31 % dhe defiçiti tregtar vetëm për muajin tetor 2000 arriti në 486 milionë dollar.[103]

Në gusht të vitit 2001 humbjet ditore financiare izraelite kapnin shumën e 14-16 milionë dollarëve.

## Jeruzalemi dhe situata aktuale

Çifutët pushtuan gjatë luftës së 1948-ës Jeruzalemin Perëndimor, që përbën 84.1 % të sipërfaqes së përgjithshme të të gjithë këtij qyteti të shenjtë. Megjithëse në pjesën më të madhe ajo është një pronë që u përket arabëve (rreth 85%), ky rajon shumë shpejt u judaizua nëpërmjet ndërtimeve të banesave hebreje si dhe nga konfiskimi i tokave të fshatrave që ndodheshin rreth tij, siç ishte rasti i Liftës, në të cilin u ndërtua parlamenti i Izraelit (Keenest), si dhe një numër ministrish, Ain Karim, Deir Jasin dhe al-Maliha.[104]

---

103 Shih revisten *Al-Mujtama* (Kuvajt), 28 nëntor 2000 dhe "*Falastin al-Muslimah*", (Palestina muslimane), mars 2000.

104 Shih Rafik al-Natshah dhe Ismail Yaghi, *Tarikh Madinat al-Kuds, (Historia e qytetit te Kudsit)*, (Aman, 1984), fq.94 dhe Henery Cattan, *Falastin fi Dawal-Haq wa al-Adl* (Bejrut, 1970), fq.45.

Në vitin 1967 zionistët e përfunduan pushtimin e tyre të Jeruzalemit duke aneksuar dhe judaizuar pjesën lindore, ku përfshihej dhe xhamia Al-Aksa, megjithëse kjo pjesë teknikisht i përkiste Bregut Perëndimor. Dy pjesët e këtij qyteti u bashkuan nën administratën e Izraelit më 27 qershor 1967 dhe më pas, me 30 korrik 1980, qyteti i bashkuar u cilesua zyrtarisht si kryeqyteti i përjetshëm i shtetit zionist.[105]

Sipas ideologjisë çifuto-zioniste, Jeruzalemi është një çështje qendrore që ka të beje me rendesinë e gjerë historike dhe fetare të çifutëve. Pesëdhjetë vjet përpara krijimit të bashkësisë zioniste, Herzel, themeluesi i Organizatës Botërore Zioniste ka thënë: "*Nëse do ta shtiem në dorë Jeruzalemin përpara se unë të vdes, unë personalisht do të zhduk gjithçka që nuk eshte e shenjte për çifutet dhe do të djeg të gjitha reliket që janë vendosur në të gjatë shekujve.*"[106]

Duke vazhduar në të njëjtën linjë ai që është de facto themeluesi dhe njëkohësisht dhe kryeministri i shtetit çifut, David Ben-Gurion, është shprehur se: "*Izraeli nuk ka kuptim pa Jeruzalemin dhe vetë Jeruzalemi nuk ka kuptim pa tempullin (tempullin e Solomonit)*".

Shteti zionist, duke këmbëngulur në programin e tij sistematik dhe të gjerë për judaizimin e vendit në mënyrë graduale, e ka zgjeruar zonën përfshirëse të Jeruzalemit deri në Bregun Perëndimor që shkonte nga 6.5 km në vitin 1967, në 123 km2 në vitin 1990 dhe ka në plan që në këtë mënyrë të arrijë të formojë të ashtuquajturin "Jeruzalemin e Madh", ku do të përfshihen 840 km$^2$, që do të thotë 15 % e Bregut Perëndimor. Zionistët themeluan brenda zonës lindore të Jeruzalemit, rreth qytetit të vjetër ku është ndërtuar xhamia Al-Aksa, një rrip prej 11 qendrash banimi çifute, ku janë, strehuar 190.000 çifutë.

Një vendbanim akoma dhe më i madh, ku janë përqendruar 17 koloni hebreje, u ndërtua pas këtij të fundit rreth Jeruzalemit dhe kjo ka qenë një përpjekje për ta izoluar Jeruzalemin nga mjedisi arabo-islam që e rrethon dhe si rrjedhim bëhet gati e pamundur që ky qytet apo

[105] *Al-Mawsuah al-Falastinijah (Enciklopedia Palestineze)*, Vol.3, fq.522.
[106] Al-Natshah, *op.cit.*, fq. 157

pjesa lindore e tij ti dorëzohet në të ardhmen pjesës palestineze.[107]

Sipas disa statistikave të marra në vitin 2000, popullimi i Jeruzalemit, atij lindor dhe perëndimor, arrin totalisht në 650 mijë, nga të cilët 450 mijë janë çifutë dhe pjesa tjetër janë arabë. Këta të fundit që janë rreth 200 mijë jetojnë në përgjithësi vetëm në pjesën lindore të qytetit. Jeruzalemi i cili përpara pushtimit britanik ka qenë 90% i populluar nga arabët, pas fushatës në rritje për judaizimin në mënyrë të dhunshme të popullatës arriti të ketë një popullsi 86% çifute në vitin 2000. Ndërkohë që arabët kanë në posedim vetëm 4% të tokave të këtij qyteti dhe pjesa tjetër prej 10% ruhet për të vënë në zbatim projektet e ardhshme çifute.[108]

Por përvoja e xhamisë Al-Aksa është akoma dhe më e hidhur dhe katastrofike. Pak ditë pas pushtimit të Jeruzalemit, zionistët shkatërruan qendrën Al-Magharibah që ndodhet përballë me murin perëndimor të xhamisë "Al-Burak", që njihet nga çifutët si "Muri i lotëve" dhe përbëhet nga 135 vendbanime dhe dy xhami. Ata e kthyen atë në një territor të hapur për praktikimin e ritualeve çifute. Në përpjekjet e tyre të ethshme për të gjetur mbetjet arkeologjike të tempullit që ata pretendojnë (tempullit të Sulejmanit (Solomoni), çifutet ndërmorën gërmime intensive në pjesën jugore dhe perëndimore të Jeruzalemit, por për fatin e tyre jo të mirë pjesa më e madhe e mbetjeve arkeologjike që ata arritën të gjenin ishin relike islame që konfirmonin islamizimin e këtij qyteti.

Gjatë periudhës kohore 1967-2000 çifutët, në mënyrë të zjarrtë e njëkohësisht dhe të fshehtë, ndërmorën dhjetë raunde të mëdha gërmimesh dhe ndërtuan tunele poshtë xhamisë Al-Aksa, në të cilët ata përdorën substanca kimike për të shkatërruar shkëmbinjtë poshtë saj.

Kjo ndërhyrje e tyre e vë në rrezik të hapur këtë vend të shenjtë

---

[107] Mbi judaizimin e Jeruzalemit gjatë kësaj periudhe, shih *al-Mawsuah al-Falastiniah*, (Enciklopedia palestineze), Vol.3, fq 521-27: Ibrahim Abu Xhabire te tjere. "Kadijat al-Kuds wa Mustakbaluha", (Çështja e Kudsit dhe e ardhmja e tij), ne *al-Madkhal ila al-Kadijah al-Falastinijah, (Hyrje në çështjen palestineze)*, (Aman, 1997) fq.544-68 dhe gazeta Al-Dustour, 18 qershor 1997.

[108] Per me shumë rreth kësaj, shih Ibrahim Abu Xhabir e te tjere, op.cit, fq.541 dhe Rafik al-Natsha, *op. cit.*. fq.98.

dhe xhaminë e shenjtë, e cila ndodhet përballë rrezikut të shkatërrimit dhe mund të shembet në rast të ndonjë tërmeti të lehtë apo të ndonjë stuhie të fortë.

Gjatë viteve 1967-1993 çifuto-zionistët ndërmorën dyzet sulme ndaj kësaj xhamie dhe, pavarësisht nga Traktati i Oslos, ata vazhduan ta sulmonin atë edhe shtatëdhjetë e dy herë të tjera gjatë periudhës 1993-1998.

Një nga sulmet më mizore dhe poshtëruese ishte djegia e xhamisë Al-Aksa më datë 21 Gusht 1969. Më tej u bënë katër përpjekje për ta bombarduar atë dhe përkatësisht në I maj 1980 dhe në janar, gusht dhe dhjetor të vitit 1984. Ndërsa një grup ekstremist çifutësh vendosën në 17 tetor 1989 gurin themeltar të tempullit që ata mendojnë se duhet të ndërtohet në vend të xhamisë Al-Aksa. Këtë gur ata e vendosën në hyrje te kësaj xhamie.[109]

Megjithatë populli palestinez, pavarësisht se është ndodhur nën pushtimin e egër çifut dhe ka qenë i braktisur nga vendet arabe dhe muslimane, ai ka qenë gjithnjë vigjilent dhe në alarm për mbrojtjen me të gjitha mjetet e mundshme të xhamisë Al-Aksa. Të gjitha sulmet e çifutëve ndaj kësaj xhamie janë pasuar nga sulme hakmarrëse të palestinezëve, ndonëse dhe çifutët më pas kanë ndërmarrë fushata masakrash të përgjakshme kundër tyre.

Kështu mund të përmendim faktin se pasojë e këtyre përleshjeve ishin 34 të vrarë dhe 115 të plagosur në përpjekjet për ti bërë rezistencë një grupi ekstremist çifut që kërkonte të vendoste "gurin themeltar" te "Tempullit" në territorin e brendshëm të xhamisë Al-Aksa në 8 tetor 1990.

Gjatë "kryengritjes" që shpërtheu si kundërshtim ndaj hapjeve të tuneleve nga ana e çifutëve nën xhaminë Al-Aksa më 25-27 shtator 1996, pati viktima dhe numri i tyre shkoi në 62 të vdekur që ranë dëshmorë dhe 1 600 të plagosur.

---

[109] Shih Ibrahim Abu Xhabir, op cit., fq.564-68, *Al-Mawsu'ah al-Falastiniah*, (Enciklopedia palestineze), Vol. 3, fq.522-23, gazeta *Al-Khaleej*, 13 shkurt, 27 qershor, 9 shtator 2000 dhe 17 janar 2001, sipas Qendrës Palestineze per Informim (http:/ www.palestine-info.org), 23 mars 2 dhe 6 prill 2000.

Që nga viti 1967, si Kombet e Bashkuara ashtu dhe Këshilli i Sigurimit miratuan një sërë rezolutash që nuk e pranonin aneksimin izraelit të Jeruzalemit Lindor dhe shfuqizuan çdo masë fizike apo administra- tive të ndërmarrë për të ndryshuar statusin e qytetit si një qytet pa pushtet dhe i zbrazët. Për më tepër ata e dënuan Izraelin si një forcë pushtuese që duhet të tërhiqej si nga Jeruzalemi ashtu dhe nga Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës.

Ndër këto rezoluta që u miratuan, rezoluta e parë ishte ajo me nr.22 53 e datës 4 korrik 1967, ndërsa më 29 korrik 1980 pas aneksimit të njëanshëm që iu bë Jeruzalemit, Organizata Botërore me shumicë votash, ku 112 vota pro, 8 kundër dhe 24 abstenime, më 29 korrik 1980 miratoi një rezolutë që njihet si rezoluta ES 712. Kjo rezolutë bënte thirrje për një tërheqje të përgjithshme dhe pa kushte të zionistëve nga territoret e pushtuara, ku përfshihej dhe Jeruzalemi. Në të njëjtën mënyrë në ditët në vazhdim, Këshilli i Sigurimit pothuajse unanimisht (me 14 vota pro dhe me abstenimin e Shteteve të Bashkuara) miratoi një rezolutë që bënte thirrje për dhënien fund të pushtimit izraelit si dhe dënonte të gjitha masat e ndërmarra nga ana e këtij të fundit për të ndryshuar statusin e Jeruzalemit dhe i quante ato si të paligjshme.

Megjithëse haptazi ata i njihnin të drejtat e palestinezëve, këto rezoluta në fakt nuk ishin të vendosura dhe nuk posedonin mekanizmat e nevojshëm për të detyruar zbatimin e këtyre pikave ndaj shtetit arro- gant izraelit, i cili nuk do tia dijë për komunitetin ndërkombëtar.[110]

Në vitin 2005 u rrit fushata e judaizimit të Kudsit dhe e veçimit të tij nëpërmjet murit ndarës racist përqark qytetit. Në Jeruzalem u ngulën intensivisht kolonitë hebreje, u asgjësuan pasuritë e arabëve, e në mënyrë të veçantë brenda Jeruzalemit të vjetër. Gjithashtu zionistët nxorrën ligje diskriminuese për ta bërë të vështirë jetesën e palestinezëve që jetojnë në Jeruzalem.

Në vitin 2005 ekstremistët çifutë deklaruan se ai vit (2005) do të ishte viti i tempullit të pretenduar (tempulli i Solomonit). Kështu gjatë

[110] Mbi trajtimin e çështjes së Jeruzalemit në Kombet e Bashkuara, shih *Al-Mawsu' ah al-Falastinijah*, (Enciklopedia palestineze), Vol.3, fq.548-53.

këtij viti xhamia Al-Aksa përballoi shumë sulme të kryera kundër saj nga kolonët hebrenj në bashkëpinim me qeverinë pushtuese.

Ndër përpjekjet më të mëdha që ndërmorën çifutët ishte ajo e bashkësisë ekstremiste "Rafafa", e cila bëri thirrje për rrënimin e xhamisë në prill të vitit 2005. Mirëpo përpjekja e tyre dështoi, pasi palestinezët qëndruan heroikisht në mbrojtje të xhamisë Al-Aksa.

Ekstremistët edhe një herë tjetër bënë thirrje për prishjen e xhamisë në 6 qershor 2005, por plani i tyre sërish dështoi. Edhe pas ketyre dy përpjekjeve ka pasur tentativa të tjera për rrënimin e xhamisë, por me mënyra më pak të mprehta. Po ashtu zionistët kanë filluar përgatitjet për tempullin dhe kanë ndërtuar një pamje të madhe për të 25 m të lartë në koloninë Karjiat Shamona, në veri të Palestinës së pushtuar. Shtojmë këtu dhe përgatitjen e veshjeve të "klerikut më të madh në tempull" dhe paraqitja e këtyre veshjeve.

Përpjekjet e qeverisë uzurpuese kanë qenë të vazhdueshme gjatë vitit 2005 për të pasur nën kontroll xhaminë Al-Aksa. Në 20 prill të vitit 2005 ata ndërtuan një urë në zonën e quajtur Muri i Burakut, e cila kishte për qëllim tu mundësonte një numri të madh zionistësh dhe turistësh të huaj që të hynin në xhaminë Al-Aksa nga porta Al-Megaribe, të cilën e kontrollon policia hebreje. Po ashtu, është zbuluar se autoritetet izraelite kanë përfunduar nga ndërtimi i pjesës më të madhe të qytetit fetar turistik, nën xhaminë Al-Aksa, i cili ndodhet 14 m nën dhé, poshtë xhamisë.

Viti 2005 shënoi edhe një skandal tjetër që kishte të bënte me shitjen e pasurive të Kishës Ortodokse. Ky fakt u zbulua më 18 mars 2005 dhe duhet thënë se ky veprim dëshmon qartë për një marrëveshje të fshehtë ndërmjet dy kolonive hebreje dhe Patriarkanës Ortodokse Greke. Këto dy grupe kolone hebreje blenë të gjtha tokat ku ndodhej Hotel Imperial dhe Hotel Al-Patra e po ashtu edhe 27 njësi tregare që i zotëronte Patriarkana në sheshin Umer ibën El-Hatab në qytetin e vjetër në Jeruzalem.

Në këtë skandal ishte implikuar edhe patriarku Irinios i Parë dhe kjo bëri që ai të rrëzohej nga posti që kishte më 5 maj 2005. Edhe me

zgjedhjet e kompleksit të shenjtë të Patriarkanës Romako-Ortodokse në Jeruzalem, ku u zgjodh Miteran Theopilus i Trese patriark i ri i Kishës Ortodokse më 22 gusht, sërish vazhduan tentativat e qeverisë pushtuese për të uzurpuar dhe për të thyer linjat zyrtare, duke ndikuar në emërimet e bëra në kishën greke në Jeruzalem për të mundësuar shitjen e pronave që janë në varësi të kësaj kishe atje.

## Muri ndarës

Projekti për murin ndarës që po ndërton Izraeli në Bregun Perëndimor pasqyron një akt të qartë racial dhe shpreh logjikën izoluese të zionistëve, të cilët kanë preferuar të jetojnë për shekuj të tërë në lagje të veçanta me mure të larta, të rrethuara në zona të ndryshme të Evropës. Dihet se ata kanë qenë të veçuar e kanë komunikuar me të tjerët pas mureve. E tillë ka qenë dhe politika raciale që ndoqi në të kaluarën sistemi i të bardhëve në Afrikën e Jugut.

Kjo gjë nuk është e huaj për natyrën e zionistëve, të cilët e kanë futur veten mes "mureve" fetare, politike, kulturore, gjuhësore në të gjithë rajonin reth tyre dhe e kanë gjetur veten të izoluar në mjedise kundërshtare. Nga ky fakt kuptohet se bashkësia zioniste nuk ka mundur që të jetë një bashkësi e pranueshme në atë rajon.

Për ngritjen e murit ndarës në Bregun Perëndimor, Izraeli ka disa qëllime dhe synime që ka vendosur dhe ka marrë në konsideratë. Ato janë:

1- **Dimensioni i sigurisë**; konsiston në ndalimin e hyrjes së luftëtarëve palestinezë nga Bregu Perëndimor në Palestinën e pushtuar në vitin 1948 dhe ndalimi i sulmeve kamikaze.

2- **Dimensioni politik**; konsiston në paraqitjen e Izraelit sikur është në rrethana të njëjta me palestinezët dhe në vendosjen e kufijve, ndërkohë që realisht ai bën të kundërtën, që e bën absolutisht të pamundur themelimin e një shteti të vërtetë palestinez. Nëpërmjet linjës që ndjek. politika çifute synon judaizimin e zonës e në mënyrë të veçantë të Jeruzalemit.

**3-Dimensioni ekonomik**; i cili konsiston në konfiskimin e tokave bujqësore të palestinezëve, në konfiskimin e ujërave të tyre, bllokimin e mundësive të tyre për të punuar e për të lëvizur dhe vënien e tyre në kushte të vështira jetese për të nxitur emigrimin në masë të tyre.

**4- Dimensioni politik**; pasi ndërtimi i murit ka për qëllim të shpërbëjë lidhjen shoqërore të palestinezëve, pasi ai izolon nga njëra- tjetra lagje, fshatra, qytete dhe ndalon kumunikimin e tyre shoqëror dhe familjar. Ndërtimi i këtij muri ka dhe shumë anë të tjera negative, pasi pengon normalitetin e shërbimeve mjekësore e arsimore për qindra mijëra njerëz që dëmtohen në mënyrë direkte prej tij.

Qeveria izraelite bëri një mur rrethues në Rripin e Gazës pas kryengritjes së parë në vitin 1987 dhe po ashtu Is hak Rabini i fitoi zgjedhjet e vitit 1992 nën moton "Ne këtu e ata atje".

Dhe realisht qeveria izraelite e mbajti fjalën me ngritjen e murrit ndarës me Bregun Perëndimor në prill të vitit 2002 dhe më konkretisht puna për ngritjen e këtij muri filloi me 16 qershor 2002.

Qeveria çifute e ka pranuar zyrtarisht se gjatësia e murit arriti në 652 km në periudhën kohore tetor 2003 - qershor 2004. Gjithashtu kryeministri çifut Ariel Sharon deklaroi në mars të vitit 2003 në luginën Jordan, per ngritjen e një muri në lindje të Bregut Perëndimor me një gjatësi prej 132 km. Në maj të vitit 2005 Komiteti Ndërministror Izraelit vendosi që muret rrethuese të përfshinin edhe një koloni hebreje në lindje të Jeruzalemit dhe kjo do të shtonte edhe 48 km të tjera në gjatësinë e murit dhe do ta çonte në 832 km totalin e përgjithshëm të gjatësisë së murit ndarës, pra edhe njëherë më shumë se gjatësia e kufirit të gjelbër (kufijtë e Bregut Perëndimor me territoret e pushtuara palestineze në vitin 1948), i cili arrin vetëm 320 km.

Nëse projekti i murit ndarës do të bëhet sipas planifikimeve çifute, realisht në të do të përfshihen 47.6 % e territoreve të Bregut Perëndimor nën administrinmin izraelit dhe kjo gjë do të dëmtojë në mënyrë direkte 680 000 palestinez 250 000 palestinezë do ta gjejnë veten të izoluar midis murit ndarës dhe kufirit të gjelbër, 330 000 palestinezë do të izolohen nga muri ndarës dhe do të humbasin tokat, të mbjellat e tyre dhe nuk do

të kenë mundësi të shkojnë në vendet e tyre të punës. Po ashtu 101 fshatra, qytete dhe komplekse banimi do të vuajnë ga ky mur ndarës dhe 19 prej tyre do ta shohin veten në perëndim të murit ndarës, të izoluar nga komunikimi me banorët në pjesët e tjera të Bregut Perëndimor. Në të njëjtën kohë 53 fshatra dhe qytete do të jenë të rrethuara nga muri ndarës nga tre anë.

Muri do të zgjerohet derisa të përfshijë brenda tij një numër sa më të madh të kolonive hebreje në Bregun Perëndimor. Ai është planifikuar në mënyre te tille qe te përfshije për palën zioniste 55 koloni, që përbëjnë 322 000 kolonë hebrejë, të cilët përfaqësojnë pjesën më të madhe të kolonëve në Bregun Perëndimor.

Autoritetet izraelite kërkojnë që të gjejnë sa më shumë përkrahje për projektin e murit ndarës, duke e konsideruar atë thjesht si një mur rrethues, mirëpo ai që vështron me vëmendje dhe analizon në detaje projektin në fjalë, do ta shohë se ka të bëjë me një kufi ushtarak të komplikuar. Projekti për ngritjen e këtij muri ka një linjë të ngarkuar me tela me gjemba në formë spiraleje, të cilat pasohen nga një hendek i madh 4 m i gjerë dhe 5 mi thellë, pastaj një rrugë e asfaltuar 12 me gjerë e pas saj një rrugë tjetër e mbuluar me rërë të imët, 4 me gjerë. Edhe kjo rrugë pasohet nga një mur i çimentuar 8 m i lartë dhe sipër këtij muri është vendosur një gardh metalik elektronik. Në shumë vende ka kamera të instaluara dhe prozhektorë zbulues e gjithashtu ka dhe kulla ushtarake vrojtuese siper murit.[111]

Ndoshta prej qëllimeve më të rëndësishme të murit është që të funksionojë mirë parapërgatitja për judaizimin e Jeruzalemit, konfiskimin e tokave dhe rrethimi i këtij qyteti me mure e me koloni që ia zënë

[111] Jane shkruar dhjetera raporte dhe studime mbi murin ndares dhe informacionet për kete çeshtje janë marrë nga burime te ndryshme, si nga numri 581 revistes "Studime Palestineze viti 2004. Gjithashtu shih dhe burimet e meposhtme: http:// www.biselem.org/arabic/Separation Barrier/Jerusalem asp, and BTsclem The Israeli Information Center for Human Rights in the Occupied Territories. Under the Guise of Security Routing the Separation Barrier to Enable the Expansion of Israeli Settle- ments in the West Bank, December 2005, in http://www.btselem.org/arabic/Publications/Index.asp?TF=15

frymën dhe e izolojnë atë nga bota arabe dhe ajo islame.

Këtu le të qëndrojmë pak për të hedhur pak dritë mbi këtë çështje. Përllogaritjet kanë përmendur se gjatësia e murit rreth zonës së Jeruzalemit do të jetë 181 km dhe do të ndjekë një trajektore përreth Jeruzalemit nga veriu i Betlehemit, duke përfshirë dhe Kabr Rahilin dhe duke izoluar nga Jeruzalemi dy fshatra; Ebu Dijs dhe Azirije. Më tej vazhdon në veri për të përfshirë koloninë hebreje Meali Adumim e më pas kthehet në perëndim për të izoluar shumë fshatra të tjera nga Jeruzalemi. Ndërsa përsa u përket dy fshatrave Bejt Nebala dhe Al- Habib, të cilat e gjetën veten në perëndim të murit, ato do të rrethohen nga një mur tjetër që i ndalon ato dy fshatra të kenë komunikim me Jeruzalemin, duke mos patur asnjë mundësi tjetër veç drejtimit nga Ramallah.

Po ashtu fshati Bejt Hanina do të jetë në perëndim të murit, i rrethuar nga muri dhe kolonitë hebreje nga tre anë dhe nuk ka asnjë mundësi komunikimi me Jeruzalemin, përveç fshatit Bejt Nebala në drejtim të qytetit Ramallah.

Sipas disa përllogaritjeve muri ndares do te izolojë nga Jeruzalemi 18 fshatra dhe qytete palestineze, në të cilat jetojnë 220 000 shtetas palestinezë. Ato fshatra dhe qytete kanë qenë gjithmonë në varësi të Jeruzalemit nga ana gjografike dhe lidhen ngushtë me të nga ana ekonomike dhe shoqërore (duke shtuar këtu edhe lidhjen fetare dhe politike). Ky mur ndarës do ti izolojë ato nga burimi kryesor i jetesës së këtyre njerëzve.

Kështu, me ndërtimin e murit ndarës, Jeruzalemi do të humbasë 90% të territoreve të tij. Do të realizohet gjithashtu rrethimi kolonial përqark qytetit nga kolonia Ebu Ganim (Harhuma) në jug deri në koloninë Meali Edudim në lindje, duke vazhduar kështu me koloni të tjera hebreje në veri të Jeruzalemit. Sipas planeve çifute, përqindja e arabëve që jetojnë në Kuds do të ulet në mënyrë të përafërt nga 33 % në 22%. Përfundimi i këtij muri të rrezikshëm për Jeruzalemin shkurt do të thotë izolimin e 617 vendeve të shenjta apo gjurmëve të qytetërimit nga pjesa tjetër arabe dhe islame.

Bijtë e Kudsit do ti heqin mbi supe këto vuajtje dhe fatkeqësi. Përmendim faktin se muri ndan në mes fshatin Seuahara, i cili ka 25 000 banorë. Sipas planit çifut, 10 000 banorë të këtij fshati lihen në pjesën lindore të murit, ndërkohë që 15 000 të tjerë në perëndim të tij. Po ashtu, ky mur ndan fshatin Ebu Dijs dhe izolon lagjen Umu Zerazir dhe lagjen Khole Abd nga pjesa tjetër e fshatit. Ky mur i rrezikshëm ndan përgjysmë edhe periferinë e Al-Selamit në lindje të fshatit Anata dhe ndan fshatin BejtHanina në dy pjesë, duke ndaluar banorët e saj që të hyjnë e të dalin vetëm nëpërmjet portave dhe tuneleve dhe ndan prej saj 6000 dynymë prej tokave bujqësore. Në fshatin El-Habib muri rrethon dhe konfiskon 85% të tokave dhe atij fshati nuk i mbetet vetëm se 1770 dynymë truall, nga 9000 dynymë që ka realisht.[112]

Vendimi për dënimin e aktit të ndërtimit të murit ndarës në Këshillin e Sigurimit nuk pati sukses, pasi Shtetet e Bashkuara të Amerikës votuan në tetor të vitit 2003 me të drejtën e tërheqjes së vetos kundër vendimit që dënonte Izraelin për ndërtimin e murit ndarës. SH.B.A bëri thirrje për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Sigurimit kundër ndërtimit të murit.

Në 9 qershor të vitit 2004 Gjykata Ndërkombëtare e konsideroi ndërtimin e murit ndarës të paligjshëm dhe që binte ndesh me të drejtën ndërkombëtare. Ajo i kërkoi Izraelit që ta ndërpriste ndërtimin e tij dhe kërkoi që të kompensoheshin të gjithë palestinezët e dëmtuar nga projekti i murit ndarës. Gjithashtu kjo gjykatë përmendi se ky mur vështirëson të drejtën e palestinezëve për të përcaktuar të ardhmen e tyre. Po ashtu kolonitë hebreje të vendosura në territoret palestineze janë konsideruar se kanë shkelur parimet e së drejtës ndërkombëtare.

Sipas burimeve zyrtare izraelite, deri në fillim të muajit dhjetor 2005 ishin plotësuar 275 km nga ngritja e murit dhe 150 km të tjera ishin në proceset e para të ndërtimit. Ndërkohë që ishte planifikuar që puna për ndërtimin e 83 km të tjerë do të fillonte së shpejti. Janë edhe 250 km të tjera në fazën e përgatitjes së projektit në pritje të autorizimit “të

[112] Per me shume rreth problemeve te Kudsit nga muri, shih revistën "Studime Palestineze", nr 62, viti 2005 fq. 137-146.

ligjshëm" izraelit. Ndërsa është llogaritur se muri që rrethon Jeruzalemin do të përfundojë me fundvitin e 2005-ës deri në tremujorin e parë të vitit 2006.[113]

**Procesi i kompromisit dhe negociatat**

Supozohej se The Road Map (Harta e Rrugës) do të shkonte deri në fund e palestinezët dhe çifutët do të kishin gjetur gjuhën e përbashkët para se të përfundonte viti 2005. Mirëpo ja që viti 2005 shkoi para se të fillonte realisht zbatimi i Hartës së Rrugës. Para kësaj mendohej që të dyja palët të gjenin një zgjidhje përfundimtare gjatë pesë viteve që nga marrëveshja e Oslos, mirëpo të gjitha këto ishin zhgënjime dhe sollen shpërthimin e intifadës së Al-Akses në shtator të vitit 2000.

Izraelitët patën sukses që nga koha e nënshkrimit të marrëveshjes së Oslos, në shtator të vitit 1993 për të përforcuar thënien e Ishak Rabinit "Nuk ka marrëveshje të shenjta", e cila u bë moto e politikës çifute dhe një ndër mjetet për të ushtruar presion dhe për të gllabëruar sa më shumë territore.

Zionistët e kanë marrë shtruar këtë gjë, pasi kanë patur shumë gjëra në interes dhe në krah të tyre, ndërkohë që palestinezët nguteshin që të arrinin rezultate edhe përmes marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo bëri që izraelitët të vinin për palë palestineze disa kushte dhe tua impononin atyre.

Në të njëjtën kohë, zionistët filluan sulmet nëpërmjet kolonizimit. numri i të cilave sa vinte e rritej në Bregun Perëndimore në Jeruzalem për ti dhënë atij në atë pjesë një pamje çifute.

Kështu u shfaq dhe intifada e Al-Akses në 29 shtator 2000 për të shprehur dështimin e marrëveshjes së Oslos dhe për një irritim të paparë të palestinezëve. Problemi më i madh i marëveshjes së Oslos ishte se

[113] Raport 8/1/2005 nehttp://www.securityfence.mod.gov.il/Pages/ENG/news.html

ajo dështoi që në fillim. Ajo nuk zgjidhte çështje madhore që në parim, por u mor me disa procedura dhe detaje, për ti futur palestinezët në një provim, ku ata do të dëshmonin se do të silleshin mirë karshi pushtuesve të armatosur e të mos e hapnin gojën për ta nxjerrë këtë uzurpator nga tokat e pushtuara në vitin 1967, pasi këto bëheshin me disa vendime të dispozitave ndërkombëtare. Kështu çështja u la në dorë të "qëllimeve të mira çifute" dhe "sjelljes mirë" të palës palestineze.

Sërish Izraeli iu rikthye pushtimit të zonave të autoriteteve palestineze dhe shkatërroi infrastrukturën, e rrethoi Ebu Ammarin (Jaser Arafatin) në zyrën e tij për afro dy vjet e gjysmë, derisa ai vdiq në 9 nëntor 2004 në rrethana që lënë shumë pikëpyetje pas.

Sharoni, që fitoi në zgjedhjet për kryetar të qeverisë në 6 shkurt 2001, nuk mundi tu sigurojë dot izraelitëve paqen dhe nuk mudi ta ndale dot hovin e intifadës brenda 100 ditëve, ashtu siç kishte premtuar. Ai gjatë katër vjetëve nuk pati gjë tjetër, veçse dështime. Sharoni përfaqësonte krahun me ekstremist ndër krerët çifutë. Ai ka qenë prej atyre që i ka lyer më shumë se të tjerët duart me gjakun e palestinezëve dhe më kryesori prej atyre që kishin nxitur kolonizimin dhe konfiskimin e tokave, derisa arriti të quhej "Ebu-Al-Istijtan" (Babai i Kolonizimit).

Ai kishte qenë kundër marrëveshjes së Kamp-Dejvidit me Egjiptin dhe kundër marrëveshjes së Oslos me Organizatën për Çlirimin e Palestinës, ndërkohë që përkrahte marrëveshjen e paqes me Jordaninë.

Sharoni u përpoq ta kthejë pas rrotën dhe të siguronte një ambi- ent të dëshiruar për të. Ai disa herë kishte deklaruar se marrëveshja e Oslos kishte vdekur. Deri në vitin 2005 ai këmbëngulte se marrëveshja e Oslos "ishte gabimi më i madh që kishte bërë qeveria izraelite", sipas një interviste që ai ka pasur në revistën amerikane "Time" në maj të vitit 2005.[114]

Kur Sharoni erdhi në pushtet, programi i tij në esencë synonte sigurinë, ndërkohë që ai nuk la që të vetqeveriseshin veçse 40-45 % të Bregut Perëndimor. Ai refuzoi që të futej në bisedime për zgjidhjen e çështjes para se të ndalej intifada.

[114] Gazeta "Al-Kuds Al-Filistinije", 17 maj 2005.

Sharoni nuk i merrte parasaysh raportet e ndërkombëtarëve dhe nuk kishte dëshirë të bashkëpunonte me popullin palestinez. Përmes këtyre akteve moskokëçarëse ai bënte policin në shërbim të pushtimit, duke shkatërruar infrastrukturën dhe sigurinë.

Pala palestineze pa se me nënshkrimin e marrëveshjes së Oslos do të çelte dhe hapi i parë për themelimin e një shteti të pavarur palestinez në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës. Kjo bëri që autoriteti palestinez të detyrohej të marrë masa shtypëse kundër grupeve të rezistencës palestineze për ti ndaluar ato që të kryenin çdo lloj sulmi kundër izraelitëve.Autoriteti palestinez nuk mund të imponpremte politika të caktuara kundër zionistëve.

Pala amerikane gjithashtu nuk ishte e drejtë dhe neutrale. Një pjesë e madhe e palestinezëve nuk ishin të kënaqur me politikat e autoritetit palestinez dhe kjo gjë u theksua me korrupsionoin në radhët e autoritetit palestinez, gjë e cila uli ndjeshëm besimin e masës tek ky pushtet.

Gjatë dhjetë viteve pala izraelite nuk ka marrë iniciativën të plotësojë kufirin minimal të kërkesave të palës palestineze. Të gjitha rrymat politike izraelite bashkoheshin në pikën që të merrej vendimi për mosrikthimin e refugjatëve në Palestinën e pushtuar në vitin 1948 dhe se Jeruzalemi me pjesën lindore dhe perëndimore të tij do të ishte kryeqytet i përhershëm i Izraelt.

Negociatat maratonomake të Kamp-Dejvidit filluan të dështojnë që në qershor të vitit 2000 dhe e çuan procesin e kompromisit në një rrugë të bllokuar. Intifada e Al-Akses dhe popullartiteti i palëve të rezistencës ishin nga shfaqjet më të qarta për të shprehur dalldinë e popullit për ecurinë e procesit të kompromisit.

## Harta e Rrugës (The Road Map)

Ishte e qartë' se Izraeli pati sukses gjatë vitit 2005 në nxitjen projektit të Hartës së Rrugës dhe në tërheqjen e palëve lokale, rajonale e ndërkombëtare drejt planeve të tij për tërheqjen nga Rripi i Gazes.

Nuk ka patur mundësi tjetër për autoritetin palestinez për bashkëpunim. Për një kohë të gjatë Harta e Rrugës përfaqësohej si referencë e në emër të saj flisnin të gjitha palët e prej saj merrnin shkas të gjitha diskutimet politike dhe qëndrimet përkatëse. Në të njëjtën kohë. Harta e Rrugës ka shërbyer edhe si mjet presioni kundër palestinezëve.

Në 24 qershor 2002 presidenti amerikan Xhorxh Bush bëri një deklaratë për vizionin e tij për paqen në Lindjen e Mesme, vizion i cili bazohej mbi projektin e Hartës së Rrugës. Ky projekt u pranua dhe u njoh si projekti i të katërve, ku në të përfshiheshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Rusia dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara. Ai projekt u publikua zyrtarisht më 30 prill 2003.

Harta e Rrugës ftonte për përfundimin e konfliktit arabo-izraelit dhe për arritjen e një kompromisi përfundimtar, sipas një periudhe kohore që do të përfundonte në vitin 2005, mbi bazën e themelimit të shtetit palestinez sipas vendimeve të Këshillit të Sigurimit 242, 338 dhe 1397 me marrjen parasysh të iniciativës saudite, të cilën e kishte pranuar samiti i krerëve shtetërorë arabë që u mbajt në Bejrut në mars të vitit 2002. Realizimi i kësaj nisme ndahej në tre etapa dhe mbështetej mbi bazën e kryerjes së procedurave që do të bindnin të dyja palët, palestinezët dhe izraelitët.

Dolën dhjetëra vendime dhe projekte që lidhen me çështjen palestineze, por Harta e Rrugës sërish nuk jepte zgjidhje të qartë për çështje thelbësore siç ishin (Kudsi, refugjatët, kolonite, kufijtë dhe drejtimi i shtetit). Po ashtu, nuk u gjet asnjë mekanizëm i vërtetë që të detyronte palën pushtuese izraelite të zbatonte detyrat e saj.

E thënë ndryshe, Harta e Rrugës i jepte pushtimit një mundësi evazive për dredhi. Nga një këndvështrim tjetër Harta e Rrugës u mor me garancinë e sigurisë së uzurpuesve, në vend që të garantonte siguri për viktimat e tyre.

Më 25 maj 2003 qeveria izraelite e pranoi parimisht Hartën e Rrugës duke vendosur 14 vërejtje.

Amerikanët shfaqën mirëkuptimin e plotë dhe seriozitetin që tregonin vërejtjet dhe rezervat izraelite. Ndër këto rezerva ishte fakti që palestinezët duhet ti jepnin fund intifadës për të rikthyer aparaturat

e saj të sigurimit që do të bënin përpjekje serioze për ndalimin e "dhunës" dhe si periudhë e parë apo si kusht për nisjen e periudhës së dytë palestinezët duhet të shpërbenin organizatat "terroriste" (Hamasi, Xhihadi Islamik, brigadat Al-Aksa etj), të shkatërronin strukturën e tyre, të mblidhnin armet e paligjshme dhe të ndalonin çdo lloj thirrje që nxiste për konflikt.

Shihet qartë se vetëm kjo ka qenë vërejtja e parë dhe vetëm kjo do të mjaftonte që të anullohej Harta e Rrugës për vite të tëra, ndërkohë që ata që do të jepnin "dëshminë e suksesit" per palen palestineze do të ishin vete izraelitët. Përsa i përket vërejtjeve të tjera, ato kushtëzonin një autoritet të ri palestinez dhe kjo e hedh poshtë praktikisht vlerën kohore të Hartës së Rrugës dhe e nxjerr si të parealizueshme mundësinë e zgjidhjes përfundimtare të problmeve deri në vitin 2005. Kështu mënjanohej dhe nisma saudito-arabe e po ashtu edhe vendimi i Këshillit të Sigurimit 1397. pasi zionistët kishin vënë kusht që palestinezët të njihnin Izraelin si shtet dhe të hiqnin dorë nga kërkesa për kthimin e territoreve të vitit 1948.

Autoritetet palestineze ndërmorën disa reforma. Ata unifikuan aparaturat e sigurimit në tre të tilla. Nxorën vendim të ri për postin e kryetari të këshillit të ministrave, post të cilin e mbajti Mahmud Abasi fillimisht e pas tij Ahmed Kureij. Pas vdekjes se Jaser Arafatit, palestinezët zgjodhën si president në Bregun Perëndimor Mahmud Abasin më 9 janar 2005. Pas kësaj periudhe u bënë shumë ndryshime në qeveri dhe në mënyrë të veçantë në sektorë të finances dhe ekonomisë për të garantuar më tepër transparencë. Autoritetet palestineze arritën të bindnin grupet palestineze që të deklaronin armepushimin dhe të ftonin për qetësim të situatës. Kështu rrodhën ngjarjet e u zhvilluan zgjedhjet lokale, të cilat u bënë me raunde e po ashtu u punua për përgatitjet e zgjedhjeve parlamentare, të cilat u shtynë në 25 janar 2006.

Megjithate pala zioniste nuk u bind për hapat e ndërmarra nga autoritetet palestineze dhe mendonte se Harta e Rrugës ishte ende në fillimet e saj. Ajo këmbënguli që autoritetet palestineze të shpërbënin dhe të shkatërronin strukturat e Hamasit dhe lëvizjeve të tjera të

rezistencës para se ajo të fillonte me çdo hap pozitiv nga ana e saj. Kështu zionistët përdorën këtë argument dhe e përsërisnin pothuajse çdo ditë se Ebu Mazen (Mahmud Abasi) nuk po bënte aq sa duhej për të luftuar "terrorizmin". Në të njëjtën periudhë, gjatë vitit 2005, pala izracite vazhdoi të zgjeronte kolonitë e saj duke shkatërruar shtëpi, duke bërë vrasje politike e duke arrestuar njerëz, gjëra të cilat binin ndesh me fazën e parë të Hartës se Rrugës. Ebu Mazeni u kujdes për një reformë në aparatet e sigurimit, derisa vetë kordinatori amerikan për sigurinë në territoret palestineze Wiliam Word u shpreh se ishte i kënaqur për çka arriti autoriteti palestinez për përparimin në aspektin e sigurisë.[115]

E, megjithatë autoritetet izraelite vazhduan presionet e tyre. Sharoni përfitoi nga vizita e tij në Amerikë në mes të majit për të siguruar më tepër mbështetje nga ana amerikane në drejtim të politikës së tij.

Në 21 qershor 2005 u takuan Sharoni e Mahmud Abasi në Jeruzalem dhe u duk se takimi ndërmjet tyre ishte shumë i shpejtë dhe Abasi doli shumë i acaruar nga mbledhja. Megjithëse Sharoni e pranoi se ishte realizuar një përparim në fushen e sigurisë dhe stabilitetit, sërish ai tha se kjo ishte e pamjaftueshme. Disa burime izraelite botuan fjalën e Absait që i tha Sharonit: "Duhet që të punojmë së bashku. Çdo raketë që bie te ju, ajo sikur bie te unë. Unë dua që të bëj më tepër, por mundësitë e mia janë të kufizuara". Po ashtu citohet të ketë thënë: "Gjendja është e vështirë dhe Izraeli kerkon nga autoriteti palestinez shumë, në një kohë kur pjesa më e madhe sulmeve kundër Izraelit ndodhin në zona që janë nën dominimin e tij".[116]

## Tërheqja nga Rripi i Gazës dhe plani i ndarjes

Sharoni nuk mund ti kthehej planit të ndarjes, edhe nëse ai filloi në kohën e tij. Që nga pushtimi i Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. Gazeta "Al-Mustekbel", Bejrut 18 maj 2005.

[115] Gazeta "Al-Mustekbel", Bejrut 18 maj 2005.
[116] Gazeta "Al-Ajam Al-Filistinije", 22 qershor 2005 në artikullin e Hilmi Muses në Al-Safir me 22 qershor 2005.

diskutimet nuk kanë reshtur rreth kujdesit për imazhin çifut të shtetit zionist, sipërfaqet e territoreve që u duhen për kolonët, rreziqet demografike palestineze dhe se çfarë mund të lëshojë pala izraelite në rast se arrihet një kompromis përfundimtar. Këto tema janë bërë shumë të nxehta, sidomos pasi zionistët e kane paguar shtrenjtë nga sulmet e rezistences, shumë prej të cilave kanë ndodhur në territoret e pushtuara në vitin 1948.

Teoria e ndarjes u be e njohur në vitin 1995 pas sulmit palestinez në Bejt Lijd në 22 janar 1995, pas të cilit kryetari i këshillit të ministarve Rabin urdhëroi për formimin e një komisioni sigurie që do të studionte planin e ndarjes ndërmjet palestinezëve dhe izraelitëve. Me këtë përgjegjësi u ngarkua ministri i policisë Moshi Shahal. Në tetor të vitit 2000, pas shpërthimit të intifadës së Al-Aksës, Shaul Arijli dhe Moni Kristal paraqitën planin e ndarjes, pasi ishin konsultuar me pjesën më të madhe të institucioneve përgjegjëse. Atëherë kryeministri Barak e mbajti këtë plan si alternativë të mundshme, nëse bisedimet me palën palestineze do të dështonin.

Mirëpo Sharoni nuk e përkrahte këtë mendim, pasi ai do të çonte në një detyrim faktik të tijin për të hequr dore nga një pjesë që ai e quan "toka e Izraelit", për më tepër që ai plan kishte dalë nga Partia Laburiste. Mirëpo rritja e fuqise se intifades e detyroi atë që ta merrte seriozisht këtë punë, sidomos pasi ministri i mbrojtjes Benjamin Bin Aljazar dhe ministri i sigurisë Auzi Lindao përgatitën një plan të ri për ndarjen dhe ia paraqitën Sharonit me 6 qershor 2001. Më pas kjo ide do të behej objekt i diskutimeve të gjata në polemikat zioniste që nga shtatori vititi 2001.[117]

Në 18 dhjetor 2003 Sharoni deklaroi pranimin e idesë së ndarjes dhe në shkurt të vitit 2004 ai paraqiti planin e tij për ndarjen, nëpërmjet të cilit parashikohej që të ruheshin 6 koloni hebreje në Bregun Perëndimor, duke shtuar këtu dhe ato që ndodheshin në Jeruzalemin lindor. Ky plan gjeti përkrahjen zyrtare të palës amerikane, e cila u bë e ditur dhe u deklarua në një konferencë shtypi të përbashkët që pati Bush dhe Sharon,

[117] Gazeta "Sharq Al-Awsat", 9 qershor 2001 dhe nr 121 revistes "Roya". Per metepër shih: http://www.sis.gov.ps/arabic/roya/12/page6.html

të mbajtur në Uashington në datën 14 prrill 2004. Në kundërshtim me qëndrimin zyrtar amerikan të njohur lidhur me kolonitë dhe në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar, Bushi përshpejtoi rezultatet e negociatave përfundimtare dhe deklaroi angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për sigurinë e shtetit izraelit dhe se Izraeli ka të drejtë të kujdeset për kolonitë e tij në Bregun Perëndimor dhe se "në dritën e realiteteve të reja mbi territoret duke përfshirë këtu edhe grupet kryesore të kolonive nuk mund të ndodhë që të parashikohet që të përfundojnë negociatat për vendosjen përfundimtare për një kthim të plotë deri në kufirin e armë pushimit të vitit 1949".

Sipas planit të ndarjes duhet të tërhiqeshin nga Rripi i Gazës kolonitë hebreje e po ashtu edhe katër koloni të tjera nga Bregu Perëndimor, të cilat ishin autorizuar nga ana e qeverisë izraelite më 20 shkurt të vitit 2005. Në të njëjtën kohë, praktikisht sipas atij plani, synohej që Gaza të shndërrohej në një burg të madh, pasi Izraeli ishte zotuar se do të ruante dhe do të vëzhgonte kufijtë e jashtëm të Rripit të Gazës dhe do të kishte nën kontroll hapësirën ajrore dhe do të vazhdonte me aktivitete për sigurinë në brigjet e Rripit të Gazës.[118]

Kjo gjë do ta linte Rripin e Gazës zonë nën pushtimin zionist sipas ligjit ndërkombëtar. Një argumnet që përdorej për pranimin e planit te ndarjes ishte se nuk mund të gjendej pala palestineze e gatshme për të negociuar. Mirëpo kuptimi i vërtetë i asaj çka përmbante pretendimi i tyre ishte se Izraeli donte të imponoște planin e tij të veçantë për kompromisin dhe, përderisa nuk gjendej asnjë palestinez që ta pranonte atë plan, nuk ekzistonte palë që të negociohej me të. Edhe nëse do të ishte gjetur një palë për negociata, çdo gjë do të shkonte sipas standarteve të vendosura nga çifutët, pasi siç e shihte Sharoni këtë çështje: "Marrëveshjet që nënshkruajnë krerët arabë nuk vlejnë as sa çmimi i letrës ku ata shkruajnë".[119]

Autoritetet palestineze u përpoqën që ta konsiderojnë tërheqjen

[118] http://www.disengagement pngo.ps/BG.php
[119] Al-Quds Al-Arabi", 25 maj 2005. Burimi i informacionit është marrë nga Agjencia Franceze e Lajmeve.

zioniste pjesë të procesit të negociatave, por një gjë e tillë u refuzua nga pala izraelite dhe u mjaftua me kërkesat e saj për tu përpjekur që të vërë qetësinë dhe ndalimin e shfaqjes së tërheqjes, sikur kjo të bëhej nga frika e sulmeve të rezistencës.

Ministri palestinez Saib Arijkat është shprehur me detaje mbi gjendjen e pushtetit dhe ka thënë: "Ne nuk e dimë se çdo të ndodhë pas zbatimit të planit të ndarjes. Askush nuk u përgjigjet pytjeve tona. Ata kërkojnë nga ne bashkëpunim që të ndahemi, ndërkohë që ne nuk e dimë se si do të shkojë puna. Jemi lodhur nga marrëveshjet e shumta. Gjatë viteve të intifadës çdo gjë u shkatërrua. Ju (çifutët) na lidhni duart dhe na hidhni në det; nëse ne nuk dimë të notojmë, nuk konsiderohemi partnerë për ju, e nëse dimë të notojmë, sërish ne nuk jemi partnerë të mirë. Ka ardhur koha të na thoni se çfarë kërkoni prej nesh".[120]

Autoriteti palestinez nuk kishte asnjë lloj fuqie për të ushtruar presion mbi palën izraelite dhe nuk u ngushëllua as nga reformat që ndërmori dhe as nga vizita e Ebu Mazenit në maj të vitit 2005 më Uashington, pasi ai u kthye i zhgënjyer dhe deklaroi se amerikanët pranuan nismën e Sharonit për tu tërhequr nga Rripi i Gazës dhe se ata kishin rënë dakord që kolonitë e mëdha hebreje të qëndronin si ishin dhe se refugjatët palestinezë nuk duhet të ktheheshin".[121]

Intifada e Al-Akses pati rolin kryesor që bëri të tërhiqeshin izraelitët nga Rripi i Gazës, pasi e kishin shndërruar në një pengesë të madhe të sigurisë dhe ekonomisë.[122]

Mbrojtja e 8 mijë kolonëve hebrejë ka qenë një proces i vështirë dhe i lodhshëm e ka kërkuar që të shpërndajë mijëra ushtarë për të mbrojtur kolonitë nga 400 000 palestinezë.

Qeveria izraelite nëpërmjet tërheqjes kërkonte të kishte interesa të mëdha politike dhe materiale. Përmes kësaj ajo do ti jepte fund barrës demografike të banorëve që përfaqësonte Rripi i Gazës, të cilin nuk

[120] Al-Quds Al-Arabi", 13 prill 2005.
[121] Raporti Shakir Al-Xheuheri "Al-Shark Al-Kutrije", 6 qershor 2005.
[122] Sharoni e ka pranuar këtë në një interviste me gazeten izraelite "Lidjaut Ahronuf" në 12 gusht 2005.

mund ta bënte pjesë të asnjë projekti që kishte për qëllim ruajtjen e identitetit zionist të shtetit. Për më tepër ajo donte që të lehtësonte barrën financiare dhe atë të sigurisë dhe rikthimin e përhapjes së ushtrisë izraelite, gjë e cila do ti siguronte fundin e fërkimeve dhe mosmarrëveshjeve me banorët e Gazës dhe uljen e mundësisë së ndonjë sulmi nga ana e tyre. Ajo kishte për qëllim rrëzimin e rezistencës në Rripin e Gazës duke justifikuar sulmet ushtarake, të paktën në sytë e botës, dhe donte të gjente ndonjë situatë të favorshme për çdo sulm ushtarak apo vrasje politike, të cilat do të bëheshin si kundërpërgjigje e rezistencës palestineze. Qeveria izraelite filloi ti bëjë dredhi projektit të Hartës së Rrugës dhe u tërhoq në Bregun Perëndimor për të realizuar planet e saj për judaizimin e Jeruzalemit, ngritjen e murit ndarës, konfiskimin e tokave dhe lënien në vend të vendbanimeve hebreje për çdo kompromis politik të mëvonshëm.

Nga ana tjetër, qeveria izraelite u përpoq që të përmirësojë imazhin e saj dhe ta paraqesë veten në opinionin ndërkombëtar si një palë që e do paqen dhe heq dorë nga gjëra që janë për të "të dhimbshme", vetëm e vetëm për hir të paqes e stabilitetit në atë zonë. Ajo pati sukses që të rikthente një ngrohje të marrëdhënieve me Egjiptin, Jordaninë dhe disa vende të tjera arabe dhe të realizonte disa depërtime në botën islame e në mënyrë të veçantë në Pakistan.

Izraeli deklaroi fillimin e zbatimit të tërheqjes në qershor të vitit 2005, mirëpio më pas ai e shtyu këtë proces për në mes të gushtit. Zbatimi i tërheqjes filloi me një fushatë mediatike që synonte të frynte "bamirësinë" e Izraelit dhe aspektet e "dhimbjeve dhe vuajtjeve", që prekën kolonët hebrenj, që në sytë e atij që i sheh këto situata nuk mund ta imagjinojë mundësinë e një tërheqjeje tjetër të çifutëve nga kolonitë e tyre. Doli se vetë qeveria izraelite financonte fushatat mediatike dhe protestuese të kolonëve hebrej.[123]

[123] Shih gazetën "Kulu Al-Arab", 29 qershor 2005 dhe "Al-Khaleej", Emiratet e Bashkuara Arabe, 30 qershor 2005. Shih dhe raportin e "Qendrës së Mbrojtjes së Demokracisë në Izrael" rreth mashtrimit që bëri media izraelite gjatë tërheqjes. Pjesë të shkurtuara të këtij raporti i publikoi gazeta "Al-Safir" me 3 shkurt 2006.

Po ashtu çdo familje hebreje e shpërngulur u kompensua me 250 000 dollarë e ajo ishte një shumë që mund të rritej deri në 400 mijë dollarë amerikanë.[124]

Në 11 shtator Izraeli përfundoi heqjen e kolonive hebreje dhe deklaroi fundin e pushtimit të Rripit të Gazës. Nxjerrja e çifutëve ishte shumë komode dhe nuk mund të krahasohet me shkatërrimin e shtëpive sipër kokave të palestinezëve dhe flakja e tyre në mes të katër rrugëve, e për më tepër as që mund të krahasohet me dëbimin dhe konfiskimin e pasurive të rreth 57 % të popullit palestinez në katastrofën e vititi 1948, ku e pësuan 800 mijë palestinezë nga 1 milion e 400 mijë që kishte në atë kohë.

Izraeli vazhdoi të kontrollonte kufijtë e Rripit të Gazës me Egjiptin, derisa u nënshkrua një marrëveshje me autoritetet palestineze në 15 nëntor 2005 me ndermjetësimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të udhëhequr nga sekretarja e shtetit për marrëdhëniet me jashtë Kondolina Rajs. Marrëveshja përmbante dhe praninë e mbikqyrjes evropiane në vendkalime dhe instalimin e kamerave vëzhguese që do të transmetonin direkt për palën izraelite çdo gjë që bëhej, me të drejtën e Izraelit për të kundërshtuar hyrjen apo daljen e atyre që ai i shihte si të dyshimtë, për aq kohë sa të vendosnin evropianët se çdo bëhej për gjashtë orë nga ndalimi i tyre.

Në 25 nëntor autoritetet palestineze po festonin përurimin e vendkalimit dhe fillimin e zbatimit të marrëveshjes. Ende pa u plotësuar entuziazmi palestinez, Izraeli e deklaroi një anë të Rripit të Gazës zonë sigurie, ku e ndalonte hyrjen e palestinezëve në të. Kjo bëhej me argumentin që të ndalohej gjuajtja me raketa nga ana e rezistencës kundër vendbanimeve hebreje.

[124] The Guardian, 17 gusht 2005.

## Ngritja e hamasit

HAMAS luajti një rol tepër të rëndësishëm në intifadën e Al- Aksës. Gjatë kësaj kohe u vranë një numër i konsiderueshëm i krerëve më të lartë të kësaj lëvizjeje si Shejh Ahmed Jasini, Abdul-Aziz Al- Rantisi, Salah Shehade, Xhemal Selim, Xhemal Mensur, Ismail Ebu Shamb etj. Megjithatë Hamasi vazhdoi me aktivitetet e tij sociale në përkujdesje të shtresave të varfëra të shoqërisë me përkrahjen e grave të veja, jetimëve e me një solidarizim të madh për situatën. Anëtarët e lëvizjes Hamas u shquan për besnikëri, pastërti dhe sakrificë dhe për të gjitha këto fituan një respekt të madh në popull.

Në të njëjtën kohë lëvizja Fatah po shfaqte dobësi në drejtimin e shtetit dhe administrata shtetërore nuk ishte më e besueshme, sidomos në aspektin financiar dhe atë të sigurisë. Ajo ishte një administratë e korruptuar.

Hamasi arriti të ketë suksese të mëdha në zgjedhjet lokale palestineze dhe ky ishte një sinjal frikësimi për autoritetin palestinez dhe çifutët, në rast se kjo lëvizje do të fitonte zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Mirëpo autoritetet palestineze tashmë nuk kishin fuqinë e duhur. Ato u përpoqën ta inkoporonin Hamasin në proceset politike. pasi nuk kishin fuqi ta ndalonin atë nga vazhdimësia e intifadës, mirëpo ata nuk e parashikonin kurrë që Hamasi do të fitonte me shumë se një të katërtën apo dhe një të tretën në zgjedhjet parlamentare.

Zionistët u përpoqën shumë herë që ta detyronin autoritetin palestinez që të mos e lejonte përfshirjen e Hamasit në zgjedhjet parlamentare. Ata kishin deklaruar se nuk do të bashkëpunonin me qeverinë palestineze të udhëhequr nga Hamasi apo edhe nëse kjo lëvizje do të ishte pjesë e kësaj qeverie. Për këtë ata filluan të bënin një fushatë ndërkombëtare për të gjetur përkrahje për qëndrimin e tyre. Disa drejtues amerikanë u solidarizuan me zionistët dhe dolën në krah të qëndrimit të tyre. Sharoni vuri si kusht për Hamasin që të dorëzonte armët me qëllim që të merrte pjesë në zgjedhje dhe bëri presion për ndërprejen e zbatimit të Hartës së Rrugës, nëse Hamasi do të merrte pjesë në zgjedhjet

parlamentare.[125]

Ndërsa zëvendëskryeministri, Shimon Peres, tha se Izraeli do të ndihmonte Mahmud Abasin, se në rast se do të fitonte në zgjedhje Hamasi, sipas tij, kjo do të ishte "fundi i procesit të paqes".[126]

Gjithashtu ministri izraelit i financave Netanjahu deklaroi se as Tel Avivi dhe as Uashingtoni nuk dëshironin që Hamasi të arrinte në pushtet, qoftë kjo edhe përmes zgjedhjeve parlamentare.[127]

Edhe drejtori i Shërbimeve Sekrete Izraelite, Diskin, u shpreh se fitorja e Hamasit do ta vinte Izraelin në një pozitë të vështirë dhe, nëse Hamasi do të merrte pjesë në qeveri dhe do të vazhdonte zbatimin e sulmeve, sipas tij, kjo "do të na vinte në një situatë të vështirë e tepër të komplikuar".[128]

Mirepo Ebu Mazeni (Mahmud Abasi) këmbënguli në qëndrimin e tij se Hamasi duhet të merrte pjesë në zgjedhje dhe e konsideroi këtë vendim si çështje të brendshme.

Duket se takimi i dytë i Mahmud Abasit me Bushin në 20 tetor 2005 i shërbeu këtij qëndrimi.

Përllogaritjet tregonin se përfshirja e Hamasit në procesin politik do ta dobësonte fuqinë e tij për të anuluar rrugën e kompromisit dhe do ta shndërronte këtë lëvizje në një forcë të zakonshme politike. Po ashtu, shumë tregues flisnin për një fitore të sigurt të lëvizjes Fatah në zgjedhje dhe ajo fitore do ti jepte të drejtën e përfaqësimit të popullit palestinez me të gjitha drejtimet e tij dhe se Hamasi do te mbetej një grup në opozitë.

Qëndrimet e zionistëve vazhduan me deklarata politike duke mos marrë qëndrime të prera për anullimin e procesit zgjedhor, megjithëse gjatë asaj periudhe ata bënë disa fushata për arrestimin dhe ndalimin e disa prej krerëve dhe mbështetësve të Hamasit për ta dobësuar atë si lëvizje.

---

[125] "Al-Khaleej", Emiratet e Bashkuara Arabe dhe "Al-Quds al-Arabi", 4 maj 2005.
[126] "Al-Hajat Al-Xhedijda". 19 prill 2005.
[127] "Al-Khaleej", Emiratet e Bashkuara Arabe, 19 prill 2005.
[128] Qendra Palestineze për Informim: 19 maj 2005.

Ndodhi që Hamasi të realizojë surprizën e madhe më 25 janar 2006, ku kandidatët e saj fituan në zgjedhjet e lira dhe të ndershme 74 vende në parlament dhe katër të tjera që ishin të pavarur e aleatë me të. Ndërsa Fatah fitoi vetëm 45 vende, ndërkohë që 9 vende të tjera u fituan nga forca të tjera politike.

Kështu populli palestinez ia dha votbesimin e tij Hamasit dhe lëvizja Fatah e la pushtetin, pasi kishte komanduar luftën palestineze për rreth 40 vjet me radhë.

Realisht Hamasi po përballon sfida të mëdha në drejtimin e shtetit dhe po e gjen veten në një konkurencë të vështirë politike, pasi lëvizja Fatah ende vazhdon të drejtojë pushtetin dhe Organizatën për Çlirimin e Palestinës. Jo vetëm kaq, por Hamasi është përballë një agresori që përpiqet ta shtypë e gjendet gjithashtu në situata kur vendet arabe nuk po i ofrojnë ndihmë dhe në një kohë kur bota e konsideron si organizatë terroriste. Megjithatë, Hamasi gëzon një mbështetje të fuqishme popullore në Palestinë, në botën arabe dhe në mbarë botën islame.

Kjo lëvizje ka politikanë të zgjuar që e drejtojnë, mbështetet në parime, është fleksible në diplomaci dhe bashkëvepron me situata të ndryshme. Deri tani kjo lëvizje shquhet për pastërti, disiplinë dhe solidaritet.

Sidoqoftë ditët në vijim do të dëshmojnë për aftësinë e kësaj lëvizjeje për të bashkëvepruar me realitetin e ri...

## VËZHGIME DHE VLERESIME

Ne fund të kësaj pjese përmbyllëse të këtij studimi do të ishte me vend që të paraqitej një vlerësim i çështjes palestineze duke përfshirë pikat e mëposhtme:

1. Toka palestineze është e shenjtë dhe është një tokë e bekuar. Banorët autoktonë të saj janë Kananët, të cilët kanë jetuar në këtë vend gjatë 4500 vjetëve të fundit dhe ata gradualisht janë asimiluar nga palestinezët së bashku me fiset e tjera arabe. Gjuha arabe u bë gjuha e tyre bazë dhe që nga momenti i çlirimit të Palestinës nga muslimanët, në vitin 636 e.r (viti 15 hixhrit) këto fise pranuan Islamin dhe me vullnetin e tyre qëndruan nën udhëheqjen e muslimanëve për një periudhë qëështe më e gjata në historinë e Palestines.

2- Muslimanët besojne se populli i Izraelit ka pasur nën udhëheqjen e tij pjesë të veçanta të Palestinës për një periudhë prej katër shekujsh, por, ndërkohë ata kanë trilluar fenë, i kanë vrarë dhe i kanë mohuar profetët e tyre. Për këtë arsye ata meritojnë dënimin dhe mallkimin e Zotit si dhe e drejta mbi Palestinën i takon automatikisht popullit monoteist musliman, palestinezëve, që kanë mbajtur lart flamurin e teuhidit dhe nuk e kanë braktisur kurrë atë tokë të shenjtë. Çifutët në të vërtetë kanë qenë të shkëputur nga toka e bekuar e Palestinës, si politikisht ashtu dhe nga ana e mënyrës së jetesës apo qytetërimit që i përkasin dhe kjo për rreth 1800 vjet me radhë (që nga viti 135 e.r deri në shekullin e 20-të.)

3- Shumë faktorë kanë qenë instrumentalë në urgjencën e lëvizjes zioniste që luftoi për krijimin e një vendqëndrimi për çifutët në Palestinë. Ndër këto është dhe mbështetja e fortë e Europës së krishterë, nevoja e ideologjisë së nacinalizmit, "problemi çifut" në Europën Lindore dhe rritja e ndikimit të çifutëve në qarqet qeveritare

dhe private të Europës dhe Shteteve të Bashkuara.

4- Rreziku zionisto-perëndimor kundër Islamit arriti kulmin në kohët e fundit, kur sfida e tyre u përmblodh në termin e një "shteti barrikade" në Palestinë, që është mbështetur në mënyrë aktive nga fuqitë imperialiste perëndimore, sidomos nga Britania. Kjo gjë kishte si qëllim të saj thelbësor copëtimin e botës muslimane, vendosjen e saj nën dominimin e Perëndimit si dhe shtypjen e çdo përpjekjeje për formimin e një superfuqie muslimane që të zëvendësonte kalifatin e mundur osman.

5- Projekti zionist u mendua, u mor në patronazh, u mbështet dhe u mbrojt nga fuqitë me të mëdha perëndimore dhe e para ndër to është Britania, e cila e pushtoi Palestinën gjatë viteve 1918-1948. Më pas, që nga viti 1948, këtë gjë e bëri Amerika, e cila deri më sot vazhdon të ndihmojë bashkësinë zioniste si nga ana politike, ashtu dhe nga ajo ushtarake dhe ekonomike, duke i dhënë projektit zionist një legjitimitet ndërkombëtar.

6- Muslimanët nuk i luftojnë çifutët për faktin e thjeshtë se ata janë çifutë. Historikisht marrëdhëniet e muslimanëve me ithtarët e librit Ahl al-Kitab dhe me Ahl al-Dhimmah kanë qenë ekskluzivisht të bazuara në drejtësi dhe dashamirësi. Ata kanë pasur liri të plotë si dhe të drejta fetare dhe civile, në kohën që kanë qenë nën sundimin islam. Në të vërtetë "Problemi çifut" dhe anti-semitizmi filloi dhe mori hov në Europë. Bota muslimane, e cila nuk ka të bëjë fare me këto paragjykime, u kishte siguruar çifutëve një parajsë të sigurt nga fanatizmi fetar europian dhe ultra-nacionalizmi. Muslimanët i luftojnë zionistët vetëm për faktin e thjeshtë se ata kanë pushtuar tokën palestineze, i kanë dëbuar banorët e saj vendas dhe kanë shkelur vendet e tyre të shenjta. Pa dyshim që muslimanët kanë një të drejtë normale dhe legjitime që të luftojnë çdo grup që guxon të pushtojë tokën e tyre, pavarësisht kombësisë apo fesë që mund të ketë.

7- Fakti që shtetet muslimane arabe ishin të dobëta dhe të përçara, të ndarë në 55 shtete të pavarura por të pafuqishme, e kjo kishte filluar që në gjysmën e parë të shekullit XX, e lehtësoi shumë krijimin e shtetit zionist. Përveç kësaj, ideologjitë laike që u ngulitën në popullsinë e këtyre vendeve bënë që të krijohej një boshllëk midis këtyre vendeve dhe bashkimit të umetit kundër rrezikut zionist që po kërcënonte ekzistencën e tyre. Për më tepër, këto regjime janë në konflikt dhe me vetë popujt e tyre, për shkak të shtypjes së madhe dhe korrupsionit në shkallë të gjerë.

8- I ashtuquajturi rendi botëror që prezantohet nga Lidhja e Kombeve apo ndryshe Kombet e Bashkuara është vetëm një vegël për të zbatuar axhendat e tyre dhe për të legjitimuar hegjemoninë e tyre ndërkombëtare. Krijimi i bashkësisë zioniste dhe konsolidimi i nguljes së saj në Palestinë ka qenë një vegël e vlefshme për zbatimin e këtij programi, për hatër të të cilit fuqitë imperialiste kanë injoruar ose kanë lënë mënjanë të gjitha rezolutat propalestineze që ka nxjerrë komuniteti ndërkombëtar.

9. Në të vërtetë bashkësia çifuto-zioniste është një rrezik i madh për të gjithë botën muslimane. Në fillim të shekullit XXI Izraeli i ka ngulur thonjtë mbi Palestinën me një bashkësi prej 5 milionë çifutësh dhe me një fuqi ushtarake jashtëzakonisht të madhe, ku përfshihen 200 bomba atomike me të cilat është në gjendje të mundë së bashku të gjitha vendet arabe dhe të bombardojë kryeqytetet më të mëdha të botës muslimane. Zionistët përpiqen që ta mbajnë botën arabe në një rrëmujë të tillë gjë që është garancia më e mirë për mbijetesën dhe vazhdimësinë e komunitetit të tyre. Mbështetja logjistike dhe politike që zionistët po i japin kryengritjeve në Sudan, shkatërrimin që ata i bënë reaktorit bërthamor të Irakut në korrik të vitit 1981 si dhe përpjekjet e tyre të dështuara ndaj kundërshtarit të tij Pakistanit, si dhe roli korruptiv që pati Shërbimi Sekret Izraelit në Egjipt, Jordani dhe Liban janë vetëm disa nga treguesit e rrezikut që mbart lëvizja imperialiste-zioniste.

10- Populli palestinez i ka bërë një rezistencë të fortë dhe të guximshme pushtimit britanik si dhe projektit zionist (1917-1948), veçanërisht gjatë revolucionit të madh të viteve 1936-1939. Por, është fakt se populli palestinez ka qenë i vetëm në fushën e betejës dhe rrjedhimisht ai ka qenë i dobët përballë konspiracioneve ndërkombëtare dhe dhe nuk ka mundur ti kapërcejë dot forcat e fuqive të mëdha.

11- Nëpërmjet sakrificave dhe vështirësive të mëdha, rezistenca e sotme palestineze me O.C.P-në dhe organizata të tjera u përfshinë në një luftë frytdhënëse që çoi në ruajtjen e identitetit palestinez dhe arriti të fitojë respektin dhe nderimin e botës. Megjithatë, revolucioni palestinez vuan nga disa të meta serioze që vënë në rrezik aftësinë e saj dhe mundësitë për të arritur objektivat e deklaruara. Në mesin e këtyre të metave të kësaj lëvizjeje përmendim:

I. **Problemi ideologjik**. Ideologjia miope laike dhe orientimet e rezistencës, që shpërthyen në mes patriotizmit, nacionalizmit dhe radikalizmit, çuan në kufizimin dhe ndonjëherë dhe në mungesën totale të pikëpamjeve islame që është nja nga faktorët e vetëm për bashkimin e umetit musliman dhe për të fituar kështu mbështetjen popullore kundër zionistëve dhe aleatëve të tyre. Organizata për Çlirimin e Palestinës, që ka një pozitë dominuese laike, arriti që të hyjë në kompromise në kurriz të parimeve të palestinezëve dhe në kundërshtim me kërkesat politike bazë, që filluan së zvogëloheshin nga dëbimi i pushtuesve dhe çlirimi total i vendit, deri në krijimin e një shteti laik-demokratik për të dy palët si arabët ashtu dhe çifutët, duke vazhduar me njohjen e së "drejtës" së çifutëve për të marrë në zotërim 77% të tokës palestineze dhe si përfundim pranimin e një vetëqeverisjeje të vetshpallur në Rripin e Gazës dhe në Bregun Perëndimor.

II. P**engesat që kanë të bëjnë me udhëheqjen**.
Udhëheqja palestineze është e paralizuar nga natyra e saj heterogjene, nga kondradiktat lidhur me qëllimet dhe objektivat si dhe përkulja përballë disa vendeve arabe dhe ndërkombëtare,

të cilët insistojnë në kufizimin e disa të drejtave bazë të palestinezëve. Në vend që të ishte transparente, kolektive dhe institucionale, udhëheqja ishte përqendruar në duart e një individi të vetëm "al-za im" Arafat, fjala e të cilit ishte e fundit për çdo çështje, qoftë politike apo financiare. Kjo gjë çoi në krijimin e një neopotizmi, si dhe në shpërbërjen e brendshme të revolucionit palestinez, në dezertimin brenda radhëve të tij ose në eleminimin e shumë udhëheqësve të tjerë të zotë.

III . **Problemi i institucioneve.**
Despotizmi i kreut të udhëheqjes i ka dobësuar institucionet në një pikë të tillë, saqë trupi që supozohet se ka nje rol mbikqyrës, pra Asambleja Kombëtare Paistineze, nuk është gjë tjetër, veçse një lodër në duart e një njeriu që qëndron në krye. Institucionet e tjera të rëndësishme ose janë dobësuar në një masë të konsiderueshme ose kanë pushuar së funksionuari dhe janë zhdukur si p.sh Thesari Kombëtar, Qendra Kërkimore, organizatat për mirëqënien e familjeve të dëshmorëve dhe Departamenti i Planifikimeve. Pushteti është përqendruar në një klikë njerëzish që kanë marrë mbi vete të drejtën për të vendosur për çdo çështje të rëndësishme që ka të bëjë me botën muslimane në kohët e sotme.

IV. Revolucioni palestinez ka vuajtur më së shumti nga konfliktet e përgjakshme me disa regjime që janë përpjekur për "ta zbutur" dhe për ta disiplinuar atë apo për të folur në emër të tij. Ky fakt e ka dobësuar revolucionin, ia ka shteruar energjitë dhe e ka penguar atë nga marrja e iniciativave të sulmeve komando përgjatë kufijve, duke ia hequr kështu mundësinë për të qenë një forcë "politike e mundshsme".

12- Roli i rrymës islame në rezistencën kundër zionistëve, projektit të tyre dhe në të njëjtën kohë kundër padronëve të tyre, fuqive imperialiste, nuk duhet të lihet pa u vlerësuar. Kështu revoltat palestineze të viteve 1920-1939, të cilat patën një zgjerim të madh, u motivuan nga lëvizjet islamike dhe u modeluan sipas grupeve të

xhihadit, ndërsa levizja Xhihadijah e Shejh Al-Kasamit së bashku me lëvizjen Al-Xhihad al-Mukaddas e Abdul-Kadir Al-Huseinit, kanë organizuar rezistencën popullore gjatë viteve 1936-1939 të Revoltës së Madhe dhe luftës së viteve 1947-1948. Grupi Al-Ikhwan Al-Muslimun (Vëllezërit Muslimanë) ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në luftën e viteve 1947-1948 dhe vetë lëvizja Fatah është krijuar si rezultat i ideve të disa prej pjesëtarëve të grupit Al- Ikhwan, ndonëse më vonë ajo kaloi në laicitet dhe nacionalizëm. Për më tepër, anëtarët e lëvizjes "Vëllezërit Muslimanë" kanë marrë pjesë aktive në Kampet e Shujukut dhe themeluan Hamasin që përbën bërthamën e rezistencës së armatosur që vepron sot dhe që refuzon kategorikisht të dorëzojë ndonje pjese te tokes palestineze dhe insiston në vazhdimin e luftës deri në çlirimin e plotë të Palestinës.

13- Lëvizja islame ende nuk ka arritur të kapë udhëheqjen politike të revolucionit palestinez, megjithëse ajo është e papërkulur në vizionin dhe misionin e saj për xhihadin. Ajo është subjket i përpjekjeve intensive dhe të vazhdueshme të faktorit palestinezo-arab për ta zhdukur dhe për tia prishur imazhin që ka. Megjithatë, ajo vazhdon të jetë ndërgjegjja e umetit musliman dhe shpresa e tij e ardhshme në dashtë Zoti. Vlen të përmendet se udhëheqja e lëvizjes islame po përballet me sfidat e mëposhtme:

Përcaktimi saktë i strategjive të saj afatgjata dhe afatshkurtra për të pëballuar sfidën zioniste dhe për të çliruar Palestinën.

- Të arrijë të gjejë mënyrat dhe mjetet për të zgjeruar rrezen e luftës që nga vendi i kufizuar i momentit, statusi rajonal dhe kombëtar në një interesim më të gjerë dhe tërësisht musliman.
- Të nxisë organizimin e vet institucional si dhe ti hapë radhët e saj për futjen e rekrutëve të rinj dhe tia lërë në dorë lëvizjen dhe udhëheqjen e saj brezit të ri në një mënyrë graduale dhe sistematike.

- Kontakti i vazhdueshëm me njerëzit duhet të jetë një detyre primare për këse lëvizje, në mënyrë që xhihadi kundër zionistëve të kthehet në një çështje të ditës.

- Një sfidë tjetër për këtë lëvizje është mbajtja ndezur e zjarrit të xhihadit, pavarësisht vështirësive dhe pengesave që duhen kaluar apo dhe sakrificave që dalin gjatë rrugës. Një frymëzim për këtë mund të jetë rezistenca 22 vjeçare islame në pjesën jugore të Libanit që ndezi muxhahidinët për të vazhduar përpjekjet për dëbimin pa kushte të zionistëve.

Muslimanët duhet të jenë të sigurt se, megjithëse mund të kërkojë një kohë të gjate, projekti zionist do të çrrënjoset njëherë e mirë, duke pasur parasysh dhe premtimin e Allahut, që jepet në ajetet e para të sures Isra, kuptimi i të cilave është: "**E, kur erdhi premtimi i ngatërresës së dytë, Ne i dërguam (armiqtë tuaj) për t'ju nxirë fytyrat tuaja, dhe që të hyjnë ata në tempull, sikundër patën hyrë herën e parë dhe të shkatërrojnë plotësisht çdo gjë që pushtonin"**. (Al-Isra, ajeti 7).

Profeti ynë, Muhamedi (a.s.), e ka përsëritur këtë lajm të mirë në një hadith të vërtetë, të transmetuar nga Muslimi dhe Ahmedi përmes Ebu Hurejres (r.a.), në të cilin thuhet: "Nuk do të bëhet kijameti, derisa muslimanët ti luftojnë çifutët dhe ti vrasin ata. Çifutët do të fshihen pas pemëve dhe gurëve, por gurët dhe pemët do të flasin dhe do të thonë: "O musliman! Hajde se pas meje është fshehur një çifut, hajde dhe vrite! Përveç pemës me emrin garkat, e cila është pema e çifutëve."

**DESHMI DHE THENIE**

- "Hapësira! Nga Nili deri në Eufrat ne kemi nevojë për një periudhë tranzitore nën juridiksionin tonë dhe për një sundimtar çifut që të udhëheqë gjatë kësaj periudhe.... Në momentin kur përqindja e popullsisë do të jetë çifute në dy të tretat e saj, ajo automatikisht do të kalojë nën dominimin politik çifut".

*Theodore Herzl, themeluesi dhe kryetari i Organizatës Botërore Zioniste, fjalë e cituar në Asad Zarruk: Israel al-Kubra, (Izraeli i Madh), fq. 87-89.*

- "Ne do të kërkojmë atë që na nevojitet. Sa më shumë emigrantë të kemi, aq më shumë sipërfaqe toke na duhet."

*Ditaret e Herzlit, Vol.2, fq.720.*

- Në Palestinë ne nuk propozojmë as ndjekjen e formës së konsultimit të dëshirave që mund të kenë banorët e sotëm të vendit. Katër fuqitë e mëdha janë të bindura për zionizmin dhe, qoftë ai i gabuar ose jo, i mirë apo i keq, është rrënjosur në një epokë të gjatë traditash, është rrënjosur në nevojat e sotme dhe në shpresat e së ardhmes së njerëzve shumë herë më të rëndësishëm se paragjykimet e 700 000 arabëve, që tani popullojnë atë vend të lashtë. Për mendimin tim kjo është një gjë e drejtë. Unë nuk mendoj se zionizmi do ti dëmtojë arabët. Pavarësisht çdo lloj respekti që i duhet treguar atyre që jetojnë në ato vende, fuqitë që ata kanë zgjedhur me mandatin e tyre nuk propozojnë konsultimin me ta. Shkurtimisht, për sa i përket Palestinës, fuqitë nuk kanë deklaruar fakte të cilat nuk kanë qenë pa asnjë dyshim të pasakta dhe nuk kanë lëshuar deklaratë politike që, të paktën në letër, nuk janë përpjekur ta shkelin.".

*Memorandumi i Belforit për Lord Curzon, 11 gusht 1919 PRO. FO. 371/4183.*

- Yosef Weitz, drejtori i Departamentit për Tokën i Fondit

Kombetar Çifut ka shkruar në ditarin e tij e pikërisht në hyrjen e datës 20 dhjetor 1940: "Në mesin tonë duhet të jetë e qartë se nuk ka vend për të dy popujt në këtë vend. Pasi të trasferohen arabët, vendi do të jetë i hapur dhe i gjerë për ne dhe, nëse arabët do të qëndrojnë në këtë shtet, ne do të jemi ngushtë dhe nuk do të kemi hapësira të mjaftueshme... Zgjidhja e vetme është Toka e Izraelit ose të paktën Toka Lindore e Izraelit (Palestina) pa arabët. Nuk ka hapësira kompromisi në këtë pikë. Mënyra e vetme është që ti transferojmë arabët në vendet fqinje, të gjithë ata, dhe mbase mund të bëjmë përjashtim Betlehemin, Nazaretin dhe Jeruzalemin e Vjetër. Nuk duhet të anashkalohet as edhe një fshat apo fis i vetëm. Dhe vetëm atëherë ky vend do të jetë në gjendje të presë miliona izraelitë dhe në këtë mënyrë mund të zgjidhet problemi izraelit. Nuk ka asnjë zgjidhje tjetër."

*Dhe në 20 mars të vitit 1941 ai ka shkruar:*

"Zionizmi është zgjidhja për problemin izraelit në Tokën e Izraelit, vetëm në Tokën e Izraelit por jo që arabët të mbeten shumica atje. Shpërngulja e plotë nga vendi i banorëve të saj dhe dorëzimi i këtij vendi në duart e izraelitëve është e vetmja zgjidhje për çështjen."

*Ditari i Weitz, A246/7, fq. 1090-91 & fq.1127, Arkivat Qendrorë Zioniste (CA), siç citohet në Nur Masalha, Dëbimi i palestinezëve (U.S.A.: Instituti i Studimeve Palestineze).*

- Në një takim sekret me ambasadorin rus në Londër, në shkurt të vitit 1941, Chaim Weizmann, kryetari i Organizatës Botërore Zioniste (1921-1933 dhe 1935-1946) si dhe kryetari i parë i bashkësisë çifute dha mendimin për dëbimin e një milion palestinezëve nga tokat e tyre, në mënyrë që të silleshin nga Europa Lindore një numër çifutësh që do të arrinte në 4-5 milionë. Raporti sekret i ambasadorit për këtë intervistë private u mbyll në arkivat e Ministrisë se Jashtme Ruse deri në momentin kur u zbulua në maj të vitit 1993 nga gazeta çifute, Yadiut Ahrunut dhe kjo e fundit u citua dhe nga gazetat al-Quds and al-Rai në 29 maj 1993.
- "Kjo është një kohë e artë për disa çifuto-amerikanë të

respektueshëm dhe të spikatur, sidomos për ata nga të cilët unë arrita të mësoj shumë, që të thoja me guxim dhe publikisht: "Mjaft e gënjyem botën dhe veten tonë. Ne e vodhëm Palestinën. Ne e vodhëm atë. Edhe në rast se ne u japim palestinezëve autonomi apo të drejtën për të vetvendosur, apo në rast se u japim Bregun Perëndimor ose një shtet palestinez, ne akoma do ti kemi vjedhur atyre pjesën më të madhe të vendit të tyre. Le të fillojmë të paktën të themi të vërtetën."

*Shkrimtari Ron David, cituar në librin etij / A * rab & Israel for Beginners, "Arabet dhe Izraeli për fillestarët", New York, 1993, fq.210*

• “Kërkesa e zionistëve për krijimin e një shteti izraelit ishte në kundërshtim të plotë me të gjitha parimet e historisë moderne dhe ligjiet ndërkombëtare... Izraeli nuk ka një të ardhme të gjatë, pa arritur në një marrëveshje me arabët.

Në vitin 1956 Ben Gurioni ka thënë "Shteti çifut do të mbijetojë dhe për dhjetë apo pesëdhjetë vitet e ardhshme, por mundësia e mbijetesës së tij të mëtejshme është një mundësi 50%."

*Nahum Goldman, Presidenti i Kongresit Botëror Izraelit dhe president i Organizatës Botërore Zioniste (1956-1968) është shprehur kështu në artikullin e tij "Psikologjia e Paqes së Lindjes së Mesme." Publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, tetor 1975 fq.98. fq.114.*

• "Cifutët dhe miqtë e tyre duhet ta dinë se rivitalizimi i Islamit dhe rizgjimi i tij janë një rrezik real për Izraelin. Ata që e duan Izraelin duhet të bëjnë çështë e mundur për të zhdukur shpirtin islam ose në të kundërt jo vetëm Izraeli, por i gjithë civilizimi perëndimor do të përballet me një rrezik të thellë."

*Një komentator i një radioje izraelite, ora 22:15, data 5 shtator 1978.*

• "Qeveria Izraelite formoi një këshill prej tridhjetë ekspertësh në fushat e psikologjisë, historisë, sociologjisë, politikës dhe strategjisë

për të studiuar faktorët që çuan në ngritjen e Salahudin Al-Ajubit dhe të zbulonin mundësitë e shfaqjes së një Salahudini tjetër, qoftë ai një hero musliman apo një organizatë islame dhe po ashtu të zbulonin dhe mënyrat dhe mjetet për ta luftuar një gjë të tillë.

*Trakti Al-Burak, pubikuar nga Al-Burak për dokumentacion dhe reportazh për mediat, Jordani; data 18, 30 qershor e vitit 1981.*

"Unë shpesh kam vizituar fshatrat arabë, që ndodheshin pranë kodrës përgjatë kufirit ku fshatarët, të sjellshëm dhe mikpritës, pavarësisht zemërimit të tyre ndaj britanikëve për shkak të lejimit të emigarcionit çifut, më pritën mirë. Për kush e di sa shekuj me radhë para-ardhësit e tyre kanë jetuar në Palestinë. Pak vite më vonë, përmes një bashkëpunimi të fshehtë të Amerikës dhe Britanisë, ata u dëbuan nga vendi i tyre ose u lanë ti nënshtroheshin ligjit të padrejtë të Izraelit. të cilët pretendonin se kishin të drejta mbi një vend, nga i cili ishin dëbuar mijëra vjet më parë. Rrallë mund të ketë ndodhur që një padrejtësi e tillë ti bëhet një populli duke pasur aprovime të tilla të përgjithshme dhe rrallë ka ndodhur që farat e një urrejtjeje kaq katastrofale dhe kaq të përhapur të mbillen me kaq shumë vetëkënaqësi".

*Wilfred Thesiger, në librin "Jeta e zgjedhjes sime" The Life of My Choice (Glasgow 1987), fq.387. Wilfred Thesiger ka qenë një ish-oficer politik i Shërbimeve Sekrete Britanike, i cili ka punuar në Sudan, Abisini, Arabi dhe Palestine.*

- "Konflikti izraelito-palestinez nuk është vetëm një çështje pushtimi ushtarak dhe Izraeli nuk është vetëm një vend që u themelua "normalisht dhe ndodhi që pushtoi një vend tjetër në vitin 1967. Palestinezët nuk po luftojnë për "një shtet", por ata po luftojnë për liri, çlirim dhe barazi, ashtu siç kemi luftuar ne për lirinë e Afrikës Jugore.

Në vitet e fundit dhe sidomos gjatë sundimit të partisë Laboriste, Izraeli tregoi se as që donte ta kthente atë tokë që e kishte pushtuar në 1967. Kjo do të thoshte se vendbanimet hebreje do të qëndronin, Jeruzalemi do të ishte vetëm nën sundimin izraelit dhe palestinezët nuk

do të kishin një shtet të pavarur, por do të qëndronin nën dominimin ekonomik izraelit. Kështu Izraeli do të kontrollonte kufijtë e Palestinës, tokën, ajrin, ujrat dhe detin e saj."

"Shteti palestinez nuk mund të jetë një nënprodukt i shtetit izraelit vetëm për faktin se duhet të ruhet popullsia e pastër çifute në Izrael. Diskriminimi racial i Izraelit është një pjesë e jetës së përditshme për çdo palestinez. Duke qenë se Izraeli është një shtet çifut, atëherë çifutët kanë të drejtë të ushtrojnë të drejta të veçanta, gjë e cila nuk u lejohet joçifutëve. Arabo-palestinezët nuk kanë vend në një shtet "çifut".

Aparteidi është një krim kundër njerëzimit. Izraeli u ka mohuar miliona palestinezëve të drejtën për të qenë të lirë dhe për të pasur pronën e tyre. Ai ka ngritur një sistem diskriminimi dhe pabarazie. Ky shtet ka burgosur dhe torturuar sistematikisht mijëra palestinezë në kundërshtim me rregullat e ligjit ndërkombëtar. Ai ka nisur një luftë ndaj popullsisë civile dhe në mënyrë të veçantë ndaj fëmijëve."

*Nelson Mandela (ish-Presidenti me famë botërore i Afrikes se Jugut),*
*Memorandumi i Parë për Thomas Friedman (Reporter i New York Times) Mars 2001.*

## BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR


1. Kurani Famëlartë

**Dokumente të pabotuara:**

2. Zyra e të Dhënave Publike, Londër, Air Ministry, AIR 5/ 1245, Raport mbi "Safad Gang", Përmbledhje e artikujve me interes, Air H.Q., Shkurt, 1930.

3. P.R.O., Colonial Office, C.O. 733/257/11, secret memo- randum by H.R. Rice to the chief secretary, entitled ap- preciation of Arab feeling as affecting Palestine, Septem- ber, 1933.

4. PRO., Foreign Office, FO. 371/4183, Balfour memo to Lord Curzon, 11 August 1919

5. P.R.O., Foreign Office, EO. 371/111077.

6. PR.O., Foreign Office, EO. 371/111098 111100.

7. PR.O., War Office, W.O.158/624, Summary of Historical documents from the outbreak of war between Great Brit- ain and Turkey 1914 to the outbreak of the Revolt of the Sherif of Mecca in June 1916, prepared by the Arab Bu- reau, Cairo, 29 November 1916.

**Dukumente të botuara:**

8. Ayuob, Samir, *Wathaiq Asasiyyah fi al-Siraa al-Arabi al-Sahyuni* (Basic Documents on the Arab-Zionist Con- flict), (Bejrut, 1984).

9. Hurewrtz, J. C. (editor) *Diplomacy in the Near and the Middle East: A Documentary Record 1914-1956*. (U.S.A., 1958)

10. Al-Hut, Bayan (editor), *Wathaiq al-Haraka al- wataniyyah al-*

*Falastiniyyah 1918-1939*, (Bejrut, 1984).

11. Khan, Zafrul Islam, *Palestine Document*s, (New Delhi,

1998)

12. *Malaf Wathaq Falastin* (A file on Palestine Documents). prepared by the Egyptian Ministry of National Guidance (Cairo, 1969).

**Raporte zyrtare dhe dokumente:**

13. *Palestine: Report on Immigration, Land settlement and Development*, by Sir J.H. Simpson. (London, October 1930), Cmd. 3686.

14. P*alestine Statement of Policy by His Majestys Gov- ernment in the United Kingdom*. October 1930. Cmd.3692. (London, 1930)

15. *Report of the Commission Appointed by His Excellency the High Commissioner for Palestine by Notification No. 1561, Published in Palestine Gazette dated 16 No- vember 1933*, this report was published in the Official Gazette, Extraordinary. 7 February 1934, (This report is popularly known as Murison Report).

16. The Official Arabic version of the Report of the Royal Commission: *The White Book* No. 5479, popularly known as "Peel Report", Published by the British Mandatory Gov- ernment in Palestine (Jerusalem, 1937)

17. *Palestine Statement of Policy*. May 1939. Cmd. 6019 (London, 1939).

18. *Palestinian Government: A Survey of Palestine, pre- pared in December 1945 and January 1946 for the Information of the Anglo-American Committee of In- quiry* (Jerusalem, 1946).

19. Khalifah, Ahmed (translator) *Harb Falastin 1947-1948* (Palestinian War 1947-1948: the official Israeli Narration), (Cyprus, 1984).

**Diskutime parlamentare:**

20. Diskutime parlamentare: Raport zyrtar, Fifth series, House

of Commons. Londër, 1931, Vol.248.

**Shënime biografike:**

21. Abu Azzah, Abdullah, *Maal-Haraka al-Islamiyyah fi al- Duwal al-Arabiyyah* (Me lëvizjet islame në vendet arabe), (Kuvajt, 1986)

22. Al-Ghuri, Amil, *Falastin Abr Siteen Aman* (Palestina në

rrjedhën e 60 vjetëve), (Bejrut, 1972).

23. Khalaf, Salah, *Falastini bila Hawiyyah* (Palestina pa identitet), (Aman, 1996).

24. Al-Mardini, Zuhair, *Alf Yaum ma el-Haxh Amini al- Huseini* (Një mijë ditë me Haxhii Amini Al-Huseini), (Bejrut, 1980).

25. Nuwayhid, Ajjaj, *Rixhal min Falastin* (Burra nga Palestina), (Bejrut, 1980).

26. Al-Sakakini, Khalil, Katha Ana Ya Dunia (O botë! Unë jam këtu), (Damask, 1982).

**Libra:**

27. Abdul-Rahman, Asad, *Al-Munazzamah al-Sahuniyyah al-Alamiyyah 1882-1982* (Organizata Botërore Zioniste 1882-1982), (Bejrut, 1990)

28. Abdul-Rahman Asad, *Munzamat al-Tahrir al- Falastiniyyah* (Organizata për Çlirimin e Palestinës), (Nikozia, 1985)

29. Abu Sabih, Umran, *Al-Hijrah al-Yahudiyyah: Haqaiq wa Arqam* (Emigrimi i çifutëve; fakte dhe të dhëna), (Aman, 1991).

30. Abu Sitta, Salaman, P*alestinian Right to Return: Sacred, Legal & Possible* (Londër, 1999).

31. Abu Yasir, Salih, *Jihad Shab Falastin Khilal Nisf Qarn* (Lufta e popullit palestinez në gjysmë shekulli), (Bejrut, 1970).

32. Ali, Falah Khalid, *Falastin wa al-Intidab al-Biritani 1939-1948* (Palestina dhe mandati britanik) 1939-1948, (Bejrut, 1980).

33. Al-Amiri, Muhammed Adib, *Urubat Falastin fi al-Tarikh* (Arabizimi i Palestinës gjatë rrjedhës historike). (Bejrut, 1972).

34. Antonius, George, *The Arab Awakening* (Londër, 1955)

35. Al-Arif, Arif, *Al-Nakbah, Nakbat Bayt al-Maqdis wa al-Fardous al-Mafqud 1947-1951* (Katastrofa e Kudsit dhe parajsa e humbur 1947-1951). (Bejrut, 1954).

36. Cabban, Helena, *The Palestinian Liberation Organisation: People power and Politics* (U.S.A., 1991). 37. Cattan, Henery, Falastin fi Dawal-Haq wa al-Adl (Pal- estine in the Light of Truth & Justice), (Beirut, 1970)

38. Al-Dabagh, Mustafa Murad, *Al-Qabail al-Arabiyyah wa Salailuha fi Biladina Falastin* (The Arab Tribes & their Descendants in our Lands: Palestine), (Bejrut, 1979).

39. Al-Dabagh, Mustafa Murad, *Min Huna wa Hunak* (Nga këtu dhe atje).

40. Darwazah, Muhammed Azzah, *Falastin wa Jihad al- Falastiniyyin* (Palestina dhe lufta e palestinezëve), (Kajro, 1959).

41. Fahmi, William, *Al-Hijrah al-Yahudiyyah ila Falastin* (Shpërngulja çifute në Palestinë), (Kajro, 1974).

42. Fauur, Asma, *Falastin wa al-Mazaim al-Yahudiyyah* (Palestina dhe pretendimet çifute), (Bejrut, 1995).

43. Halak, Hassan, *Mawkif al-Dawlah al-Uthmaniyyah min al-Harakah al-Sahuniyyah 1879-1909* (Qëndrimi i shtetit osman ndaj Levizjes Zioniste 1879-1909). (Bejrut. 1980).

44. Al-Hamad, Jawad (editor), *al-Madkhal ila al-Qadiyyah al-Falastiniyyah* (Hyrje në çështjen palestineze), (Aman, 1997).

45. Al-Hroub, Khalid, *Hamas* (Bejrut, 1997).

46. Al-Hur, Munir dhe Tarik al-Musa, *Mashari al-Taswiyah lil Qadiyyah al-Falastiniyyah 1947-1985*, (Aman, 1986).

47. Al-Hut, Bayan, *Al-Qiyadat wa al-Muassasat al- Siyasiyyah al-Falastiniyyah 1917- 1948* (Liderët dhe institucionet politike në Palestinë 1917-1948), (Bejrut, 1981)

48. Hyamson, Albert, *Palestine under the Mandate 1920-1948* (Britani e Madhe, Methuen, 1950)

49. Ibrahim, Hassan Ahmed, *Neo-Mahdism in the Sudan 1898-1959.*

50. Jiryes, Sabri and Ahmed Khalifah, *Dalil Israel al-Am* (Guidë e përgjithshme e Izraelit), (Bejrut, 1996).

51. Al-Kayali, Abdul-Wahhab, *Tarikh Falastin al-Hadith* (Historia Moderne e Palestinës), (Bejrut, 1985).

52. Khan, Zafar al-Islam, *Tarikh Falastin al-Qadim 1220 B.C. 1359 A.D.: Munzu Awal Ghazu Yahudi hata Akhir Ghazu Salibi* (Historia e vjetër e Palestinës 1220 B.C.1359 A.D. (Bejrut, 1984).

53. Khullah, Kamil, *Falastin wa al-Intidab al-Biritani 1922-1939* (Palestina dhe mandati britanik 1922-1939), (Tripoli, 1982).

54. Al-Makdisi. Dija al-Din Muhammed (botuar nga Muhammed Mutee Hafiz), *Fadail Bayt al-Maqdis. Silsilat Fadail al-Sham* (Vlerat e Kudsit), numër 2 (Dam-ask, 1985).

55. Al-Marashli, Ahmed, *Al-Mawsuah al-Falastiniyyah* (Enciklopedia Palestineze), (Damask, 1984).

56. Masalha, Nur, *The Expulsion of the Palestinians* (U.S.A., 1993).

57. Al-Masiri, Abdul-Wahhab, *Al-Aidiolojiyah al-Sahuniyyah* (Ideologjia zioniste), Silsalat alm al-Marifah, numër 60-61 (Kuvajt, 1983).

58. Al-Nahhal, Muhammed Salamah, S*iyasat al-Intidab al-*

*Biritani hawl Aradi Falastin al-Arabiyyah*, (Bejrut, 1981).

59. Al-Natshah, Rafik and Ismail Yaghi, *Tarikh Madinat al-Quds* (Historia e qytetit të Jeruzalemit). (Aman, 1984).

60. Al-Rayyis, Riyadh dhe Dunya Nahhas, *Al-Masar Al-Sab: Al-Magawamah Al-Filistiniyyah: Munazamatuha, Ashkhasuha, Alaqatuha* (Rruga e vështirë: Rezistenca palestineze; Organizmat, personalitetet dhe marrëdhëniet mes tyre". (Bejrut, 1976).

61. Right, Clayford (përkthyer nga Abdullah Arayqat dhe Abdullah Ayad, *Haqaik wa Abatil fi al-Sira al-Arabi al-Israeli*, (Të vërteta dhe të pavërteta në konfliktin arabo- izraelit), (Aman, 1992).

62. Saleh, Mohsen M., *Al-Tariq ila al-Quds: Munzu Usur al-Anbiyaa wa Hatta Awakhir al-Qarn al-Ishrin* (Rruga për në Jeruzalem që nga koha e profetëve deri në fund të shekullit XX), (Londër, 1998).

63. Saleh, Mohsen M., *Al-Quwwat al-Askariyyah wa Al-Shurtah fi Falastin 1917-1939* (Forcat ushtarake dhe ato policore në Palestinë 1917-1939), (Aman, 1996).

64. Saleh, Mohsen M., *Al-Tayyar al-Islami fi Falastin wa Atharuhu fi Harakat al-Jihad 1917-1948* (Rryma islame në Palestinë dhe ndikimi i saj për xhihadin atje në vitet 1917-1948), (Kuvajt, 1988).

65. Salim, Muhammed Abdul-Rauf, N*ashat Al-Wakalah al- Yahudiyyah li Falastin: munzu Nashatiha wa, hata Qiyam Dawlat Israel 1922-1948* (Bejrut, 1982).

66. Shafik, Munir, *Oslo 1 wa 2: Al-Masar wa al-Maal* (Oslo 1 and 2: the Path & the End), (Londër, 1997).

67. Al-Sharif, Rigina (përkthyer nga Ahmed Abdullah Abdul- Aziz) *Al-Sahuniyyah Ghayr al-Yahudiyyah: Juzuruha fi al-Tarikh al-Gharbi* No. 96, (Kuvajt, 1985).

68. Sulayman, Daud, *Al-Sultah Al-Wataniyyah al-*

*Falastiniyyah fi Am 1994-1995* (Autoriteti Kombëtar Palestinez në vitet 1994-1995), (Aman, 1995).

69. Thesiger, Wilfred, *The Life of My Choice* (Glasgow 1987). 70) Yusif, Imad and others, *Al-Inikasat al-Siyasiyyah li luifak al-Hukm al-Thati al-Falastini* (The Political Conse- quences of the Palestinian Self-Rule Agreement), (Aman, 1995).

**Gazeta dhe periodikë:**

71. *Al-Dustour* (Jordani)

72. *Falastin al-Muslimah* (Londër)

73. *Al Hayat* (Londer)

74. *Al-Khaleej* (Emiratet e Bashkuara Arabe)

75. *Al-Mujtama (*Kuvajt)

76. *Al-Rai* (Jordani).

77. *Sawt al-Shab* (Jordani).

78. *Al-Sharq al-Awsat* (Londër)

79. *Al-Siyasah* (Kuvajt).

**Web Sites:**

80. Zyra Qendrore e Statistikave, qeveria izraelite, http:// www.cbs.gov.il/yahran/bl/e.htm
81. http://www.cia.gov/cia/publications/factbook/geos/is.html (CIA world fact book). 82. www.islamonline.com

83. www.Palestine-info.com

84. www.passia.org

# ÇËSHTJA PALESTINEZE

## Historia dhe zhvillimi i saj deri në 2005

Dr. Muhsin Salih është një nga mendjet më të ndritura palestineze që kam njohur ndonjëherë. Libri i tij, 'Çështja Palestineze: historia dhe zhvillimi i saj deri në 2005' është një përpjekje serioze e një dëshmimtari dhe historiani të gjallë, i cili në kete liber mundohet t'i rrëfejë komunitetit ndërkombëtar tragjedinë më të madhe njerëzore të shekullit të XX: Historinë e Holokaustit Palestinez.

Në momentet që ky libër po botohet, në Gaza, në Bregun Perëndimor dhe në të gjithë Lindjen e Mesme, një popull vazhdon të jetojë si i huaj, i përbuzur dhe i shtypur. Populli krenar palestinez deri në këto momente, që prej afro 100 vitesh pas nisjes së tragjedisë së tij, ekziston si një komb i dënuar dhe i mohuar. Palestinezët që prej afro 60 vitesh jetojnë nëpër kampe refugjatësh, larg nga toka e tyre, të cilën udhëheqësit e botës së sotme ia grabitën me dhunë dhe ligësi këtij kombi të pafaj. Palestinezët janë ende qytetarë të asnjë vendi dhe Palestina e shenjtë e komunitetit të muslimanëve botërorë vazhdon të mbetet një nocion i kaluar historik për mendjet e sundimtarëve zionistë të Izraelit dhe padronëve të tyre në Perëndim.

Ngaqë publiku ynë në Shqipëri, shpesh bëhet viktimë e trushplarjes së mediave tona thellësisht perëndimore dhe servile, prej kohësh kam qenë i mendimit që ky libër duhej të botohej në gjuhën shqipe: në mënyrë që edhe në mendjen shqiptare të hidhet pakëz dritë mbi historikun e vërtetë të Tokës së Shenjtë dhe njerëzve të saj; palestinezëve.

Palestinezët nuk janë terroristë si okupatorët e tyre. Ata janë njerëz që duan të jetojnë të lirë dhe në paqe. Por për të arritur këtë, ata, ashtu si Dauti i vogël në rrëfimet kuranore që qëndronte kundër bishës Xhalut, janë të vendosur që të luftojnë një luftë të pabarabartë me makinën ushtarake të zionizmit ndërkombëtar dhe të mos dorëzohen kurrë, në mënyrë që një ditë, ashtu si Dauti në rrëfimet e shenjta, të mundin bishën dhe të sigurojnë një Palestinë të lirë.

Olsi Jazexhi